



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@kish.org.al; Web-site: www.kish.org.al

Auditim performance

Efektiviteti i granteve në AZHBR



Dhjetor 2017

RAPORT I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

“EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Dhjetor 2017

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 639/1 prot., datë 09.10.2017.

Faza studimore e auditimit nisi në datë 12.06.2017 me shkresën për njoftim-fillim auditimi nr. 639 prot. dhe përfundoi në datë 03.06.2017.

Faza e terrenit të auditimit nisi në datë 10.10.2017 me programin e auditimit cituar më lart dhe përfundoi në 20.11.2017.

Projektraporti i auditimit mori formë përfundimtare më 25.11.2017 dhe me shkresën nr. 639/2 prot., iu përcoll subjektit nën auditim: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

Pas respektimit të afatit për observacione nga palët e interesit, subjekti i audituar AZHBR me shkresën nr. 3365 prot., datë 29.12.2017, ardhur në KLSH me datë 29.12.2017 me nr. 639/3 prot., ka vlerësuar pozitivisht, korrekte dhe të qarta gjetjet dhe rekomandimet e trajtuara në Projektraport, të shoqëruara me disa sqarime dhe saktësime për çështje të veçanta, të cilat janë pasqyruar gjatë raportit të auditimit.

Auditimi është kryer nga:

1. Gjovalin Preçi, Kryeauditues, përgjegjës grupi,
2. Klejvis Kule, Auditues i dytë, anëtar.



📖 Përmbajtja

1. RËNDËSIA E AUDITIMIT	4
1.1 Konteksti i problemit social.....	4
1.2. Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës	5
1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë.....	6
1.4 Subjekti nën auditim.....	8
1.4.1 Hyrje	9
1.4.2 Politikat e institucionit/agjencisë	11
1.4.3 Pesha në buxhet dhe PBB.....	12
1.4.4 Risqet e aktivitetit të subjektit	13
1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	17
1.4.6 Feedback-u i subjektit në përfundim të auditimit	18
2. QASJA DHE DETAJE TË AUDITIMIT	19
2.1 Objektivi dhe problemi i performancës	20
2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës.....	20
2.1.2 Objektivi i auditimit.....	22
2.2 Përkufizimet dhe terminologjia.....	22
2.3. Kriteret.....	24
2.3.1 Kriteret e politikës	24
2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimi	24
2.3.3 Kriteret teknike.....	24
2.3.4 Kriteret e tjera/Praktikat më të mira	25
2.4. Piramida e pyetjeve audituese.....	25
2.5 Skema e auditimit	26
2.5.1 Qasja/ Metodologjia audituese	26
2.5.2 Metodatat & teknikat audituese	27
2.6 Rezultatet e parashikuara	27
2.6.1 Impakti i mesazhit auditues për Kuvendin dhe Qeverinë	27
2.6.2 Impakti i mesazhit auditues për publikun dhe palët e interesit.....	27
2.6.3 Forma e publikimit	28
3. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE	28
3.1. Si ka ndikuar menaxhimi i stafit dhe specialistëve të AZHBR në funksion të zbatimit të procedurave të granteve?.....	29
3.2 A është ndikuar efektiviteti i granteve nga performanca e AZHBR në zbatimin procedurës së dhënies së granteve?.....	36
3.3. A janë arritur objektivat në administrimin e skemave dhe fondeve për mbështetjen e zhvillimit të bujqësisë?	48
3.3.1 A kanë ndikuar fondet për publicitet në efektivitetin e granteve të dhëna?	48
3.3.2 Sa efektive kanë qenë financimet buxhetore për mbrojtjen e ullirit në vendin tonë?	55
3.3.3 A është përdorur me ekonomicitet mbështetja financiare e investimeve në bujqësi?	62
3.3.4 Sa i ka shërbyer monitorimi i granteve zhvillimit të bujqësisë?	72
4. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE, KONKLUSIONEVE DHE REKOMANDIMEVE	77
4.1 Informacion përmbledhës	77
4.2 Aneksat (literatura e përdorur, pasqyra etj.)	90
5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE.....	94



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

✂ Lista e shkurtimeve

AKU	Agjencia Kombëtare e Ushqimit
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi European
DAP	Drejtoria e Autorizimit të Pagesave
DEP	Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave
DK	Drejtoria e Kontrollit
DPAP	Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DRB	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
EUROSAI	“European Organization of Supreme Audit Institutions”,
FEBZHR	Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural
GAUF	Grant Assistance for Underprivileged Farmers
GDP	“Gross Domestic Product”
Ha	Hektar
INSTAT	Instituti i Statistikave
INTOSAI	“The International Organisation of Supreme Audit Institutions”
IPA	Instrument for Pre-Accession Assistance
IPAARD	Instrument for Pre-Accession Assistance in Rural Development
ISHTI	Inspektoriati Shtetëror, Teknik dhe Industrial
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KVM	Komisioni i Verifikimit dhe Monitorimit
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MF	Ministria e Financave
OE	Operatori Ekonomik
PF	Person Fizik
PMB	Produktet e Mbrojtjes së Bimëve
QTTB	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
SAP	Spektori i Auditit të Brendshëm
SEP	Spektori i Ekzekutimit të Pagesave
SHPK	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
SNZHBR	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
SWOT	“Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats”
TV	Televizion
TVSH	Tatim mbi vlerën e shtuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZRPP	Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme



1. RËNDËSIA E AUDITIMIT

Auditimi në përgjithësi ka të bëjë me ekzaminim sistematik dhe të pavarur të dokumentacionit tërësor të një organizate, ndërsa auditimi i performancës lidhet me auditimin e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit, dhe synon krahas të tjerave, për formalizimin e ekonomisë, për mirëmenaxhimin e financave dhe fondeve publike, për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe përdorimit të tyre, në luftë me abuzimin dhe shpërdorimin, vjedhjen dhe korrupsionin dhe keqpërdorimin e tyre.

KLSH auditon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë publikë, për të evidentuar nëse aktiviteti i tyre ka qenë me efektivitet, efijencë dhe ekonomicitet, duke rekomanduar masat e duhura për përmirësimin e performancës së tyre. Veç këtyre, nëpërmjet auditimit, KLSH bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe burimeve natyrore kombëtare, kryerjen në kohë, me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike etj¹. Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe EUROSAI, të cilat gjejnë pasqyrim në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2013-2017.

Tematika e auditimeve të performancës, nis me përzgjedhjen e propozimeve për auditim që në vitin paraardhës, në zbatim të Manualit të Auditimit të Departamentit të Performancës, i miratuar me urdhrin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 47, datë 30.04.2015². Në këtë kuadër është evidentuar dhe nevoja e auditimit të efektivitetit të granteve në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR). Fokusimi në këtë temë vjen pas krijimit të një eksperience departamentale në auditimin e performancës së disa institucioneve publike si: metrologjisë, ISHTI-t, AKU-s etj., si dhe të auditimeve specifike të lidhura me efektivitetin e granteve siç ishte performanca e Projektit të Shpërndarjes së Shërbimeve Bujqësore.

Veç këtyre, bujqësia është një nga sektorët kryesor që ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit, për shkak të kontributit të lartë në Prodhimin e Brendshëm Bruto, ndikimit në nivelin e punësimit dhe të vetëpunësimit, shtrirjes së gjerë të popullsisë rurale, rritjes së konsumit, prirjes për të harmonizuar zhvillimin e bujqësisë me atë rajonal, përmirësimin të raportit eksport/import në tërësi etj. Në këto kushte bujqësia merr financime nga buxheti i shtetit me synim zhvillimin ekonomik dhe social të zonave rurale. Financimet buxhetore për zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural realizohen kryesisht nëpërmjet skemave kombëtare, të cilat administrohen dhe menaxhohen nga AZHBR, sipas kuadrit rregullator të posaçëm.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në faktin që Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij kushtetues, ka për kompetencë auditimin me qëllim mbrojtjen e interesave publike, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH ndërmori auditimin e performancës së efektivitetit të granteve në AZHBR. Nëpërmjet këtij auditimi, duke identifikuar dhe analizuar për një periudhë pesëvjeçare (2013-2017) çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore, me ciklin e plotë të administrimit të skemave kombëtare (informim, aplikim, përfitues, verifikim, kontroll, monitorim) deri në vlerësimin e impaktit në terren, synojmë të japim rekomandimet e duhura në drejtim të përmirësimin të organizimit, menaxhimit dhe administrimit me efektivitet të parave publike në zhvillimin e bujqësisë dhe të rajoneve.

Gjithashtu, kjo performancë është një vlerë e shtuar në përvojën institucionale, pasi orientohet në një fragment të rëndësishëm të veprimtarisë së AZHBR dhe fushë të veçantë auditimi efektivitetin e granteve, në kushtet e mungesës së auditimeve të mirëfillta të performancës me këtë fokus.

1.1 Konteksti i problemit social

Bujqësia shqiptare luan një rol të rëndësishëm në ekonomi, pasi është një prej sektorëve potencial në zhvillimin e vendit. Në periudhën 2013 -2015 kontributi i bujqësisë në GDP përfaqëson mesatarisht 17 % të totalit dhe vazhdon të mbetet sektori kryesor i punësimit për rreth 45 % të punësuarve (viti

¹ Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Neni 6.

² Manuali i Auditimit të Performancës



KONTROLLI I LARTË I SHËTËTIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

2016)³, ndërsa sipas INSTAT, në vitin 2014 popullsia banuese në zonat rurale ka qenë 52.3 % me prirje në rënie në vitin 2016 me 42.59 %⁴, me rënie të theksuar krahasuar me vitin 1990 që ishte 63,6 %⁵. Veç kësaj, vlera e produkteve bujqësore dhe blegtorale në periudhën 2013-2016 zë mesatarisht 34 % të importeve dhe 2.28 % të eksporteve gjë që tregon se ekonomia jonë bujqësore nuk është akoma konkurruese me atë të vendeve të tjera.

Veç këtyre, gati gjysma e popullsisë shqiptare (45.5 %) jeton me 5 dollarë në ditë, një kufi që konsiderohet varfëri nga Banka Botërore, e matur kundrejt nivelit të standardizuar rajonal⁶, ose tre herë më pak se niveli i krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Shkalla e varfërisë në zonat rurale është rritur nga 15,0 % në 2008 në 15,5 % në vitin 2012, duke shfaqur që nuk është më e përqendruar në zonat malore rurale⁷

Në këto kushte, bujqësia konsiderohet një nga sektorët kryesor për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, për të cilën, krahas politikave të tjera mbështetëse, është financuar nga buxheti i shtetit. Pra një numër fermerësh kanë përfituar nga grantet e skemave kombëtare me synime të ndryshme: që nga nxitja e prodhimit, të përpunimit, të tregtimit deri tek rritja e konkurueshmërisë bujqësore. Në këtë kuadër AZHBR ka për detyrë, midis të tjerave të vëre në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural⁸, si dhe është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programit për bujqësinë dhe për zhvillimin rural.⁹

Aktualisht, sektori i bujqësisë është përfshirë në prioritetet strategjike të qeverisë për zhvillim, duke i ofruar edhe lehtësira procedurale¹⁰, ndërkohë, vazhdon të mbetet një nga sektorët më informal të ekonomisë, i cili vihet re në nivele të ndryshme në të gjitha hallkat e zinxhirit të prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore e blegtorale.

1.2. Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës

KLSH ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet ndërkombëtare në fushën e auditimit, duke u përpjekur në përvetësimin e praktikave më të mira, si dhe i është përshtatur zhvillimeve ekonomike brenda vendit, me qëllim që të sigurojë shërbime publike optimale nëpërmjet përdorimit me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

Në këtë kuadër, KLSH, në përmbushje të funksionit të vet kushtetues, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI dhe Manualin Departamental të Auditimit të Performancës, i orientuar drejt modernizimit dhe rritjes cilësore profesionale të kapaciteteve njerëzore, strukturore dhe teknike, në të gjithë administratën publike, po e vë theksin, gjithnjë e më tepër, tek auditimi i performancës dhe roli këshillimor i tij.

“Auditimi i performancës” ka të bëjë me:

- Auditimin e ekonomikitetit*, që nënkupton minimizimin e kostos së burimeve që përdoren në një veprimtari publike, duke mos cenuar cilësinë e tij;
- Auditimin e efikasitetit*, që nënkupton optimizimin e raportit burime-rezultate të veprimtarisë publike, duke modifikuar proceset, strukturat dhe gjithë zinxhirin ekonomik të vlerës, në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare dhe praktikën më të mira;
- Auditimin e efektivitetit*, që nënkupton vlerësimin e rezultateve përfundimtare dhe objektivave të vendosura, në përputhje me politikën e subjektit të audituar.

³ www.instat.gov.al dhe përlogaritje të grupit të auditimit.

⁴ <https://tradingeconomics.com/albania/rural-population-percent-of-total-population-wb-data.html>

⁵ www.opendata.al

⁶ “Ribalancim për një rritje më të fortë” World Bank Group, Pranverë 2016.

⁷ Shqipëria: trendi i varfërisë 2002-2005-2008-2012, INSTAT.

⁸ Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, neni 21.

⁹ VKM Nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, pika 4.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

KLSH është institucioni i vetëm që ka tagrin kushtetues për akses të pavarur në informacion, avantazhin për t’u dëgjuar direkt nga Kuvendi dhe profesionalizmin për të qenë i pavarur nga ndërhyrjet politike, qeveritare, të biznesit etj., duke bërë të mundur trajtimin e performancës së institucioneve publike në përputhje me misionin institucional. Gjithashtu, KLSH zotëron kapacitetet njerëzore dhe teknike për t’a realizuar me sukses auditimin, duke harmonizuar dhe bashkërenduar përvojat, formimin profesional, trajnimet, rezultatet, ekspertizën e jashtme etj., me eksperiencën e akumuluar nga auditimet e kryera më parë.

1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë

Grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi auditimet e kryera në AZHBR në periudhën 2013-2017. Nga analiza e dosjeve të kontrollit, si dhe nga takimet me pjesëtarë të stafit të Agjencisë, konstatohet se AZHBR është audituar nga KLSH, nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e MBZHRAU, si dhe nga Sektori i Auditit të Brendshëm.

a) KLSH ka kryer dy auditime:

1. Në prill të vitit 2014 ka përfunduar auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për periudhën e aktivitetit të AZHBR nga janar 2012 - dhjetor 2013. Gjatë këtij auditimi kanë rezultuar disa probleme dhe mangësi lidhur me: mungesën licencimit për veprimtarinë financiare që kryhet në këtë institucion, veprimtari e pamjaftueshme e verifikimit në terren, mosndjekje për arkëtim e detyrimeve debitore, mos ndjekje e realizmit të investimeve etj. Mbi këtë bazë është propozuar përmirësim në legjislacion, si dhe janë rekomanduar 5 masa organizative të cilat konsistojnë në kryerjen nga AZHBR të verifikimeve në terren për ecurinë e investimeve, arkëtim të detyrimeve debitore etj. Gjithashtu është kërkuar arkëtimi i dëmit ekonomik në vlerën 5,551,912 lekë në total në 3 raste, si dhe 6 masa disiplinore, kryesisht largim dhe paralajmërim për largim nga puna për drejtor, përgjegjës sektori dhe specialistë.

2. Auditimi KLSH “Rregullshmëria Financiare në AZHBR” ka përfunduar në datën 05.10.2016, për aktivitetin e periudhës dhjetor 2014 - dhjetor 2015, me objekt vlerësimin e saktësisë së raportimit financiar të aktivitetit ekonomik të AZHBR. Në përfundim të auditimit është dhënë Opinion i Pakualifikuar: pasqyrat vjetore të AZHBR paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të institucionit. Raporti është shoqëruar me disa konkluzione të rëndësishme si: Rregullorja e brendshme e AZHBR nuk është përditësuar për një periudhë 3-vjeçare, nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të risqeve, monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave, menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm nuk ka funksionuar siç duhet etj. Gjetjet dhe konkluzionet e mësipërme kanë bërë që KLSH të rekomandojë dhe të kërkojë zbatimin e 27 masave organizative për përmirësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të AZHBR-së.

b) Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MBZHRAU: ka kryer auditimin e Përputhshmërisë dhe Financiar me tematikë “Dokumentimi, ndjekja dhe kontabilizimi i detyrimeve debitore të trashëguara nga ish Projekti 2 KR” në tetor 2014 për periudhën nga 01.01.2008 deri më 31.12.2013. Gjatë këtij auditimi është arritur në konkluzione të rëndësishme si: Menaxhimi i AZHBR në vite nuk ka zbatuar dhe ndjekur objektivat kryesore për realizimin e misionit për të cilin është krijuar, mungesa të dokumentacionit mbështetës gjatë kontratave, mos mbajtja e një kontabiliteti unik etj. Për këto mangësi, titullarit të AZHBR i janë lënë disa detyra, si: krijimin e një data baze me të dhëna të plota dhe një arshivë me dosje personale për secilin përfutues të granteve në vite, që kanë përfutuar mallra, nxjerrjen e përgjegjësive dhe sistemimit të shumave të caktuara për kreditim pa interes të linjave për të cilat nuk është gjetur dokumentacion justifikues etj.

c) Auditimet nga Sektori i Auditit të Brendshëm:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Për periudhën 2013-2016 janë ushtruar 12 auditime, nga të cilat 8 janë auditime financiare, 3 auditime përputhshmërie dhe një auditim i konsideruar prej tyre auditim performance. Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet kryesore të dhëna gjatë këtyre auditimeve konsistojnë në masa disiplinore ndaj specialistëve të AZHBR për mos zbatim të detyrave, Drejtoria e IT të gjenerojë të dhëna të sakta dhe të plota, implementim i regjistrit të riskut, trajnim dhe shtim të numrit të stafit, rritjen e mbikëqyrjes nga sektori i skemave kombëtare, të realizohet kontroll real para dhe pas financimit etj.

Gjetjet dhe konkluzionet kryesore të këtyre auditimeve janë:

- ✘ Mungon bashkëpunimi midis Sektorit të Menaxhimit të Borxhit dhe Sektorit Juridik.
- ✘ Kontroll jo i plotë i dokumenteve të pronësisë.
- ✘ Mangësi/pa përputhshmëri midis përmbajtjes së dosjes fizike dhe dosjes elektronike.
- ✘ Mos respektim në kohë i afatit 3-mujor, që nga koha e kërkesës për pagesë deri në ekzekutimin e saj.
- ✘ Vlerësimi me sistem pikësh nuk është bërë në përputhje me kriteret e vlerësimit sipas udhëzimit.
- ✘ Nuk kanë funksionuar siç duhet mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe parimi i ndarjes së detyrave sipas Manualit të Procedurave për Implementimin e Skemave Kombëtare pasi inspektorët e DAP kanë marrë të mirëqenë faturën e aprovuar nga DPAP.
- ✘ Mos ekzistenca e normativave në nivel kombëtar të nevojshme për vlerësimin e saktë të planit të biznesit.

Për këto janë dhënë rekomandime të ndryshme si:

- ✓ Të merret masë disiplinore për Përgjegjësen e Sektorit Juridik për mos ngritjen e padisë dhe mos inicimin e procedurave gjyqësore siç përshkruhet në Rregulloren e Brendshme të AZHBR-së dhe në Manualin e Procedurave për Implementimin e Skemave Kombëtare.
- ✓ Të përshkruhet në rregulloren e brendshme të AZHBR-së dhe në Manualin e Procedurave për Implementimin e Skemave Kombëtare procesi i detajuar mbi ndjekjen e çështjeve gjyqësore.
- ✓ Drejtoria IT duhet të koordinojë me Drejtorinë përkatëse që Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në AZHBR, të gjenerojë të dhënat e sakta dhe të plota.
- ✓ Implementimi i regjistrit të riskut, vlerësimi, kontrolli i risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave për secilën drejtori.
- ✓ Hartimi dhe dokumentimi i objektivave në një Plan Vjetor dhe Strategjik dhe Institucioni në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- ✓ DAP të ndjekë procedurat gjatë përpunimit të aplikimeve lidhur me plotësimin dhe skanimin e dosjes së aplikantit si dhe të shtohet monitorimi nga kjo drejtori.
- ✓ Të vendoset gjurmë auditimi në çdo hap të dosjes.
- ✓ Pikëzimi të bëhet me rend zbritës që të mund të llogaritet lehtësisht vija e financimit të projekteve.
- ✓ AZHBR duhet të angazhohet për të filluar krijimin e normativave në nivel kombëtar dhe për të rritur rëndësinë për këto çështje.
- ✓ Drejtori i DPAP dhe DK duhet të performojnë kontroll real dhe jo formal.

Auditimi i Performancës është realizuar gjatë vitit 2014 me fokus “Sistemi i Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD-LIKE” për periudhën 30.09.2012-31.12.2013. Qëllimi i këtij auditimi ishin proceset e aprovimit të projekteve dhe kontrollit në terren përpara aprovimit për implementimin e thirrjes së parë të kësaj skeme. Pra Sektori i Auditit të Brendshëm në AZHBR nuk ka kryer performancën e skemave kombëtare por të fondeve të BE-s për një projekt të caktuar.

Me gjithë sa paraqitet më sipër, rezulton se: auditimet, para së gjithash, mbulojnë periudha të veçanta, pa siguruar një vazhdimësi auditimi; në pjesën më të madhe janë tematike me çështje sporadike të rastit; në të shumën e rasteve kërkohet zbatim i kuadrit rregullator; përgjithësisht dhe kryesisht përfshijnë çështje të karakterit financiar, të përputhshmërisë dhe jo drejtpërdrejtë të performancës skemave kombëtare. Në këtë mënyrë arrihet në përfundimin, se institucionet shtetërore që kanë ushtruar auditim në



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”


AZHB si dhe vetë sektori i auditit të brendshëm, nuk kanë zhvilluar auditime të mirëfillta performance për të arritur në përfundime mbi efektivitetin e granteve të skemave kombëtare në AZHBR.

1.4 Subjekti nën auditim

Subjekti nën auditim është Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), e cila ka strukturë qendrore dhe struktura vendore në shkallë qarku. AZHBR është person juridik publik në varësi të ministrit të Bujqësisë¹¹.

Një ndër detyrat kryesore të AZHBR është administrimi i fondeve të programeve për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, me burim buxhetin e shtetit dhe fondet kundërparti të projektit 2KR, të cilat janë fokusi i këtij auditimi të performancës. Me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Këshilli i Ministrave për çdo vit përcakton kriteret bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Gjithashtu, kriteret, procedura dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Bujqësisë.

Skema nr. 1 Procesi i aplikimit (Sipas Udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë nr. 3, datë 30.12.2008)



Burimi: Përgatitur nga grupi i auditimit të KLSH

Me masat për zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimit të zonave rurale synohet të arrihen objektivat e përgjithshëm, si: rritja e të ardhurave për popullsinë rurale, rritja e prodhimit nëpërmjet nxitjes së konkurrueshmërisë dhe të progresit teknik, stabiliteti i tregut, duke garantuar qëndrueshmëri në prodhimin bujqësor, ulje e varfërisë etj. Gjithashtu kanë për qëllim zvogëlimin e pabarazive ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme, si edhe të prapambetjes së zonave rurale, më pak të favorizuara, duke zhvilluar veprimtari alternative dhe plotësuese, që gjenerojnë punësim, me synim ngadalësimin e largimit të popullsisë nga fshatrat, si dhe duke fuqizuar biznesin e vogël dhe të mesëm¹².

Qeveria shqiptare ka një program të dedikuar në buxhetin e shtetit për skemat mbështetëse në bujqësi që zbatohet nga MBZHRAU nëpërmjet AZHBR-së. Fondi i akorduar i skemave kombëtare për periudhën 2013 - 2016 ka ardhur vazhdimisht në rritje, duke bërë që këto fonde të dyfishohen në fund të kësaj periudhe: nga 967 milion lekë në 2013 në 1,8979.7 milion lekë në 2016. Përdorimi në

¹¹ VKM Nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

¹² Të cilin nr. 0817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

fakt i këtij buxheti ose aftësia thithëse nga ana e sektorit bujqësor ka qenë mesatarisht 92.2% për këtë periudhë, me një rënie në nivelin e 83.4 % në vitin 2016¹³.

Duhet theksuar se me gjithë rritjen e vazhdueshme të fondeve të akorduara për bujqësinë, ato janë disa herë më të ulta në vendet fqinje si Maqedonia 150 milion euro, Kosova rreth 60 milion etj., duke e bërë bujqësinë shqiptare më pak konkurruese në rajon. Në këto kushte mundësitë për të përfituar nga skema edhe pse fermeri mund të ketë arritur të plotësojë të gjitha kriteret reduktohen gjithmonë e më shumë duke rënduar besimin e aplikuesve.

Gjatë periudhës 2013-2016, AZHBR ka ofruar mbështetje për 15-19 skema për prodhimin bujqësor, blegtoral dhe agro-përpunimin. Këto skema janë të orientuara në nxitjen e investimeve, përmirësimin e teknologjisë, prodhimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, rritjen e cilësisë, e standardeve të produkteve si dhe mbështetje për formalizim dhe bashkëpunim bujqësor. Vlerën më të madhe të fondeve të dhëna për skemat kombëtare në tërësi për gjithë periudhën konstatohet, se 39,2% i përket financimit të investimeve në masën 50-60% të vlerës së tyre, 25,9% prodhimit të qumështi nga blegtoria e imët dhe 5,9% mbrojtjes së ullishtave nga miza e ullirit etj. Nuk konstatohen prioritete të ndryshme gjatë kësaj periudhe, me përjashtim të vitit 2013 ku përparësi ka pasur mbjellja e ullinjve (23.6%). Në nivel rajoni në periudhën 2013-2016, konstatohet se qarku Fier ka përfituar 16.6 % të fondeve të skemave kombëtare; Gjirokastra 12.9%; Vlora 12.1 % dhe Beratit 11.9 %, pa ndryshime të theksuara në vite.

Numri i përfituesve të skemave mbështetëse ka ardhur në rritje nga viti në vit (me përjashtim të rënies në vitin 2016), duke u ndarë në 5-9 mijë 2013-2014 dhe 11-13 mijë në 2015-2016. Numri më i lartë i përfituesve është për masën e mbrojtjes së ullishtave nga miza me 65.8 %, dhe në vijim prodhimi i qumështit nga të imtat 16.9 %, mbjellje ullinj 4.5 % etj. Ndërsa në nivel rajoni 34.5 % të projekteve i kanë përfituar në qarkun e Fierit, 25.4 % në atë të Beratit, 16.2 % në Vlorë etj.¹⁴

Numri më i lartë i aplikuesve i përket qarkut të Beratit me 28.8 % të aplikuesve në shkallë vendi dhe Fierit me 24 %. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion konstatohet se mesatarisht periudhën 2013-2016 kanë përfituar 63.4 % e aplikuesve për masa të ndryshme, me diferenca të theksuara midis viteve: 41.6 % në vitin 2014 dhe 97.62 % në vitin 2015. Mesatarisht 91.1 % e aplikuesve në Fier kanë përfituar nga skemat mbështetëse dhe 77.2 % në qarkun e Vlorës etj.

1.4.1 Hyrje

Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural", në nenin 21 ka përcaktuar themelimin e Agjencisë së Pagesave me statusin e personit juridik. Një vit më pas është krijuar Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, organizimi dhe funksionimi si agjenci e pagesave fillimisht ka qenë sipas VKM nr. 1443, datë 30.10.2008. Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR, si dhe ndarja e detyrave, përgjegjësisive dhe kompetencave mes saj, DRB dhe aktorëve të tjerë të sistemit të bujqësisë janë vendosur në Udhëzimin e Ministrit të Bujqësisë nr. 3, datë 30.12.2008.

VKM për krijimin e AZHBR është shfuqizuar me VKM nr 719, datë 31.10.2014, i cili zgjeron dhe qartëson rrethin e detyrave të saj, si dhe ndryshon statusin e marrëdhënieve të punës së punonjësve duke i zbritur në rregullimin në bazë të Kodit të Punës. Ndryshimet e fundit kanë ndodhur me VKM nr. 877, datë 14.12.2016, i cili nuk prek në thelb çështjet e organizimit dhe funksionimit të AZHBR. Gjithashtu, Rregullorja e brendshme e AZHBR-së e vitit 2012 është shfuqizuar më datë 02.02.2016.¹⁵ Skemat kombëtare janë të përvitshme, llojet, kriteret dhe masa e përfitimit përcaktohen me VKM të veçanta, të shoqëruara në mënyrë të detajuar me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së bujqësisë dhe asaj të Financave.

¹³ Të dhëna të AZHBR, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

¹⁴ Të dhëna të AZHBR, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Pra, AZHBR është një institucion publik relativisht i ri, me një historik aktiviteti prej afër një dekade, funksionimi i së cilës bazohet në një kuadër rregullator specifik, jo vetëm për fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, por më shumë mpleksjen e këtyre çështjeve me ato të karakterit financiar.

AZHBR ka për mision zhvillimin bujqësisë dhe rural në Shqipëri, duke mbështetur sipërmarrësit në sektorin ushqimor, përgatitjen e institucionit për përfitimin e fondeve nga buxheti i Bashkimit Evropian, ristrukturim, modernizim dhe specializim në produktet dhe tregjet specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit.


Vizioni i AZHBR është:

- akreditimi sa më parë i agjencisë për të përthithur sa më shumë fonde nga Bashkimi Evropian;
- procedimi dhe analizimi i aplikimeve të fermerëve bazuar në rregullat e Bashkimit Evropian për të bërë pagesat nga buxheti i BE-së për këto aplikantë.
- të arrijmë një bashkëpunim dhe mjedis pune eficient me partnerët e agjencisë.
- krijimi i një stafi profesional, të trajnuar dhe të kualifikuar me anë të strategjisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.¹⁶

Në kushtet që Shqipëria vazhdon të jetë një vend neto importues agrar, me 7 herë më shumë importe se sa eksporte, dëshmi kjo për vështirësi në rritjen e konkurrencës së sektorit bujqësor e ushqimor vendas, nxitja e prodhimit bujqësor, nëpërmjet uljes së kostos dhe rritjes së konkurrueshmërisë mbetet një objektivi parësor. Kjo do të arrihet, midis të tjerave, me mbështetjen financiare të bujqësisë, për të patur pritshmërinë e programuar për zhvillimin rural.¹⁷

Një ndër objektivat strategjikë është balancimi i zhvillimit territorial në zonat rurale përmes promovimit të diversifikimit të veprimtarive ekonomike, krijimit të vendeve të punës, përfshirjes sociale dhe përmirësimit të kushteve të jetesës.¹⁸ Në kuadër të strategjisë “Evropë 2020” për një rritje të shpejtë, të qëndrueshme dhe përfshirëse, Shqipëria ka objektivi të përgjithshëm strategjik për t’u anëtarësuar në BE.¹⁹

Skema nr. 2 Skema dhe struktura organizative e AZHBR



¹⁶ <http://www.azhbr.gov.al/agjencia/rreth-nesh/misioni-dhe-vizioni>.

¹⁷ <http://www.kryeministria.al/al/programi/zhvillimi-ekonomik/zhvillimi-urban-rural-dhe-rajonal>.

¹⁸ Strategjia Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020, Shkurt 2016.

¹⁹ Strategjia Ndërkombëtare për Zhvillimin Rural dhe Rrethet, Shkurt 2014, 2000, 2011, 2014.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Burimi: AZHBR, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

AZHBR ka në strukturën e saj Drejtorin e Përgjithshëm dhe 6 drejtori, si: ajo e përzgjedhjes së dhe aprovimit të projekteve, e kontrollit, autorizimit të pagesave, ekzekutimit të pagesave etj., të cilat janë të ndarë në 2 deri në 4 sektorë. Në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm është Sektori i Auditit të Brendshëm dhe Sektori i Riskut, Parandalimit të Mashtrimit, Analizës dhe Raportimit. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil, ndërsa për punonjësit administrativë në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, të cilët gjithsej përbëjnë 123 punonjës.²⁰

1.4.2 Politikat e institucionit/agjencisë

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural kryen me rigorozitet ndjekjen dhe zbatimin e ligjit për bujqësinë nr. 9817, datë 22.10.2007, si dhe të VKM-ve përkatëse “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, si dhe “Për menaxhimin e fondit të mbështetjes për bujqësinë”, të përcaktuara me udhëzime përkatëse.²¹ AZHBR ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural në Republikën e Shqipërisë dhe ka për detyrë:

- ✓ të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, si dhe masa të tjera të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore;
- ✓ të hartojë raportet dhe analizat, në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;
- ✓ të organizojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit;
- ✓ të krijojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave të nevojshme;
- ✓ të zbatojë masat e kontrollit dhe auditit të brendshëm;
- ✓ të organizojë ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut;
- ✓ të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programeve për zhvillimin bujqësor dhe rural.²²

Qeveria ka qenë vijimësisht e shqetësuar dhe përditë e më e vetëdijshme se ajo çka duhet në raport me bujqësinë është një kapërcim epokal nga një bujqësi e mbijetesës tek një bujqësi e dijes e konkurrencës dhe e përfitimit përmes konkurrencës. Nga një bujqësi që është parë tradicionalisht si territori i varfërisë dhe i shpërndarjes së lëmshës, për të ruajtur normat e një mbijetese që asnjëherë nuk mund të kapërcejë vetveten, tek një bujqësi e shembujve të suksesit dhe e zinxhirit të vlerave²³. Kryeministri në një takim promovues për Hartën e Rajonalizimit të Produkteve në nëntor 2014 është shprehur se ka besimin se rritja e efektivitetit të skemës së mbështetjes së fermerëve, përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit, si dhe vendosja gjithmonë e më shumë para syve të të gjithë njerëzve të sektorit dhe shembujve të suksesit që krijojnë zinxhir vlerash, duke sjellë vlerë të shtuar në vitet e ardhshme.

Qëllimi i përgjithshëm i politikave qeveritare është orientimi dhe sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të bimëve bujqësore, e cila përmbledh rritjen optimale të prodhimit për plotësimin sa më mirë të nevojave të vendit, minimizimin e importit dhe rritjen e mundësive për eksport si dhe mbështetjen e menaxhimin e këtij zhvillimi. Qeveria me politikat e saj synon të ndërhyjë për të:

- ◀siguruar përkrahje për industrinë agro-përpunuese;
- ◀mbështetur prodhimet e fermerëve;
- ◀përmirësuar cilësinë e produktit me qëllim që të arrijnë standardet e BE-së;

²⁰ Urdhër nr. 156, datë 01.12.2015 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së agjencisë për zhvillim bujqësor dhe rural”

²¹ <http://www.azhbr.gov.al/agjencia/rreth-nesh/historiku>

²² VKM Nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e AZHBR”.

²³ “Për organizimin dhe funksionimin e Produkteve”. 21 Nëntor 2014.



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

↳siguruar mbrojtjen dhe sigurinë ushqimore për konsumatorin.²⁴

Edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë të vitit 2015 është cilësuar se: “Përgatitjet në bujqësi dhe zhvillimin rural janë në fazë të hershme. Janë bërë disa përpertime në forcimin e kapaciteteve të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor Rural në përpjekje për t’i ngarkuar detyra që lidhen me zbatimin e buxhetit”.

1.4.3 Pesha në buxhet dhe PBB

Programi “Zhvillimi Rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agro-industrial dhe marketingun”, është një nga 8 programet e Ministrisë së Bujqësisë, i cili financohet nga buxheti i shtetit, në shpenzimet kapitale të të cilit përfshihet dhe financimi i huaj. Të dhënat mbi shpenzimet buxhetore në tërësi, të Ministrisë së bujqësisë dhe të programit për zhvillimin rural jepen në pasqyrën e mëposhtme.

Pasqyra nr. 1, Shpenzimet buxhetore për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural 2013-2017

në 000 lekë

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
- Buxheti gjithsej	266.249.303	267.806.090	263.119.142	261.141.978	283.898.175
- Për Ministrinë e Bujqësisë	5.535.830	6.592.006	8.257.044	11.011.786	10.171.456
<i>Në % kundrejt buxhetit gjithsej</i>	<i>2,1</i>	<i>2,5</i>	<i>3,1</i>	<i>4,2</i>	<i>3,6</i>
- Prog. Zhvillimi rural	1.781.200	1.858.338	2.835.221	3.328.090	4.887.653
<i>Në % kundrejt buxhetit ministrisë</i>	<i>32,2</i>	<i>28,2</i>	<i>34,3</i>	<i>30,2</i>	<i>48,1</i>
<i>Në % kundrejt buxhetit gjithsej</i>	<i>0,7</i>	<i>0,7</i>	<i>1,1</i>	<i>1,3</i>	<i>1,7</i>
Financim i huaj	488.000	377.538	795.208	1.142.750	1.927.353
<i>Në % kundrejt programit</i>	<i>27,4</i>	<i>20,3</i>	<i>28,0</i>	<i>34,3</i>	<i>39,4</i>

Burimi: Të dhëna të Ministrisë së Financave të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Programi “Zhvillimi Rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agro-industrial dhe marketingun” në pjesën më të madhe menaxhohet dhe administrohet nga AZHBR, në funksion kryesisht të skemave kombëtare. Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se, shpenzimet buxhetore të këtij programi në periudhën 2013 - 2017 zënë nga 0.7 % deri në 1.7 % të buxhetit vjetor në shkallë vendi, i cili ka ardhur në rritje të vazhdueshme që nga viti 2015. Jo vetëm kaq, por është rritur ndjeshëm dhe raporti i këtyre shpenzimeve ndaj buxhetit gjithsej të Ministrisë së Bujqësisë nga 1/3 në 2013 në pothuajse gjysmën e tyre në vitin 2017. Duhet theksuar që në programin e zhvillimit rural 30 % e shpenzimeve janë me burim financimin e huaj.

Me gjithë rritjen e vlerës së parave të akorduara për zhvillimin rural dhe bujqësor, përsëri madhësia e kësaj mbështetjeje mbetet e vogël në krahasim me vendet e rajonit. Kështu gjatë vitit 2016 në Kosovë janë subvencionuar nga të gjitha burime 22.5 milion euro²⁵, ndërsa në Shqipëri pothuajse gjysma e tyre ose rreth 14.6 milion euro²⁶. Rritja e subvencioneve për bujqësinë dhe burimet buxhetore të kufizuara kërkojnë domosdoshmërisht rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve në skemat kombëtare. Në këtë mënyrë, mbështetja e fermerëve dhe zhvillimi rural kërkojnë sisteme të forta menaxhimi dhe kontrolli.²⁷

²⁴ <http://www.bujqesia.gov.al/al/programi/zhvillimi-rural/bujqesia-dhe-zhvillimi-rural>.

²⁵ http://www.azhb-ks.net/repository/docs/2017_07_20_145614_Raporti_Vjetor_i_AZHB-se_2016.pdf.

²⁶ Të dhëna të AZHBR, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH.

²⁷ Raporti i vitit 2015 për Shqipërinë, Prill 10-11, 2015.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Veç këtyre vendet e rajonit i kushtojnë një vëmendje më të madhe sektorit të bujqësisë, duke i akorduar vlera më të mëdha buxhetore, kështu Maqedonia shpenzon 4.58% të buxhetit gjithsej. Sipas të dhënave të INSTAT bujqësia, pyjet dhe peshkimi në periudhën 2013 - 2015 zënë 16.5 %, 17.2 % dhe 17 % të PBB, pra një përqindje e konsiderueshme. Nga ana e tjetër vërehet se kontributi i bujqësisë në vendin tonë është i ndryshueshëm, pa mundur të evidentojmë prirjen e këtij zhvillimi në raport me degët e tjera të ekonomisë dhe vetë atë në tërësi.


Pasqyra nr. 2 Bujqësia dhe Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) 2013-2015

Emërtimi	2013	2014	2015
PBB gjithsej 000 lekë	2.246.280.008	2.252.544.516	2.333.075.723
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi 000 lekë	369.537.043	386.708.030	397.322.762
<i>Në përqindje ndaj PBB gjithsej</i>	<i>16,5</i>	<i>17,2</i>	<i>17,0</i>
Programi Zhvillimi rural 000 lekë	1.781.200	1.858.338	2.835.221
<i>Në përqindje ndaj PBB gjithsej</i>	<i>0,08</i>	<i>0,08</i>	<i>0,12</i>

Burimi: Të dhëna të INSTAT dhe Ministrisë së Financave, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Krahasuar me vendet e tjera të rajonit, Shqipëria ka përqindjen më të madhe të bujqësisë në GDP, pasi Kosova e ka 13.4 %, Mali i Zi 10.2%, Maqedonia 9.9%, Serbia 8.2% dhe Bosnja dhe Hercegovina 7.8 %, ²⁸ dhe është e kuptueshme që kjo varet nga një numër i konsiderueshëm faktorësh të tjerë. Nga krahasimi i kontributit të bujqësisë në GDP dhe shpenzimeve që i akordohen asaj në tërësi nga buxheti i shtetit, vërehet se ka një diferencë të madhe: mesatarisht 17 % në GDP e përbën bujqësia ndërsa ajo përfiton nga buxheti shtetëror është 3.1 %. Kjo tregon se krahas burimeve të kufizuara të fondeve buxhetore, konstatohet dhe një mungesë kujdesi në financime të sektorit të bujqësisë nga ana e qeverive në Shqipëri, megjithëse është një ndër degët me kontributin më të madh në GDP.

Grafiku nr. 1 Përqindja e sektorit bujqësor në GDP dhe në buxhetin e shtetit 2013-2015



Burimi: Të dhëna të INSTAT dhe Ministrisë së Financave, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

1.4.4 Risqet e aktivitetit të subjektit

Risqet e aktivitetit të subjektit janë ato me të cilat përballlet AZHBR, për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi që lindin nga aktiviteti në tërësi duke u fokusuar në politikat, strategjitë, skemat kombëtare, ndërkombëtare dhe proceset që ndjek ky institucion për zhvillimin rural dhe të bujqësisë. Sektori i bujqësisë, si një nga sektorët më të rëndësishëm për rritjen ekonomike, mbart me vete disa problematika, ku më kryesoret janë implementimi i politikave të ndjekura, i strategjive dhe mënyra e



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

administrimit të fondeve nga skemat kombëtare. Risqet e aktivitetit të AZHBR janë analizuar dhe evidentuar të klasifikuara fillimisht sipas analizës SWOT: fuqitë, dobësitë, shanset, kërcënimet, detajuar në faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Në vijim, grupi i auditimit ka bërë një ndarje të risqeve të veprimtarisë sipas përkatësisë së tyre: brenda dhe jashtë kontrollit menaxherial. Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

Pasqyra nr. 3 Analiza SWOT

Fuqitë (S)	Dobësitë (W)
Partneritetet me ndërkombëtarët	Mungesë e raporteve të monitorimit të investimeve.
	Mungesa e studimeve mbi kërkesën për financime dhe harmonizimin e tyre me burimet të bujqësisë.
Udhëzime, manuale dhe metodologji për kryerjen e funksioneve	Cilësi e ulët e zbatimit të udhëzimeve, manualeve dhe metodologjive.
Struktura e financimit	Cilësia dhe koha e informimit të fermerëve për aplikimin në skemat kombëtare.
	Struktura e formimit profesional i punonjësve në drejtorinë e kontrollit.
	Mungesa e sistemeve të informacionit bujqësor dhe aksesit të AZHBR.
	Mungesa e sektorit të monitorimit për vitet 2013-2015
	Mungesa e mekanizmave për kontrollin e cilësisë së kontrolleve.
	Mungesa e studimeve dhe planeve të veprimit për të rekomanduar strukturën masave në përputhje me strategjinë.
	Mungesë e regjistrave të fermave bujqësore.
	Numri i lartë i procedurave (kërkesë për plotësimin e shumë dokumenteve) gjatë aplikimit.
	Plan-biznese të dobëta dhe pranimi tyre nga AZHBR, duke komprometuar të ardhmen e investimeve.
Plotësimi i numrit të specialistëve në organikë	Përvojë e papërshtatshme e specialistëve me pozicionet e punës.
	Trajnime të përqendruara në numër të kufizuar punonjësish dhe jashtë sferës së skemave kombëtare.
	Largimet e specialistëve dhe bashkë me të e trajnuarve të fushës.
	Ndryshimi i statusit të marrëdhënieve të punës së punonjësve.
	Mungesa e vlerësimit të treguesve të performancës individuale të specialistëve.
	Mungesa e studimeve mbi numrin dhe strukturën organike të punonjësve në përputhje me ngarkesën në punë.
Shanset (O)	Kërcënimet (T)
Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020	Përshtatja e skemave me strategjinë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe të bujqësisë.
	Ndryshimet e kuadrit rregullativ për akordimin e granteve.
Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”	Bashkëpunim i mangët me Ministrinë e bujqësisë, dhe koordinim i pamjaftueshëm me Drejtoritë rajonale të bujqësisë.
	Informacion dhe ndërgjegjësim i pamjaftueshëm i fermerëve mbi mbështetjen financiare, duke reduktuar mundësitë për efektivitetin e skemës.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Mbështetja financiare nga buxheti i shtetit	Mbështetja e ulët financiare nga buxheti i shtetit, krahasuar me atë të vendeve të rajonit
	Shpallja e debitorëve kundrejt skemave dhe përpjekjet politike për të falur detyrimet.
	Efekt i anësor që krijon tek fermerët se një pjesë e financimeve të bujqësisë duhen dhuruar nga shteti.
	Niveli i ulët i formimit të fermerëve rrit subjektivizmin e punonjësve të AZHBR.
	Krahasuar me mbështetjen e investimeve, subvencionet janë një mjet më pak efikas për të nxitur zhvillimin
	Mbështetja financiare nga buxheti i shtetit që ju ofrohet një pjesë të fermerëve dhe për fusha të kufizuara të aktivitetit bujqësor.
	Raporti i pagesave për procese më të lartë se sa ai për investime.
	Kërkesa e lartë për financimin e bujqësisë dhe mundësitë e kufizuara në burime.
	Dështimet në vijimësinë e investimeve pas realizimit
	Klasifikimi i përfituesve dhe pamundësia e financimit dobëson efektet e skemës.
	Aplikimet e përvitshme nga të njëjtët fermerë dhe në skema të ndryshme në të njëjtin vit.
	Numri i lartë dhe kompleks i dokumentacionit të kërkuar për aplikim.
	Ndryshimet e shpeshta të kritereve të përfitimit sidomos në blegtori, rrisin fiktivitetin.
	Pa aftësi të aplikuesve në plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.
Mbështetja financiare nga partnerët e huaj	Konkurrenca rajonale në fushën e produkteve bujqësore
	Aftësia thithëse e vendit tonë të financimeve të BE.
Udhëzime për drejtimin dhe mënyrën e shpërndarjes së fondeve	Cilësia e verifikimeve të aplikimeve dhe klasifikimit të përfituesve.
	Akses i ulët i AZHBR në institucionet e tjera për verifikimin e dokumentacionit të dosjes së aplikantit.
	Mungesë e sistemit të identifikimit të plotë të parcelave të tokës.
	Mungesa e infrastrukturës së nevojshme në fazën e verifikimit dhe monitorimit të granteve.
	Mungesa e transparencës në afishimin e përfituesve, sipas kërkesës së VKM.
	Mungesa e qëndrueshmërisë së masës në periudha 5 vjeçare nga përfitues në zona shumë të varfra.
	Mungesa e studimeve dhe analizave nga AZHBR mbi se sa dhe si kanë kontribuar skemat kombëtare në arritjen e objektivave strategjik në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Burimi: Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancë dhe Grupi i auditimit të KLSH

a) Brenda kontrollit menaxherial

- Mungesë e raporteve të monitorimit të investimeve.
- Mungesa e studimeve mbi kërkesën për financime dhe harmonizimin e tyre me burimet të bujqësisë.
- Cilësi e ulët e zbatimit të udhëzimeve, manualeve dhe metodologjive.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

- Cilësia dhe koha e informimit të fermerëve për aplikimin në skemat kombëtare
- Struktura e formimit profesional i punonjësve në drejtorinë e kontrollit.
- Mungesa e sektorit të monitorimit për vitet 2013-2015.
- Mungesa e mekanizmave për kontrollin e cilësisë së kontrolleve.
- Mungesa e studimeve për të rekomanduar strukturën masave në përputhje me strategjinë.
- Përvojë e papërshtatshme e specialistëve me pozicionet e punës.
- Trajnime të përqendruara në numër të kufizuar punonjësish dhe jashtë sferës së skemave kombëtare.
- Largimet e specialistëve dhe bashkë me të e trajnuarve të fushës.
- Mungesa e vlerësimit të treguesve të performancës individuale të specialistëve.
- Mungesa e studimeve mbi numrin dhe strukturën organike të punonjësve në përputhje me ngarkesën në punë.
- Bashkëpunim i mangët me Ministrinë e bujqësisë, dhe koordinim i pamjaftueshëm me Drejtoritë rajonale të bujqësisë.
- Informacion dhe ndërgjegjësim i pamjaftueshëm i fermerëve mbi mbështetjen financiare, duke reduktuar mundësitë për efektivitetin e skemës.
- Dështimet në vijimësinë e investimeve pas realizimit.
- Aftësia thithëse e vendit tonë të financimeve të BE.
- Cilësia e verifikimeve të aplikimeve dhe klasifikimit të përfituesve.
- Plan-biznese të dobëta dhe pranimi tyre nga AZHBR, duke komprometuar të ardhmen e investimeve.
- Mungesa e infrastrukturës së nevojshme në fazën e verifikimit dhe monitorimit të granteve.
- Mungesa e transparencës në afishimin e përfituesve, sipas kërkesës së VKM.
- Mungesa e studimeve dhe analizave nga AZHBR mbi se sa dhe si kanë kontribuar skemat kombëtare në arritjen e objektivave strategjik në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

b) Jashtë kontrollit menaxherial

- Mungesa e sistemeve të informacionit bujqësor dhe aksesit të AZHBR.
- Mungesë e regjistrave të fermave bujqësore.
- Numri i lartë i procedurave (kërkesë për plotësimin e shumë dokumenteve) gjatë aplikimit.
- Niveli i ulët i formimit të fermerëve rrit subjektivizmin e punonjësve të AZHBR.
- Ndryshimi i statusit të marrëdhënieve të punës së punonjësve.
- Përshtatja e skemave me strategjinë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe të bujqësisë.
- Karakteri sezonal i disa prej produkteve bujqësore.
- Ndryshimet e kuadrit rregullativ për akordimin e granteve.
- Informacion dhe ndërgjegjësim i pamjaftueshëm i fermerëve mbi mbështetjen financiare, duke reduktuar mundësitë për efektivitetin e skemës.
- Mbështetja e ulët financiare nga buxheti i shtetit, krahasuar me atë të vendeve të rajonit.
- Shpallja e debitorëve kundrejt skemave dhe përprjekjet politike për të falur detyrimet.
- Efekti anësor që krijon tek fermerët se një pjese e financimeve të bujqësisë duhen dhuruar nga shteti.
- Krahasuar me mbështetjen e investimeve, subvencionet janë një mjet më pak efikas për të nxitur zhvillimin.
- Mbështetja financiare ju ofrohet një pjese të fermerëve dhe për fusha të kufizuara të aktivitetit bujqësor.
- Kërkesa e lartë për financimin e bujqësisë dhe mundësitë e kufizuara në burime.
- Aplikimet e përvitshme nga të njëjtët fermerë dhe në skema të ndryshme në të njëjtin vit dhe në disa vite.
- Klasifikimi i përfituesve dhe pamundësia e financimit dobëson efektet e skemës.
- Numri i lartë dhe kompleks i dokumentacionit të kërkuar për aplikim.
- Ndryshimet e shpeshta të kritereve të përfitimit sidomos në blegtori, rrisin fktivitetin.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Metoda e përdorur për kategorizimin e riskut në strategjik, financiar, juridik dhe operacional si në tabelën më poshtë është bazuar në gjykimin dhe analizimin e dokumentacionit si dhe ajo intuitive.

Pasqyra nr. 4 Klasifikimi i riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Politikat e Institucionit	Risk Strategjik	I Mesëm
2	Format e financimit		I Mesëm
3	Aftësia për të përfituar nga skemat kombëtare dhe ndërkombëtare		I Mesëm
4	Fondet e akorduara nga buxheti i shtetit	Risk Financiar	I Mesëm
5	Mosrespektim i detyrave funksionale që i ngarkon ligji	Risk Rregullator dhe Juridik	I Mesëm
6	Mosrespektim i udhëzimeve ligjore për administrimin e fondeve të skemave kombëtare dhe ndërkombëtare		I Mesëm
7	Aftësia për të zbatuar strategjinë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe të bujqësisë 2014-2020	Risk Operacional	I Mesëm
8	Përbërja dhe formimi profesional i grupit të kontrollit në terren		I Mesëm
9	Vlerësimi jo i saktë i dosjes së aplikuesit		I Mesëm
10	Mungesa e Sektorit të monitorimit në AZHBR për vitet 2013-2015		I Mesëm
11	Mungesë e koordinimit të drejtorive të AZHBR me njëra-tjetrën		I Mesëm
13	Mungesë e informimit ndaj aplikantit		I Mesëm
14	Kontrolli në terren i projektit		I Mesëm
15	Mungesë e formimit profesional të duhur të stafit		I Mesëm
16	Mosrespektim i afateve për kryerjen e kontrollit administrativ të dosjes së aplikantit nga DPAP.		I Mesëm

Burimi: Përgatitur nga grupi i auditimit të KLSH

1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit

Ligji “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i tetorit 2007, përcaktoi objektivat, masat dhe programimin e politikave bujqësore e të zhvillimit rural, të shërbimeve publike bujqësore, të kërkimit dhe trajnimit profesional, si dhe bazën e të dhënave dhe informacionin për politikën në sektorët e bujqësisë dhe të zhvillimit rural. Politikën bujqësore dhe zhvillimit rural përqendrohen në objektivat dhe masat, që veprojnë drejtpërsëdrejti në tregjet agro-ushqimore dhe të ardhurat nga ferma, krahas zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale, në konvergencën e tyre ekonomike dhe sociale, si dhe në mbrojtjen e mjedisit.

Programi për bujqësinë dhe zhvillimin rural, ka si qëllim të mbështesë zhvillimin e bujqësisë në vend, të garantojë, në mënyrë graduale, efektivitetin e masave të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, duke i kushtuar vëmendje nevojës së planifikimit të zbatimit të projekteve dhe të masave mbështetëse. Burimet financiare të programit sigurohen nga: buxheti i shtetit; donatorët ndërkombëtarë, sipas marrëveshjeve përkatëse; si dhe nga buxheti i bashkisë/komunës. Ky program është i përhershëm dhe administrohet nga ministria, nëpërmjet agjencisë së pagesave.²⁹ Kriteret bazë, sektorët që do të mbështeten dhe masa e përfitimit nga fondi i programit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa procedura dhe mënyra e administrimit të fondit të programit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e bujqësisë dhe Ministrit të Financave. Përfituesit nga fondi i programit nëpërmjet masave, që ndërmerren në kuadër të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, janë:



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

- a) fermerët, grupet e fermerëve, personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë veprimtari bujqësore ose veprimtari ekonomike të lidhur me të;
- b) personat fizikë apo juridikë, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë në industrinë agrourbushqimore;
- c) personat fizikë apo juridikë, të cilët ofrojnë shërbime për veprimtari bujqësore dhe veprimtari të tjera rurale.

Ky ligj ka sanksionuar me nen të veçantë (neni 10), se: masat e politikave bujqësore duhet të harmonizohen dhe të zbatohen në përputhje me parimet e barazisë dhe të efikasitetit. Sipas ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, krijohet Agjencia e pagesave, e cila ka për detyrë të vëre në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural. Është pikërisht Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), e krijuar si agjencia e pagesave që nga tetori i vitit 2008, posaçërisht përgjegjëse për administrimin e fondeve të programit për bujqësinë dhe për zhvillimin rural.

AZHBR si institucioni kryesor për administrimin e fondeve që prej vitit 2009, duke ofruar shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas, luan rol kryesor në dhënien e ndihmës, informimin dhe këshillimin e tyre, duke ndikuar në rritjen e kërkesës për fonde, rritjen e investimeve dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë.³⁰

AZHBR bashkëpunon ngushtësisht për administrimin, zbatimin, kontrollin, vlerësimin dhe ofrimin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë të projekteve vendase, duke dhënë kontribut në: Nxitjen e investimeve në sektorin e bujqësisë, blegtorisë, shpendëve, bletarisë, akuakulturës dhe bimëve medicinale; Përmirësimin e teknologjisë së ujitjes, kultivimit e të mbrojtjes së bimëve, së mbjelljes së fruta perimeve; Mbështetjen e fermave organike dhe blegtorale; Mbrojtjen e ullishteve nga dëmtimi i mizës së ullirit; Furnizimin e qëndrueshëm të tregut dhe rritjen e të ardhurave financiare për familjet në zonat rurale.³¹

1.4.6 Feedback-u i subjektit në përfundim të auditimit

Gjatë fazës së auditimit, drejtuesit dhe stafi i AZHBR i janë përgjigjur në kohë takimeve konsultuese dhe sqaruese, si dhe plotësimit të informacionit të kërkuar. Informacioni i kërkuar, kryesisht me dokumentacionin që lidhet me ligjin dhe aktet ligjore, nënligjore, dosjet e përfituesve të granteve, statistikat për skemat kombëtare 2013-2017, është vënë në dispozicion të grupit të auditimit.

Konstatohet se edhe në nivel rajonal, inspektorët janë treguar bashkëpunues lidhur me verifikimin në terren të zbatimit të masave kombëtare, pa përfshirë aplikimet që bëhen në zyrat qendrore të AZHBR.

Auditimet e herëpashershme nga vetë AZHBR dhe nga institucione të jashtme, përfshirë dhe KLSH, ka ndikuar në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së punonjësve ndaj grupit të auditimit.

Grupi i KLSH, në përfundim të fazës së auditimit në terren, arriti në konkluzionin se stafi dhe specialistët treguan gatishmëri në vënien në dispozicion të mjeteve të punës dhe informacionit të kërkuar.

Drejtuesit, stafi dhe specialistët e AZHBR kanë shfaqur interes dhe janë treguar bashkëpunues mbi rezultatet e këtij auditimi performance, të parin në llojin e vet dhe të mirëfilltë në këtë fushë.

³⁰ VKM nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”.

³¹ KLSH, 2017




2. QASJA DHE DETAJE TË AUDITIMIT

Bazuar në dokumentacionin e grumbulluar dhe të analizuar, të dhënat e kërkuara dhe të plotësuara nga subjekti nën auditim, komunikimet me stafin, pasqyrimin në media të këtij aktiviteti publik, gjatë fazës së auditimit, qasjet audituese që u aplikuan ishin të ndryshme, në varësi të çështjeve të përzgjedhura për t'u shqyrtuar. Për realizimin e qasjes tonë kundrejt realizimit të objektivave të auditimit, është grumbulluar dokumentacioni i nevojshëm si nga pikëpamja cilësore ashtu edhe sasiore. Grupi i auditimit, për të bërë analiza sasiore grumbulloi të dhëna numerike nëpërmjet intervistave që zhvilloi me stafin e AZHBR, pra u përdor qasja sasiore.

Performanca e AZHBR-së, drejtorive dhe punonjësve, në tërësi është e lidhur me zbatimin e detyrave funksionale përkatëse, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave të këtij institucioni. Në këtë mënyrë grupi i auditimit gjatë fazës së auditimit me qëllim marrjen e informacionit cilësor, përdori edhe qasjen cilësore, duke zhvilluar intervista me pyetje të hapura, konkretisht me Drejtorin e Përgjithshëm të AZHBR, Drejtorin e Drejtorisë së Kontrollit, Drejtorin e DPAP, Drejtorin e DEP, Përgjegjësën e SEP, Përgjegjësën e Sektorit të Monitorimit, Përgjegjësën e Sektorit të Auditit të Brendshëm, Specialistin e Protokollit etj. Pra në këtë auditim, grupi përdori edhe qasjen pragmatike, si një miks i dy qasjeve të përmendura më lart.

Duke audituar veprimtarinë e AZHBR për një periudhë pesëvjeçare (2013 - 2017), duke u fokusuar në administrimin e skemave kombëtare, në bazë të të dhënave dokumentare dhe statistikore zyrtare, brenda dhe jashtë institucionit, intervistave, pyetësorëve, konsultave me ekspertë etj., nëpërmjet përdorimit të metodave sasiore, cilësore dhe mikse (pragmatike), u krijua mundësia e vlerësimit objektiv, të qartë, të pavarur dhe profesional të dhënies së granteve.

Skema nr. 3 Metodologjia e kërkimit në Auditimin e Performancës






2.1 Objektivi dhe problemi i performancës

Gjatë kryerjes së këtij auditimi të përformancës, kemi analizuar shkallën e realizimit të objektivave të planifikuara, pra rezultatet e matura kundrejt synimeve dhe atje ku është e mundur edhe burimet e shpenzuara për të arritur këto objektivat. Kjo do të thotë se vend të rëndësishëm dhe kryesor në auditimin e granteve zë *efektiviteti*. Kështu, është detyrim ligjor procesi i administrimit të burimeve njerëzore që përcakton kritere për rekrutimin, trajnimin vlerësimin e specialistëve dhe punonjësve; verifikimet, kontrollet dhe monitorimet jo vetëm që duhet të jenë të cilësore, por duhet të bazohen në risk, pasi kanë ndikim të ndjeshëm në efektivitetin e granteve të dhëna nga AZHBR.

AZHBR, duke qenë një institucion shtetëror buxhetor, përdor fonde nga buxheti jo vetëm për aktivitetin e saj, por dhe në akordimin e granteve për skemat kombëtare. Në varësi të llojit të skemave dhe cilësisë së aktivitetit të saj, kryesisht në investime, AZHBR në dhënien e granteve i krijohen detyrime debitorë, duke ndikuar në efektivitetin e tyre dhe imazhin e financimeve publike për bujqësinë. Veç kësaj, AZHBR-së i vihen në dispozicion strukturë organike e caktuar me specialistë, të cilët nëpërmjet zbatimit të kërkesave të VKM dhe udhëzimeve për skemat kombëtare, duhet të synojnë përmirësimin e efektivitetit të dhënies së granteve. Këto bëjnë të nevojshme matjen e performancës së tyre nëpërmjet *eficiencës*: minimizimit të input-eve (burimeve: financiare, njerëzore dhe/ose materiale), kur rezultatet janë të fiksuara, ose maksimizimin e rezultateve, kur input-et janë fikse.

Skema nr. 4 Përdorimi tre E-ve gjatë auditimit



Burimi: Përgatitur nga grupi i auditimit të KLSH

Duke qenë një veprimtari sa ekonomike por edhe financiare e AZHBR për zhvillimin bujqësor dhe rural, për çështje apo elementë të veçantë brenda tyre, për matjen e performancës, grupi i auditimit ka audituar *ekonomicitetin*: arritjen e një sasive dhe cilësie produkti të përshtatshëm, me çmimet më të ulëta të mundshme.

2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës

Zhvillim i bujqësisë është një çështje ekonomike, financiare e sociale me shtrirjen më të gjerë gjeografike e demografike dhe që ndikon në tërësi mirëqenien e qytetarëve shqiptar. Mbi këtë bazë, qeverisë i linden detyrime për t'u kujdesur në mënyrë të veçantë për këtë sektor të rëndësishëm të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

ekonomisë jo vetëm nëpërmjet politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural, por edhe me mbështetjen financiare në mënyrë prioritare.

Në këtë mënyrë, AZHBR është një nga institucionet më të rëndësishme publike në menaxhimin dhe administrimin e pjesës më të madhe të fondeve buxhetore për zhvillimin e bujqësisë dhe të zonave rurale. Kështu, nga zbatimi i detyrave të specialistëve të AZHBR dhe mbështetjes së tyre me logjistikën e nevojshme varet në mënyrë të konsiderueshme arritja e objektivave për të cilat ju akordohen grantet fermerëve në zhvillimin e bujqësisë.

Nevoja e miradministrimit dhe mirmenaxhimit të granteve nga AZHBR bëhet më e domosdoshme në kushtet kur bujqësia e vendit tonë vuan akoma pasoja të copëzimit të parcelave të tokës, çështjet madhore të pronësisë, mungesën e informimi dhe këshillimit të fermerëve në të gjithë territorin, largimin e fuqisë punëtore aktive etj., të cilat të gjitha sëbashku kërkojnë rritjen e efektivitetit të granteve nga AZHBR.

AZHBR gjatë kryerjes së aktivitetit të saj, duhet të zbatojë përcaktimet në VKM për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Në mënyrë më të detajuar, për menaxhimin dhe administrimin e fondeve buxhetore shërben Udhëzimi i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Financave për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Sipas të dhënave të AZHBR numri i masave përfituesve dhe vlerat e përfituara në periudhën 2013-2016 paraqiten në tabelën e mëposhtme.


Pasqyra nr. 5 Të dhëna mbi masat, aplikuesit, përfituesit dhe fondet e akorduara 2013-2016

Emërtimi	Njësia matjes	2013	2014	2015	2016
Numri i masave	numër	19	15	19	15
Aplikues	numër	6.623	21.186	13.028	23.845
Përfitues	numër	5.601	8.801	12.767	11.516
Fonde buxhetore	lekë	846.608.971	1.218.477.286	1.651.085.729	1.568.175.660

Burimi: Të dhëna të AZHBR, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në fakt numri gjithsej i llojeve të masave është 23, por që disa prej tyre janë alternuar gjatë viteve të kësaj periudhe. Veç këtyre, pavarësisht luhatjes së numrit të përfituesve, fondet buxhetore kanë prirje të rriten për zhvillimin e bujqësisë dhe atë rajonal. Interesat e vendit kërkojnë rritjen e vazhdueshme dhe me ritme të shpejta të financimit bujqësor dhe rrjedhimisht të numrit të përfituesve, të zgjerimit të masave në favor të investimit, në përputhje me strategjinë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor.

Grafiku nr. 2 Ecuria e detyrimeve debitoare 2013-2016



Burimi: Të dhëna të AZHBR, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në aktivitetin e vet, AZHBR ka krijuar debitorë të granteve japoneze; debitorë nga riciklimi i Fondeve Kundërparti; detyrime për dhoma frigoriferike, linja të përpunimit të qumështit dhe fruta perime;



debitorë për naftën dhe të tjerë debitorë mbi 2 miliard lekë.

Gjithashtu, AZHBR ka zhvilluar procedura prokurimi për dy çështje të rëndësishme dhe me peshë në totalin e fondeve numrin e përfituesve për skemat kombëtare: publicitetin dhe mbrojtjen e ullishtave nga miza e ullirit, kur kjo e fundit zë 65.8 % të përfituesve dhe afër 6 % të fondeve në periudhën 2013-2015. Kjo do të thotë se, zbatimi i procedurave të këtyre dy masave është me pasoja të drejtpërdrejta në një numër të konsiderueshëm fermerësh në të gjithë vendin.

Në këtë mënyrë, funksionimi institucional me integritet dhe profesionalizëm i AZHBR-së siguron realizimin e objektivave qeveritare për zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural, si dhe bën të mundur rritjen e efektivitetit të granteve.

2.1.2 Objektivi i auditimit

Zhvillimi i bujqësisë dhe ai rural ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në të gjithë ekonominë e vendit, por veçanërisht në territoret agrare dhe popullsinë përkatëse. Në këtë mënyrë, të gjitha paratë publike të përdorura në këtë drejtim duhet të shkojnë në destinacionin e caktuar dhe të arrihen synimet strategjike dhe afat-shkurtra në sektorin e agrikulturës. dhe të arrijë performancë të lartë dhe që konsumatori, që mund të jetë një individ, fermer ose biznes të përfitojë shërbim me standarde dhe kosto të pranueshme, grupi i auditimit synon që të bëjë një vlerësim mbi efektivitetin e granteve kombëtare në AZHBR, pasi kjo tematikë ka ndikim të lartë social dhe ekonomik të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve, kryesisht të atyre në zonat rurale. Sektori i bujqësisë, për faktin se është një sektor i rëndësishëm, ka përfituar financime nga buxheti i shtetit për zhvillimin e qëndrueshëm të tij, duke rritur shpenzimet buxhetore dhe për pasojë duke ulur mundësinë për më shumë investime në sektorët e tjerë.

Në këtë mënyrë, objekti i këtij auditimi është: Veprimtaria e AZHBR-së gjatë gjithë procesit të aplikimit (informimi, pranimi, kontrolli administrativ i aplikimeve, kontrolli në terren para dhe pas financimit, monitorimit të ecurisë së financimit përgjatë një periudhe kohore të caktuar) si institucioni kryesor në miradministrimin e fondeve të buxhetit të shtetit për zhvillimin e bujqësisë dhe të rajoneve. Gjithashtu, përfshihet në këtë objekt struktura organizative e AZHBR, kapacitetet e burimeve njerëzore, formimin profesional të tyre, me infrastrukturën e nevojshme për realizimin me sukses të objektivave institucional.

Grupi i auditimit të KLSH ka shqyrtuar masat e skemës kombëtare me fondet përkatëse për periudhën pesëvjeçare 2013 - 2017, në ciklin e tyre të plotë, që nga informimi i publikut deri në monitorimin e granteve. Auditimi është fokusuar në masa të veçanta brenda skemës, duke u kushtëzuar nga madhësia grantit, shpërndarja, numri i përfituesve, shtrirja gjeografike, mundësia e verifikimit në terren etj.

2.2 Përkufizimet dhe terminologjia

- **Auditim:** Proces i domosdoshëm i një sistemi rregullator, i cili ka për qëllim të zbulojë devijimet nga standardet e pranuar dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, efijencës, efektivitetit, ekonomikitetit dhe të menaxhimit financiar.
- **Auditimi i performancës:** Shqyrtim i pavarur i efijencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizatave publike, duke iu përmbajtur ekonomikitetit dhe me synim identifikimin e përmirësimeve.
- **Risku:** Mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në aritjen e objektivave të një njësie organizative apo të shoqërisë në tërësi.
- **Grant:** Pagesë nga Autoriteti Kontraktues i cili rimbursos një pjesë të shpenzimeve të pranueshme të bëra nga përfituesi për investimin (projektin) në aktive të luajtshme dhe të paluajtshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

- **Monitorimi:** Mbikqyrja e aktiviteteve në proces, për të siguruar që ato janë sipas procedurës së duhur dhe sipas programeve përkatëse për të arritur objektivat dhe qëllimet e performancës³².
- **Bujqësia:** Veprimtaria ekonomike, e cila ka si objektiv prodhimin e ushqimit për njerëzit, për blegtorinë, të bimëve industriale dhe të karburanteve bio, si dhe të produkteve të tjera, nëpërmjet kultivimit sistematik të bimëve dhe mbarështimit të kafshëve.
- **Fermë:** Njësia ekonomike bazë në bujqësi dhe në veprimtaritë ekonomike që lidhen me atë.
- **Produkt bujqësor:** Produkt bimor apo shtazor, i cili prodhohet në fermë, si dhe produktet që rrjedhin nga faza e parë e përpunimit të këtij produkti bimor apo shtazor.
- **Produkt agro-ushqimor:** Produkti bujqësor dhe produkte të tjera ushqimore të përpunuara.
- **Politikat bujqësore:** Politika shtetërore, që përqendrohen në objektivat dhe masat, që veprojnë drejtpërsëdrejti në tregjet agro-ushqimore dhe të ardhurat nga ferma.
- **Politikë e zhvillimit rural:** Politikë shtetërore, që përqendrohet në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, në konvergencën e tyre ekonomike dhe sociale, si dhe në mbrojtjen e mjedisit.
- **Strategjia e bujqësisë dhe e zhvillimit rural:** Objektivat afatmesme të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, programimi, masat dhe mënyrat se si qeveria planifikon mbështetjen financiare në një periudhë kohore të dhënë, në të mirë të bujqësisë dhe zonave rurale.
- **Bujqësi e qëndrueshme:** Bujqësia, e cila, nga ana ekonomike dhe sociale, është e aftë të mbijetojë dhe që për një periudhë të gjatë nuk e dëmton mjedisin.
- **Prodhimi:** Procesi në të cilin faktorët e prodhimit kombinohen për prodhimin e të mirave dhe shërbimeve.³³
- **Sektor:** një fushë e ekonomisë në të cilën bizneset ndajnë të njëjtin produkt ose shërbim ose të lidhur mes tyre. Mund të mendohet si një industri apo treg që ndan karakteristikat e zakonshme të funksionimit³⁴.
- **Person Juridik:** Organizime kolektive që e drejta i ka njohur si subjekte të veçanta të saj, duke iu dhënë zotësinë për të pasur të drejta dhe detyrime juridike.
- **Aplikanti:** Individ (fermer), person fizik apo juridik i cili dorëzon një aplikim për grant në përputhje me Thirrjen për Dorëzimin e Aplikimeve;
- **Përfituesi (ose përfitues i grantit):** Person fizik apo juridik të cilit i është dhënë një grant për zbatimin e investimit (projektit).
- **Investimi (projekti):** Përbëhet nga një grup aktiviteteve për investime në aktive të luajtshme dhe të paluajtshme që synon përmbushjen e objektivave të sektorëve të mbështetur.
- **Fonde kundërpartit:** janë fonde të dhëna nga qeveria japoneze dhe të mbledhura nga AZHBR.
- **Masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural:** janë instrumentet ligjore dhe financiare për arritjen e objektivave, në përputhje me dokumentet programuese
- **Kërkesat ligjore:** janë kërkesat e përcaktuara nga një ligj, akti nënligjor apo një leje, licencë a autorizim dhe që janë të detyrueshme për t'u respektuar gjatë ushtrimit të një veprimtarie të natyrës tregtare, ekonomike apo profesionale, përfshirë ato kërkesa të detyrueshme për t'u respektuar nga organet publike që ofrojnë shërbime publike.
- **Subjekti i inspektimit:** është çdo person fizik apo juridik, privat apo publik, që ka, sipas ligjit, detyrimin të respektojë një kërkesë ligjore.
- **Inspektim:** është çdo formë kontrolli që organi publik kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.
- **Inspektim rastësor:** është ajo formë inspektimi, në të cilin subjekti i inspektimit është i përcaktueshëm, në mënyrë rastësore në bazë të veprimtarisë së caktuar që kryen.
- **Inspektim i programuar:** është inspektimi që kryhet në bazë të programit të miratuar të inspektimit.

³² <http://www.businessdictionary.com>.

³³ Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural"



- **Inspektimi në vend:** është inspektimi që kryhet në vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit të inspektimit.

2.3. Kriteret

2.3.1 Kriteret e politikës

- Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030.
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020.
- Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020.

2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimi

- Data baza me të dhëna statistikore për përfituesit e skemave kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Auditime të mëparshme nga KLSH, Drejtoria e Auditit të Brendshëm në MBZHRAU, Sektori i Auditit të Brendshëm në AZHBR.
- Studime për zhvillimin e rural dhe bujqësor.
- Buxheti i AZHBR për periudhën e auditimit.
- Plani i veprimit për zbatimin e projektit “Mbulimi i dëmeve në bujqësi dhe ruajtja e kapaciteteve prodhuese”.
- Manuale të implementimit të procedurave për zbatimin e skemave kombëtare 2013-2017.

2.3.3 Kriteret teknike

- Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”
- VKM nr. 1443, datë 31.10.2008 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si Agjencia e Pagesave”, të ndryshuar.
- VKM nr. 709, datë 29.10.2014 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020”.
- VKM nr. 89, datë 16.1.2013 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2013”, të ndryshuar.
- VKM nr. 173, datë 26.3.2014 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, Për Vitin 2014, të ndryshuar.
- VKM nr. 52, datë 21.1.2015 “Për Përcaktimin e Kriterëve Bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2015, të ndryshuar.
- VKM nr. 91, datë 10.2.2016 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2016
- VKM nr. 137, datë 22.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për Bujqësinë Dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2017”.
- Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë nr. 3, datë 30.12.2008 “Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR, si dhe ndarja e detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave mes saj, DRB dhe aktorëve të tjerë të sistemit të bujqësisë”
- Urdhër nr. 156, datë 01.12.2015 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së agjencisë për zhvillim bujqësor dhe rural”
- Udhëzim i MBUMK dhe MF Nr. 1, datë 01.02.2013 Mbi zbatimin e VKM Nr. 89, datë 16.1.2013 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

- përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2013”.
- Udhëzim nr. 4, datë 11.4.2014 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
 - Udhëzim nr. 10, datë 25.06.2014 “Për procedurat, kriteret e përfitimit të huasë, shlyerjes së detyrimeve dhe mënyra e administrimit të fondeve kundërpartit të mbledhura nga grantet Japoneze për sektorin e bujqësisë.
 - Udhëzim i MBZHRAU dhe MF Nr. 4, datë 25.02.2015 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
 - Udhëzim nr. 8, datë 31.03.2017 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar.
 - Rregullore e brendshme e funksionimit të AZBHR dhe për çështje të tjera.

2.3.4 Kriteret e tjera/Praktikat më të mira

- Auditime të performancës mbi sigurinë ushqimore nga përvoja e vendeve të tjera (në se ka).

2.4. Piramida e pyetjeve audituese

Pyetja Kryesore

1. Sa ka kontribuar performanca e AZHBR në efektivitetin e granteve në zhvillimin bujqësor dhe rural?

Nënpyetjet e nivelit 1

1.1 Si ka ndikuar menaxhimi i stafit dhe specialistëve të AZHBR në funksion të zbatimit të procedurave të granteve?

1.2 A është ndikuar efektiviteti i granteve nga performanca e AZHBR në zbatimin procedurës së dhënies së granteve?

1.3 A janë arritur objektivat në administrimin e skemave dhe fondeve për mbështetjen e zhvillimit të bujqësisë?

Nënpyetjet e nivelit 2

1.3.1 A kanë ndikuar fondet për publicitetin në efektivitetin e granteve të dhëna?


1.3.2 Sa efektive kanë qenë financimet buxhetore për mbrojtjen e ullirit në vendin tonë?

1.3.3 A është përdorur me ekonomicitet mbështetja financiare e investimeve në bujqësi?

1.3.4 Sa i ka shërbyer monitorimi i granteve zhvillimit të bujqësisë?



Skema nr. 5 Piramida e pyetjeve të auditimit



Burimi: Përgatitur nga grupi i auditimit të KLSH

2.5 Skema e auditimit

2.5.1 Qasja/Metodologjia audituese

Siç është cilësuar dhe në çështjet e trajtuara më lart, për t'iu përgjigjur pyetjes kryesore nëpërmjet nënpyetjeve të dy niveleve të tjera, u përdor qasja pragmatike, e cila përfshin qasjen sasiore edhe atë cilësore. Kjo qasje u përzgjedh nga grupi i auditimit në varësi të të dhënave dhe dokumentacionit të grumbulluar dhe që përdoret gjatë shtjellimit të tyre.

Pardigma kryesore e këtij auditimi është: *“Rritja e efektivitetit në administrimin e granteve duke kryer detyrat e përkatëse nga AZHBR në eficiencën dhe ekonomicitetin e procesit të dhënies së fondeve, i shërben fuqizimit dhe zhvillimit bujqësor dhe rural”.*

Auditimi i aktivitetit të AZHBR si administruese e granteve, për periudhën 2013-2017, krijon mundësinë e evidentimit të prirjeve në realizimin e objektivave të veprimtarisë saj, duke krahasuar rezultatet me pritshmëritë në zhvillimin e bujqësisë dhe rural. Një analizë e tillë, deri në nivel sektori dhe Drejtorie Rajonale, bën të mundur arrijten e konkluzioneve të sakta e objektive dhe dhënien e rekomandimeve të duhura.

Aplikimi i qasjes pragmatike (si miksim i qasjes sasiore dhe cilësore) siguron një trajtim shterues të performancës së AZHBR në funksion të efektivitetit të granteve, një problem ky me karakter social dhe ekonomik, me ndikim në mirëqenien e qytetarëve, kryesisht të atyre në zonat rurale dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë.



2.5.2 Metodatat & teknikat audituese

- ✓ Analiza dhe krahasimi i akteve normative me situatën gjatë periudhës së auditimit;
- ✓ Analizë sasiore dhe cilësore e informacionit të ofruar nga AZHBR dhe më gjerë;
- ✓ Intervista me stafin e AZHBR në qendër dhe në rajone, Drejtorive Rajonale Bujqësore;
- ✓ Vizita në terren dhe vëzhgime të procedurave inspektuese;
- ✓ Intervista me përfitues të granteve, kryesisht atyre që kanë mundësi verifikimi fizik në terren;
- ✓ Rishikim dhe vlerësim i të dhënave statistikore dhe dokumentacionit të grumbulluar gjatë fazës studimore;
- ✓ Analizë sasiore dhe cilësore e veprimtarisë së drejtuesve, specialistëve dhe punonjësve në përmbushje të detyrave në AZHBR;
- ✓ Studim i auditimeve të ngjashme të kryera nga vendet e tjera.

2.6 Rezultatet e parashikuara

Auditimi i performancës së granteve në AZHBR, duke u fokusuar në efektivitetin e skemave kombëtare, ka rezultuar me një shqyrtim të detajuar të tre elementëve kyç në këtë proces: administrimi i burimeve njerëzore, përfshirë çështje rregullatore dhe të logjistikës së nevojshme së bashku me disa indekse të performancës; analiza e gjithë procedurës së dhënies së granteve (informim, aplikim, përzgjedhje, përfitim, verifikim, monitorim) me rolin e secilës drejtori dhe sektor, duke e mbyllur me vëzhgimeve të drejtpërdrejta në terren të efektivitetit të tyre. Të dhënat, dokumentet, intervistat, pyetësorët, vizitat në terren etj., për skemat kombëtare të shqyrtuara dhe të analizuar për një periudhë 5 vjeçare (2013 - 2017) parashikohet të kenë impakt social kryesisht në popullsinë e zonave rurale.

Paraqitja e problematikave të sektorit të bujqësisë, por kryesisht të problematikave që shoqërojnë dhënien e granteve mundëson që jo vetëm të përmirësohet veprimtaria e AZHBR në tërësi, por edhe zhvillimi ekonomik dhe social në zonat rurale.

Megjithëse segmente të veçanta të AZHBR janë audituar, kontrolluar, nga institucione të tjera shtetërore, nuk ka pasur auditime të performancës të fokusuar në efektivitetin e granteve. Nëpërmjet këtij auditimi jemi përpjekur të bëjmë më transparente veprimtarinë e AZHBR, gjë e cila rrit përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien përballë opinionit të gjerë publik.

2.6.1 Impakti i mesazhit auditues për Kuvendin dhe Qeverinë

Rezultatet e këtij auditimi të performancës do të kenë impakt për Kuvendin, pasi do t'i krijojnë mundësinë të njihet në mënyrë të detajuar dhe të veçantë për problematikën që ka shoqëruar performancën dhe efektivitetin në administrimin e granteve të skemave kombëtare nga AZHBR në funksion të përmirësimit të këtij procesi, me ndikim në jetën ekonomike dhe sociale të popullsisë në zonat rurale të vendit tonë.

Raporti përfundimtar, në të cilin pasqyrohen gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, do të ndikojë për Qeverinë, së pari për të nxitur përmirësimin e kuadrit të nevojshëm rregullator për zhvillimin rural dhe të bujqësisë, si dhe për të forcuar dhe bashkërenduar më mirë veprimtarinë e AZHBR me drejtoritë e bujqësisë, në funksion të përmirësimit të procesit të administrimit të granteve dhe rritjes së efektivitetit të tyre.

2.6.2 Impakti i mesazhit auditues për publikun dhe palët e interesit

Duke audituar efektivitetin e granteve në AZHBR, jemi përpjekur që jo vetëm të bëjmë transparente veprimtarinë e këtij institucioni në shërbim të fermerëve dhe qytetarëve, por nëpërmjet një vlerësimi mbi efektivitetin e granteve të dhëna për zhvillimin bujqësor dhe rural, të ndikojmë në rritjen e përgjegjshmërisë së institucioneve dhe nëpunësve publikë të kësaj fushe, përballë taksapaguesve dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

opinionit publik.

Veç kësaj, duke evidentuar problematikat dhe mangësitë, që kanë shoqëruar veprimtarinë e AZHBR në periudhën 2013 - 2017, sznojmë të ndikojmë në përmirësimin e veprimtarisë së specialistëve dhe inspektorëve të AZHBR, nëpërmjet rekomandimeve përkatëse.

2.6.3 Forma e publikimit

Në përfundim të auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit, i cili i dërgohet subjektit nën auditim Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Një përmbledhje e Raportit Përfundimtar të Auditimit do të publikohet në website-in e KLSH-së dhe rrjetet sociale të Departamentit të Auditimit të Performancës.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është pjesë dhe e Raportit të veprimtarisë vjetore të KLSH-së.

Gjithashtu, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet do të jenë pjesë e workshop-eve periodike të Departamentit dhe KLSH-së.

Pas vendimit të marrë nga Kryetari i KLSH-së për këtë auditim dhe dërgimit të Raportit dhe Rekomandimeve subjektit të auditimit, do të përgatitet një artikull për në median e shkruar.

3. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

Sa ka kontribuar performanca e AZHBR në efektivitetin e granteve në zhvillimin bujqësor dhe rural?

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, i kemi dhënë përgjigje kësaj pyetjeje duke arritur në këtë mesazh auditimi:

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural nuk ka arritur efektivitetin e synuar nga menaxhimi dhe administrimi i fondeve buxhetore për skemat kombëtare, për shkak se:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore ka shfaqur mangësi në strukturimin organik, formimin bazë, rekrutimin, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së tyre etj.;
- Kanë shfaqur mangësi vetë procedurat e subvencionimit për skemat kombëtare të analizuara në dinamikë për kushtet dhe kriteret e përfitimit, si dhe zbatimit të tyre nga ana e AZHBR;
- Fondet e dhëna për informim kanë rezultuar jo efektive, pasi mjetet e komunikimit kanë qenë të kufizuara, informacioni i pamjaftueshëm dhe jo cilësor, nuk është menaxhuar siç duhet etj.;
- Financimet për mbrojtjen e ullirit nuk rezultojnë efektive, pasi nuk janë zbatuar siç duhet procedurat e prokurimit, nuk është vepruar në përputhje me kuadrin rregullator, verifikimet dhe monitorimet për këtë skemë nga AZHBR kanë qenë me mangësi, duke rritur premisat për abuzime nga ana e institucionit;
- Fondet e investimeve të përfituara nuk janë shfrytëzuar si duhet në aspektin ekonomik, për të gjeneruar më pas të ardhura të mjaftueshme për të mbështetur zhvillimin e zinxhirit të vlerës që të mund të zhvillojnë projekte të besueshme për financim;
- Ka munguar sektori i monitorimit për një periudhë 4-vjeçare, e si pasojë edhe monitorimi i skemave kombëtare të vogla dhe investimeve, duke e ulur ndjeshëm efektivitetin e fondeve të dhëna për ato.



3.1. Si ka ndikuar menaxhimi i stafit dhe specialistëve të AZHBR në funksion të zbatimit të procedurave të granteve?

Suksesi i një institucioni varet nga suksesi i punonjësve të tij. Përzgjedhja e një individi të përshtatshëm për një vend vakant punësimi është një vendim shumë i rëndësishëm.

(Amstrong dhe Brown, 2001)

Zhvillimi i një shërbimi publik efektiv, kompetent, të kujdesshëm dhe të fortë në kushtet e institucioneve të dobëta, është një nga sfidat më të rëndësishme për suksesin në vendet në zhvillim. Mënyra se si është strukturuar një institucion publik dhe se si operon brenda fushës përcaktuar, luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, duke e bërë që kapitali njerëzor të jetë kritik në cilësinë e administrimit dhe kryerjes së shërbimeve publike.

Efektiviteti i administratës publike është në varësi direkt të sektorit të burimeve njerëzore. Pra menaxhimi i burimeve njerëzore është pjesë e rëndësishme e funksionit optimal të administratës publike. Përzgjedhja, konkurrimi, trajnimi dhe zhvillimi i stafit dhe specialistëve është një mjet i rëndësishëm dhe strategjik që ndihmon në krijimin e një përparësie të qëndrueshme konkurruese dhe i shton vlerën institucionit. Veprimtaria publike me performancë të lartë çon përpara si performancën individuale dhe atë institucionale.

Në çdo qeveri ndikimi i burimeve njerëzore është thelbësor në kryerjen e shërbimit ndaj qytetarëve dhe taksapaguesve, me kosto të konsiderueshme në buxhet. Mënyrat e të bërit të punëve dhe metodat që zbatohen ndikojnë në efektivitetin e organizatës Për pasojë, institucioni duhet të hartojë dhe të zbatojë politika efikase të burimeve njerëzore, e cila përfshin një grup rregullash dhe rregulloresh, të cilat shërbejnë për realizimin me efektivitet të objektivave institucional për:

- analizën e nevojave të institucionit për numrin e stafit dhe specialistëve që duhet punësuar;
- llojet e profesioneve që duhen punësuar, procesin e rekrutimit;
- përzgjedhjen;
- konkurrueshmërinë;
- vlerësimin e performancës (masat disiplinore);
- kostot e burimeve njerëzore etj.

Gjatë auditimit të kësaj çështjeje, grupi i auditimit shqyrtoj dhe analizoj përfshirjen si pjesë të fokusit të burimeve njerëzore aktivitetet e mëposhtme: zhvillimi i institucionit gjatë periudhës 2013 - 2017, duke analizuar çdo vendim, urdhër apo udhëzim i cili përcaktonte strukturën, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në AZHBR; marrëdhëniet e punonjësve: termat dhe kushtet e punësimit të stafit, paditë gjyqësore të punonjësve për largimin e tyre nga puna; menaxhimi i performancës së punonjësve, i cili përfshin testimin dhe vlerësimin e individual të tyre; analiza dhe përshkrimi i kritereve të vendeve të punës; rekrutimi dhe seleksionimi duke u përshtatur me këto kritere; zhvendosjet dhe transferimet në nivelin e mesëm organizativ; analiza e nevojave për trajnim etj.³⁵

Mbi këtë bazë trajtohen disa tematika kyçe të cilat, reflektojnë një funksion bashkëkohor dhe të konsoliduar të burimeve njerëzore, për të garantuar nëse janë punësuar profesionistët e duhur, në pozicionin e duhur, në kohën e duhur dhe në numrin e duhur. Një numër i konsiderueshëm indikatorësh primar si kostot e funksionimit të burimeve njerëzore, ditë trajnimi për specialist dhe inspektorë, kryesisht në Drejtorinë e kontrollit dhe Përzgjedhjes dhe aprovimit të projekteve, vlerësime etj., si dhe indikatorësh sekondar si: kosto e stafit të kontraktuar, kosto e stafit të pushuar nga puna, rastet e masave disiplinore dhe lloji i tyre etj., ka bërë të mundur arritjen e konkluzioneve të qarta, objektive dhe profesionale.³⁶

³⁵ Indikatorë të performancës, Tiranë, maj 2015

³⁶ Indikatorë të performancës, Tiranë, maj 2015



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

a) Struktura dhe organika e AZHBR përcaktohet nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit, kurse organizimi i brendshëm, ndarja e detyrave, nëpërmjet Udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë,³⁷ si dhe në Rregulloren e brendshme për periudhën 2012 - 2016 dhe nga viti 2016 e në vazhdim³⁸.

Në periudhën 2013 - 2017 struktura ka ndryshuar katër herë, kryesisht në numrin gjithsej të punonjësve dhe shumë pak në strukturën e brendshme. Në vitin 2013, AZHBR përbëhej nga Sektori i auditit të brendshëm dhe 5 drejtori: Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Autorizimit të Pagesave, Drejtoria e Kontrollit, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (secila nga këto drejtori me disa sektorë brenda tyre). Referuar Urdhrit të Kryeministrit³⁹, të ndryshuar, struktura e AZHBR në vitin 2013 ka pasur gjithsej 102 të punësuar, ku numrin më të madh të punonjësve e ka pasur Drejtoria e Kontrollit me 46 punonjës, me Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare me 37 inspektor, ku 1-3 prej tyre ndodhen në çdo qark, e ndjekur më pas nga Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve me 10 punonjës dhe Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave me të njëjtin numër.

Nga takimet dhe intervistat zhvilluar me inspektorët e AZHBR në qendër dhe qark, rezultoi se: *numri i tyre nuk është i mjaftueshëm për të kontrolluar dosjet e aplikuesve dhe përfituesve potencial brenda afatit të caktuar referuar periudhës 2013-2014, duke krijuar në këtë mënyrë vonesa në DEP për ekzekutimin e pagesave ndaj përfituesve, duke sjellë impakt negativ në besimin e fermerëve ndaj granteve në bujqësi.* Në vitet 2013 dhe 2014 referuar Urdhrit të Kryeministrit⁴⁰ struktura e AZHBR nuk ka pasur ndryshime të theksuara, me përjashtim të Drejtorisë së Kontrollit, numri i së cilës ishte 41 punonjës.

Në vitin 2015 struktura e AZHBR pëson ndryshime vetëm në numrin e punonjësve, i cili shkon në 131 punonjës gjithsej, nga 102 që ishte më parë. Rritja më e madhe është në Drejtorinë e Kontrollit, e cila ka arritur në 70 specialistë, ku pjesën kryesore të saj e zë Sektori i Kontrollit të Skemave Kombëtare me 63 inspektorë, pra 48 % e totalit të punonjësve.⁴¹ *Rritja e numrit të stafit sipas strukturës së re të miratuar në vitin 2015, kryesisht në sektorin e kontrollit të skemave kombëtare, përballë mungesës së infrastrukturës së nevojshme për të realizuar në mënyrë të saktë, të plotë dhe brenda muajve qershor-tetor, kontrollin e skemave kombëtare, ka ulur ndjeshëm efektivitetin e këtij funksionit kontrollues dhe atë të skemave kombëtare në përgjithësi.* Brenda këtij viti struktura e AZHBR pëson ndryshime të konsiderueshme në përbërjen e saj dhe numër punonjësish, të cilat vazhdojnë të mbeten edhe aktualisht: ndryshimet në Drejtorinë e Kontrollit ku numri i punonjësve të Sektorit të Kontrollit të Skemave Kombëtare është ulur nga 63 në 34 specialist, pra 28% e totalit të strukturës, për të cilën theksojmë se është numri më i ulët për gjatë periudhës pesëvjeçare 2013-2017. *Në këtë mënyrë, AZHBR ka dobësuar rolin kontrollues duke evidentuar prirje të kundërt me rritjen e fondeve buxhetore për zhvillimin e bujqësisë dhe rural.* Gjithashtu në këtë Drejtori, në dhjetor të vitit 2015, shtohet Sektori i Monitorimit të Skemave, me 5 specialist në përbërje, *një sektor ky që ka munguar për vite me radhë, por i rëndësishëm për rolin që duhet të ketë, kryesisht atë të monitorimit të ecurisë së investimeve dhe jo vetëm. Pra e thënë ndryshe, për të vlerësuar në se fondet e dhëna nga AZHBR për mbështetjen e investimeve, kanë rezultuar efektive dhe kanë ndikuar në zhvillimin bujqësor dhe rural, duke përcaktuar dhe masat që duhen marrë për eliminimin e mangësive.* Rrjedhimisht, ky sektor duhej të ishte krijuar që në momentin që AZHBR ka filluar të japë subvencione për investimet në masën 50-60%, e lidhur dhe me objektivin kryesor të AZHBR për rritjen e efektivitetit të investimeve në zhvillimin e bujqësisë në vendin tonë.

³⁷ Udhëzim nr 3, datë 30.12.2008 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR, ndarjen e detyrave, përgjegjësisë, dhe kompetencave mes saj dhe aktorëve të tjerë të sistemit të bujqësisë dhe ushqimit”

³⁸ Rregullore e Brendshme AZHBR 10.02.2016-

³⁹ Urdhër i Kryeministrit nr. 37, datë 26.03.2012 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

⁴⁰ Urdhër i Kryeministrit nr. 67, datë 13.02.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”

⁴¹ Urdhër i Kryeministrit nr. 52, datë 22.04.2015 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”




KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

Struktura aktualisht ka 123 punonjës gjithsej, e organizuar në 6 drejtori me 16 sektorë, si dhe 2 sektorë që varen nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR: Sektori i Auditimit të Brendshëm dhe Sektori i Riskut. Lidhur me numrin gjithsej të punonjësve konstatohet një prirje negative e zvogëlimit të punonjësve që angazhohen direkt me kontrollin dhe monitorimin e skemave kombëtare, dy nga aktivitetet më të rëndësishëm të AZHBR, që ndikojnë drejtpërdrejt në efektivitetin e granteve të dhëna, krahasuar me numrin e skemave kombëtare, shtrirjen e gjerë territoriale të fondeve dhe vlerën e rritur në mënyrë të përvitshme.

Veç kësaj, referuar praktikave të mira të vendeve të rajonit si Kosova, por edhe domosdoshmëria e këtij funksioni, nga grupi i auditimit është evidentuar, se ka munguar një sektor eficient, për informimin dhe këshillimin e fermerëve, lidhur me procedurat që duhet të ndjekin dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë në AZHBR, duke ndikuar negativisht në numrin e aplikuesve dhe duke ulur numrin e përfituesve nga skemat kombëtare.

Grafiku nr. 3 Numri i përfituesve dhe specialistëve në Sektorin e kontrollit 2013 - 2016



Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Kjo situatë paraqitet edhe në grafikët e mësipërm, ku duket një trend zbritës i inspektorëve të kontrollit në vitin 2014 dhe 2016, në krahasim me numrin e përfituesve nga skemat kombëtare. Konkretisht nga viti 2013 në vitin 2014 kemi ulje të numrit të inspektorëve të kontrollit krahasuar me rritjen e numrit të përfituesve nga viti 2013 në 2014. Kjo dukuri pasqyrohet edhe në vitin 2016, ku megjithëse kemi një ulje të lehtë të numrit të përfituesve nga viti 2015, me 1202 përfitues, nga ana tjetër për këtë periudhë kemi përgjysmim të numrit të inspektorëve të kontrollit duke u ulur me 27 inspektor.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se: për vitet 2013-2017 kanë munguar analiza, studime si dhe plane-veprimi, se sa duhet të jetë numri i specialistëve të nevojshëm, sa duhet të jetë numri i inspektorëve në nivel qarku për një kontroll sa më efektiv të skemave, cili duhet të jetë lloji i profesionit që duhet të mbizotërojë në strukturën e AZHBR në total, po ashtu edhe brenda drejtorive, ku sipas aktivitetit që kryhen AZHBR, profesioni që duhet të mbizotërojë duhet të jetë i fushës së bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Gjithashtu, referuar strukturës së AZHBR për periudhën 2013 - 2017, lidhur me numrin e planifikuar të burimeve njerëzore në strukturë sipas Urdhrit të Kryeministrit, ku në vitin 2015 duhet të ishin 131 të punësuar, rezultoi se: faktikisht kanë qenë 102 të punësuar, gjë që krijon bindjen e arsyeshme të grupit të auditimit për të dalë në konkluzionin se së paku për katër muaj në Drejtorinë e kontrollit të AZHBR ka pasur performancë të munguar, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në efektivitetin e granteve të dhëna.

b) Trajnimi konsiderohet një elementë i rëndësishëm në zhvillimin e burimeve njerëzore në përgjithësi, i cili shërben për rritjen e performancës së administratës publike dhe që veprimtaria e saj të jetë sa më efektive. Trajnimet në nivel departamenti apo në grupe më të vogla duhet të shoqërojnë veprimtarinë e secilit punonjës të AZHBR.

Grupi i auditimit, për të pasqyruar ecurinë e trajnimeve në AZHBR, analizoj informacionin mbi periudhën, pjesëmarrësit, temat dhe llojet e trajnimit për secilin punonjës, duke u përqendruar në specialistët e Drejtorisë së Kontrollit dhe Drejtorisë së Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, në cilësinë e drejtorive të një rëndësie të veçantë në AZHBR.

Gjatë analizës së këtij informacioni rezultoi se trajnimet:

- janë të përqendruara në një numër punonjësish, konkretisht inspektorët në Drejtorinë e Kontrollit AZHBR në qendër kanë nga 20-30 ditë trajnimi, kurse inspektorët e qarqeve kanë 1-2 ditë trajnimi;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

- *nuk janë në përputhje me nevojat e çdo drejtorie të AZHBR, pasi inspektorë të kontrollit të skemave kombëtare, trajnohen për procedurat IPARD, sigurinë ushqimore, dhe tema të tjera të cilat nuk ndihmojnë drejtpërdrejtë në rritjen e performancës në aktivitetin e kontrollit;*
- *janë të pabarabarta referuar përvojës në punë, nuk kanë një lidhje logjike lidhur me vitet e punës në AZHBR dhe ditët e trajnimit në të cilat ka ndryshime të theksuara, ku p.sh punonjës që kanë 6 vite eksperiencë në AZHBR kanë 1-2 ditë trajnimi dhe punonjës me 2 vite eksperiencë kanë nga 18-20 ditë trajnimi;*
- *nuk i kanë shërbyer rritjes së performancës së punonjësve me vlerësime mesatare dhe të dobëta, duke i përfshirë më pak në aktivitetet e trajnimit, për të cilët duhet të jetë i domosdoshëm trajnimi me qëllim rritjen e nivelit të aftësive dhe arritjen e rezultateve të mira në punë.*

Referuar të dhënave të mësipërme, arrihet në konkluzionin se: *trajnimet nuk kanë qenë efektive, pa ndonjë ndikim në performancën e punonjësve, kryesisht të inspektorëve të kontrollit në nivel qarku, me efektivitet të ulët të kësaj veprimtarie dhe rrjedhimisht edhe të granteve të dhëna.*

c) *Vlerësimi i Performancës së stafit dhe specialistëve nëpërmjet vendosjes dhe kontrollit të treguesve të matshëm është një faktor i rëndësishëm për përmirësimin e produktivitetit dhe efikasitetit individuale. Vlerësimi i punës sipas VKM nr. 109, datë 26.02.2014⁴² duhet të bëhet çdo gjashtë muaj, duke patur parasysh që çdo nëpunës vlerësohet për kryerjen e funksionit ashtu siç duhet. Është e rëndësishme që të kuptohet se qëllimi kryesor i këtij vlerësimi është që eprori direkt ashtu dhe punonjësi të dinë objektivat e punës dhe si duhet kryer ajo. Kontrolli në vijimësi i kryerjes së punës gjatë periudhave të mëparshme dhe vendosja e piketave për të ardhmen, janë dy qëllimet kryesore për çdo program vlerësimi. Një sistem vlerësimi duhet që të krijojë ndjenjën e sigurisë tek punonjësit që të gjitha punët e ngjashme vlerësohen sipas kriterëve të njëjta. Në këtë mënyrë i jepet ndihmë punonjësit të kryejë punën me efektivitet.*

Vlerësimi i rezultateve në punë ka të bëjë me vlerësimin e realizimit të objektivave dhe e sjelljes profesionale.⁴³ Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion grupit të auditimit, u evidentua se: *rreth 24 % e të punësuarve nuk kishin akoma vlerësimin e performancës, megjithëse në dosjet e tyre personale ekzistonin masa disiplinore për arsye të ndryshme. Nuk ka patur analiza për mënyrën se si bëhet vlerësimi i performancës. Gjithashtu nga të dhënat e vëna në dispozicion për vlerësimin e performancës dhe masat disiplinore për punonjësit, gjenden tre punonjës me 3-4 masa disiplinore, për mos respektim të orarit, sjellje jo korrekte, të cilët vazhdojnë aktualisht të ushtrojnë detyrën.*

d) *Qëllimi i përgjithshëm i rekrutimit është: t'i siguroj institucionit një numër kandidatësh të kualifikuar; të ndihmoj rritjen e treguesit të suksesit të procesit të seleksionimit, duke ndikuar në pakësimin e numrit të aplikantëve me kualifikim më të vogël apo më të madh sesa duhet; të koordinoj përpjekjet e rekrutimit me programet e seleksionimit dhe të formimit; të vlerësoj efektivitetin e teknikave dhe të burimeve të ndryshme të rekrutimit për të gjithë llojet e aplikantëve dhe të plotësoj përgjegjësinë sociale të institucionit lidhur me përbërjen e forcës punëtore.*

Në periudhën 2013-31.10.2014, procesi i rekrutimit në AZHBR, referuar VKM nr. 1443 është zhvilluar sipas rregullave të përcaktuara në Ligjin "Për shërbimin civil"⁴⁴ dhe për punonjësit administrativ me Kodin e Punës⁴⁵.

Me miratimin e VKM nr. 719 në nëntor të vitit 2014 deri në 22 Dhjetor 2016⁴⁶, procesi i rekrutimit është zhvilluar sipas rregullave të Kodit të Punës⁴⁷.

Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin e vënë në dispozicion lidhur me: kontratat e punës, kriteret specifike të përcaktuara dhe largimet nga puna pas gjykimit profesional, si dhe komunikoj dhe intervistoj përgjegjësin e sektorit juridik. Nga kjo rezulton se janë larguar nga puna 94 punonjës

⁴² VKM Nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil"

⁴³ VKM Nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil"

⁴⁴ LIGJ Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"

⁴⁵ Kodi i Punës miratuar me ndryshimet në Ligjin Nr. 9125, datë 27.09.2003.

⁴⁶ VKM Nr. 719, datë 31.10.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural"

⁴⁷ Kodi i Punës miratuar me ndryshimet në Ligjin Nr. 9125, datë 27.09.2003.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

(përafërsisht 77 % e punonjësve gjithsej), nga të cilët 30 në periudhën 2013-2014 jashtë çdo kriteri ligjor. Në këtë problem ka pasur ndikim të konsiderueshëm ndryshimi i statusit të punonjësve nga shërbimi civil në marrëdhëniet me Kod pune, duke ulur nivelin e mbrojtjes së të punësuarve dhe për pasojë dhe performancën e tyre. E lidhur drejtpërdrejtë me efektivitetin e granteve të skemave kombëtare të zhvillimit të bujqësisë. Veç kësaj, kjo ka sjellë rekrutimin sipas kriterëve të vendosura nga titullari të cilat përbëjnë një risk të konsiderueshëm për efektivitetin e granteve.

Në fund-dhjetorin e vitit 2016 është miratuar VKM nr 877 për disa ndryshime në VKM nr. 719 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, ku është përcaktuar që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas ligjit “Për nëpunësin civil” dhe për punonjësit administrativ sipas Kodit të punës, sipas të cilit vepohet dhe aktualisht.

Grupi i auditimit bëri një analizë të llojeve të profesioneve të të punësuarve në AZHBR gjithsej dhe në Drejtorinë e kontrollit, për të vlerësuar prirjen e llojit të profesioneve nëse shkojnë në drejtim të njëjtë me aktivitetet kryesore që kryen AZHBR.

Nga tabela e mëposhtme shohim se një përqindje të lartë prej 48 % të strukturës e zënë profesionet që i përkasin profilit Ekonomik, Juridik dhe Social; 44% e zënë profesionet që përshtaten me aktivitetet e AZHBR pra të karakterit bujqësor, blegtoral dhe zhvillimit rural, si dhe 8% profesione jashtë kësaj fushe.

Pasqyra nr. 6 Llojet e profesioneve 2013 - 31.03.2017

Nr Total i punonjësve	Llojet e Profesioneve në Total	Nr	% ndaj Totalit	Nr Total i punonjësve në DK	Llojet e Profesioneve në DK	Nr	% ndaj Drejtorisë
117	Profili Ekonomik, Juridik dhe sociale	56	48%	48	Profili Ekonomik, Juridik dhe sociale	15	32%
	Profili Bujqësor, Agrar që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e AZHBR	52	44%		Profili Bujqësor, Agrar që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e AZHBR	28	58%
	Profesione jo të fushës	9	8%		Profesione jo të fushës	5	10%
Total		117	100%	Total		48	100%

Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga analiza e kryer për të dhënat e profesioneve në Drejtorinë e Kontrollit, rezulton se një përqindje të konsiderueshme e zënë ato të profilit ekonomik, juridik dhe social, por këtu gjejmë edhe ata punonjës me profil ushtaraku, këmbësorie etj.

Referuar të dhënave të mësipërme, grupi i auditimit, arrin në konkluzionin se: mbizotërimi i profesioneve që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet kryesore të AZHBR, afërsisht 64 % e profesioneve, si dhe rekrutimi i një pjesë të konsiderueshme të punonjësve në sektorin e kontrollit përgjatë viteve 2013-2017 jo në përputhje me kriteret e përcaktuara nga vetë AZHBR për pozicionin e Inspektorit të Kontrollit, ka ndikuar negativisht në realizimin e objektivave të AZHBR, kryesisht atë të përzgjedhjes, kontrollit dhe monitorimit të projekteve, duke sjellë efektivitet të ulët të tyre.

Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin e çështjeve gjyqësore shoqëruar më kostot financiare për periudhën 2013-2017 për largimet nga puna 2013-2017 si dhe informacion mbi trajnimet dhe punonjësit e trajnuar, duke u përqendruar në çështje të rëndësishme si:

- si janë larguar punonjësit e AZHBR për periudhën 2013-2017
- kanë qenë ligjore largimet e tyre nga puna apo jo;
- çfarë peshe kanë zënë kostot gjyqësore të AZHBR ndaj totalit të pagave për çdo vit;
- si kanë ndikuar largimet nga puna në performancën e aktivitetit të AZHBR, kryesisht atë të kontrollit dhe monitorimit;
- nëse punonjësit e larguar kanë qenë më të kualifikuarit, më të trajnuarit, çka ndikon drejtpërdrejtë në uljen e efektivitetit, uljen e performancës së aktiviteteve që kryen AZHBR, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

Nga analiza e këtij dokumentacioni për periudhën 2013-2017, rezulton se: në një masë të madhe janë kryer largime të punonjësve pa shkaqe të arsyeshme, rreth 94 punonjës të larguar, nga të cilët 49 janë larguar sipas Kodit të Punës dhe pa arsye, 43 prej tyre kanë dhënë dorëheqje. Nga të larguarit pa shkaqe të arsyeshme, kryesisht janë Inspektor Kontrolli, Përgjegjës Sektori dhe Drejtor Drejtorie, prej të cilëve, 41 prej tyre kanë hapur çështje gjyqësore ndaj AZHBR dhe kanë rezultuar fitues, pra 78% e të larguarve. Gjithashtu grupi i auditimit pasi shqyrtoi me kujdes çdo dosje gjyqësore, krijoi bindjen e arsyeshme se:

Afërsisht 62% e të larguarve janë nga Drejtoria e Kontrollit të Granteve për zhvillimin bujqësor dhe rural, ku një pjesë e konsiderueshme e tyre janë me 3-6 vite eksperiencë në AZHBR në pozicionet përkatëse dhe me formimin e dubur profesional, rreth 30 prej tyre janë me formim të lartë shkollimi në profilin bujqësor dhe zhvillim rural. Këto veprime kanë ndikuar negativisht në efektivitetin e aktivitetit të AZHBR, kryesisht në atë kontrollues, ku kanë qenë edhe largimet më të shumta. Kështu, largimet nga puna kanë ulur ndjeshëm efektivitetin e AZHBR në kontrollin dhe monitorimin e granteve të dhëna.

Gjithashtu të gjithë punonjësit e mësipërm nuk janë larguar sipas përcaktimit në VKM 1443⁴⁸, Udhëzimit të Ministrisë të MBUMK,⁴⁹ ku shprehet se rekrutimi dhe largimi nga puna i punonjësve të AZHBR, përjashtuar ata administrativ, bëhet sipas procedurave të shërbimit civil, por janë larguar sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin e Punës, çka forcon edhe më shumë konkluzionin e grupit të auditimit se, ndryshimi i rregullimit të marrëdhënieve të punës ka ndikuar negativisht në performancën e punonjësve dhe AZHBR në tërësi.

Grupi i auditimit bëri dhe një analizë financiare, se sa kanë qenë kostot totale të shpenzimeve gjyqësore ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara për pagat për vitet respektive, dhe arriti në përfundimin se, kostot financiare gjyqësore zënë një peshë të konsiderueshme ndaj fondit total të pagave, afërsisht 20 %, çka do të thotë se, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të AZHBR është shpenzuar në mënyrë jo efektive. Largimet nga puna pa kriter, pa shkaqe të arsyeshme ligjore, kryesisht në muajt nëntor - dhjetor 2013 dhe janar-shkurt 2014, është periudhë e cila përkon me ndryshime në nivelin e lartë drejtues

Pasqyra nr. 7 Kostot financiare 2013 – 31.03.2017

Kostot Gjyqësore	
Totali i Shpenzimeve Gjyqësore për të Larguarit nga Puna 2013- 31.06.2017	Totali i shpenzimeve të pagave realizuar për vitet 2013- 31.09.2017
85,940,396.00	455,340,649.00
Në % ndaj Totalit të pagave = 20 %	

Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Si konkluzion:

- Numri i inspektorëve të kontrollit në nivel qarku nuk ka qenë i mjaftueshëm për të kontrolluar dosjet e aplikuesve dhe përfituesve potencial brenda afatit të caktuar për vitet 2013-2014, duke krijuar në këtë mënyrë vonesa në DEP, për ekzekutimin e pagesave ndaj përfituesve, për pasojë ndikim negativ në besimin e fermerëve ndaj granteve në skemat kombëtare të bujqësisë.
- Konstatohet një prirje negative e zvogëlimin të numrit të inspektorëve dhe specialistëve që angazhohen direkt me kontrollin dhe monitorimin e skemave kombëtare, dy nga aktivitetet e një rëndësie të veçantë për AZHBR, në raport me numrin e skemave kombëtare, numrin e përfituesve që

⁴⁸ VKM Nr. 1443, datë 31.10.2008 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si Agjencia e Pagesave"

⁴⁹ Udhëzim nr 3, datë 30.12.2008 "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR, ndarjen e datuar në nivelin e lartë drejtues me një pjesë të funksionimit të brendshëm të AZHBR dhe ndryshime"



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

duhet të kontrollojnë, shtrirjen e gjerë territoriale të investimeve që financohen, si dhe rritjes së përvitshme të vlerës së fondeve buxhetore, me pasoja në uljen e efektivitetit të granteve të dhëna.

- Mungesa e studimeve, analizave dhe të planeve të veprimit për përcaktimin e numrit të punonjësve në strukturën totale të AZHBR, por edhe të drejtorive në veçanti, si dhe të llojit të profesionit që duhet të mbizotërojë në strukturë, ka shkaktuar ulje të efikasitetit në kryerjen e detyrave dhe uljen e efektivitetit në realizimin me sukses të objektivave.
- Për vitin 2015 AZHBR, si pasojë e mungesave në staf, kryesisht në drejtorinë e kontrollit, ka pasur performancë të ulët, duke ndikuar negativisht edhe në efektivitetin e granteve.
- Për një pjesë të konsiderueshme të punonjësve të AZHBR, 23 për totalit, ka munguar vlerësimi i performancës, gjë që përbën shkak për uljen e motivimit në punë, mos evidentimin e problematikave si dhe mos realizimin me sukses të detyrave funksionale.
- Kalimi i statusit të punonjësve nga shërbimi civil në kod pune në AZHBR, përbën një risk të konsiderueshëm në marrëdhëniet e punës së punonjësve me institucionin, sepse në këtë mënyrë Titullari ka liri veprimi në rekrutimin, seleksionimin dhe largimin nga puna të punonjësve. Gjithashtu trajtimi i marrëdhënieve të punës nëpërmjet kodit të punës rrit pasigurinë e punonjësit për vendin e punës, ndikon negativisht në motivimin si dhe ul performancën e tij në punë.
- Mbizotërimi i profesioneve që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet kryesore të AZHBR, afërsisht 54 % e profesioneve, si dhe rekrutimi i një pjesë të konsiderueshme të punonjësve në sektorin e kontrollit përgjatë viteve 2013-2017 në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga vetë AZHBR për pozicionin e Inspektorit të Kontrollit, ka ndikuar negativisht në realizimin me sukses të objektivave të AZHBR, kryesisht atë të përzgjedhjes, kontrollit dhe monitorimit të projekteve, duke i bërë këto të fundit jo efektive.

Për këto rekomandojmë:

1. AZHBR të kryejë analizë, studime, si dhe të hartojë dhe të kërkojë zbatimin e planeve të veprimit për numrin e punonjësve në strukturën e saj, llojet e profesioneve, veçanërisht në sektorin e kontrollit dhe të monitorimit të skemave kombëtare, sektorin e përzgjedhjes dhe aprovimit të projekteve për të rritur performancën e tyre, si dhe efektivitetin e granteve.

Brenda gjashtëmuorit të parë 2018

- Mungesa e një sektori në AZHBR, për informimin dhe këshillimin e fermerëve për procedurat që duhet të ndjekin dhe dokumentacionin standard që duhet të dorëzojnë në AZHBR, e cila ka ndikuar negativisht në numrin e aplikuesve, duke ulur numrin e tyre, të përfituesve nga skemat kombëtare, është përgjegjësi i drejtimit të institucionit.

Për këtë rekomandojmë:

2. AZHBR të marrë masat e nevojshme për krijimin e sektorit që shërben për informimin dhe këshillimin e fermerëve, me qëllim shmangien e gabimeve, vonesave gjatë përgatitjes së dokumentacionit si dhe penaliteteve që ndodhin gjatë kontrollit të aplikimeve.

Brenda gjashtë muorit të parë të 2018

- Rritja e numrit të stafit sipas strukturës së re të miratuar në vitin 2015, kryesisht në sektorin e kontrollit të skemave kombëtare, përball mungesës së infrastrukturës së nevojshme për të realizuar në mënyrë të saktë, të plotë dhe brenda kohës së caktuar kontrollin e skemave kombëtare, ka ulur ndjeshëm efikasitetin dhe efektivitetin e këtij funksioni.

Për këtë rekomandojmë:

3. AZHBR të hartojë dhe të zbatojë një program të veçantë investimi me prioritet të evidentuara për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për kontrollin dhe monitorimin e skemave kombëtare si: GPS, Odometër, kuti e ndihmës së shpejtë etj., në funksion të rritjes së efektivitetit të granteve në bujqësi.

Brenda gjashtë muorit të parë të 2018

Ky rekomandim është vlerësuar dhe konfirmuar dhe nga observacionet e AZHBR, me nr. 639/3 prot., datë 29.12.2017, dhe janë shprehur se po diskutohet me Bankën Botërore për mjetet e kontrollit.

- Trajnimet nuk kanë rezultuar eficientë dhe efektive, për shkak se: nuk janë në përputhje me nevojat e cdo drejtorie të AZHBR, inspektorë të kontrollit të skemave kombëtare, trajnohen për tema të cilat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

nuk ndihmojnë drejtpërdrejtë në rritjen e performancës, duke ulur efektivitetin e aktivitetit të kontrollit, janë të përqendruara në një numër punonjësish, janë të pabarabarta referuar viteve të eksperiencës, nuk kanë lidhje logjike me vitet e punës në AZHBR dhe ditët e trajnimit, duke ndikuar negativisht në performancën e atyre punonjësve që përbëjnë vazhdimësinë e institucionit, çka ka sjell uljen e performancës së punonjësve, kryesisht të inspektorëve të kontrollit në nivel qarku, duke ulur edhe efektivitetin e kontrollit dhe monitorimit të granteve të dhëna.

Për këtë rekomandojmë:

4. AZHBR të kryejë trajnime jo në numër të përqendruar punonjësish, por të jenë gjithë përfshirëse. Inspektorëve të kontrollit në nivel qarku t'u kushtohet më shumë vëmendje në këtë drejtim. Gjithashtu trajnimet të kenë një lidhje logjike midis eksperiencës në AZHBR, midis vlerësimit të performancës dhe nevojës për trajnime. Gjithashtu të kryejë vlerësimet e performancës dhe të marrin masat e nevojshme për punonjësit që kanë më shumë se dy masa disiplinore.

Vazhdimisht

Ky rekomandim është vlerësuar dhe konfirmuar dhe nga observacionet e AZHBR, me nr. 639/3 prot., datë 29.12.2017, dhe janë shprehur se AZHBR në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike doë programojë trajnime kualifikuese në përputhje me misionin dhe nevojat e stafit.

- Afërsisht 62% e të larguarve janë nga Drejtoria e Kontrollit, ku një pjesë e konsiderueshme (30 prej tyre) janë me 3-6 vite eksperiencë në AZHBR në pozicionet përkatëse dhe me formimin e duhur profesional. Këto veprime nga ana e Titullarit të Institucionit kanë ndikuar negativisht në vazhdimësinë e ushtrimit të aktiviteteve të AZHBR, por kryesisht në aktivitetin e kontrollit, ku kanë qenë edhe largimet më të larta, të cilat kanë sjellë uljen e performancës por edhe performancën e munguar, si pasojë e vendeve pune bosh të krijuara, duke ulur efektivitetin në kontrollin dhe monitorimin e granteve.

- Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të AZHBR është shpenzuar në mënyrë jo efektive për proceset gjyqësore, dukuri, e cila ka ardhur prej largimeve nga puna pa kriter, pa shkaqe të arsyeshme, kryesisht në muajt Nëntor-Dhjetor 2013 dhe Janar-Shkurt 2014, një periudhë e cila përkon me ndryshimin e drejtimit të institucionit.

Për këto rekomandojmë:

5. AZHBR të analizojë dhe të evidentojë përgjegjësinë për largimet nga puna pa shkaqe ligjore, duke marrë masat e nevojshme për të shmangur përsëritjen e tyre në të ardhmen.

Vazhdimisht

3.2 A është ndikuar efektiviteti i granteve nga performanca e AZHBR në zbatimin procedurës së dhënies së granteve?

Për ti dhënë përgjigje pyetjes së mësipërme, së pari duhet ta kuptojmë atë, pra e thënë ndryshe, nëse veprimet e marra nga institucionet përgjegjëse për zhvillimin bujqësor dhe rural, ku në qendër të tyre janë grantet e dhëna çdo vit nga qeveria shqiptare nëpërmjet skemave kombëtare, (përfshirë këtu VKM që përcaktojnë çdo vit skemat, udhëzimet se si do të jetë i gjithë procesi, nga momenti i thirrjes për aplikim deri në ekzekutimin e financimit final, veprimtaria e AZHBR), kanë rezultuar efektive apo jo.

Skemat mbështetëse në Shqipëri janë një qasje e kombinuar e mbështetjes dhe pagesave direkte për rritjen e prodhimit në sektorët më të rëndësishëm bujqësor. Mbështetja për fermerët jepet nëpërmjet një sërë skemash mbështetëse mbi baza vjetore, në formën e pagesave direkte, skema investimesh dhe mbështetja e normës së interesit. Zhvillimi rural është procesi i përmirësimit të cilësisë së jetës dhe mirëqenies ekonomike të njerëzve që jetojnë në zona relativisht të izoluara dhe pak të populluara. Zhvillimi rural është përqendruar tradicionalisht në shfrytëzimin e burimeve natyrore me bazë tokën, si bujqësia dhe pylltaria. Ai është një proces i integruar, që përfshin zhvillimin social, ekonomik, dhe politik të shtresave më të varfra të shoqërisë.




KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Mbështetja ndaj sektorit bujqësor me politika, programe dhe instrumente financiar ka ardhur në rritje, por nuk ka qenë e mjaftueshme, në periudhën 2013-2016 dhe në vijim, sepse pothuajse në çdo vit përveç shkaqeve të tjera që lidhen me AZHBR, një ndër shkaqet kryesore që rezultojnë përfitues të prapambetur është edhe pamjaftueshmëria e fondeve.

Bujqësia dhe zhvillimi rural konsiderohet nga qeveria si sektor prioritar strategjik. Synimet kryesore kanë qenë rritja e qëndrueshme e sektorit dhe përafrimi me standardet evropiane drejt aksesit të financimeve nga Fondet e Bashkimit Evropian për Zhvillimin Rural. Procedura dhe sasia e fondeve për çdo skemë që përdoren për zhvillimin bujqësor dhe rural përcaktohen për çdo vit me VKM-në përkatëse⁵⁰, në bazë të së cilës Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Financave përgatisin udhëzimin e përbashkët për çdo vit të mbështetjes financiare që jepet. Në këto udhëzime përcaktohen në mënyrë të detajuar skemat që do të mbështeten, institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre, specifikimet për çdo skemë, kriteret e konkurrueshmërisë, kriteret e përfitimit dhe mënyra se si procedohet nga momenti i aplikimit për financim deri në ekzekutimin e pagesës. Më poshtë kemi paraqitur në mënyrë të përmbledhur këtë proces nëpërmjet skemës nr.

Skema nr. 5 Procesi miratimit të fondit dhe i aplikimit (Sipas Udhëzimit të përbashkët)



Burimi: Përgatitur nga Grupi i auditimit të KLSH

Grupi i auditimit analizoi të gjitha udhëzimet që kanë dalë për çdo vit nga 2013-2017 dhe për arsye të ndryshmeve që ka pësuar udhëzimi i vitit 2017, në specifikat brenda skemave, në fondet e vëna në dispozicion për çdo skemë, në kriteret e konkurrimit, përfitimit si dhe të shtimit të numrit të dokumentacionit për aplikantët, vendosi që ta trajtojë në veçanti, me përjashtim të disa rasteve ku trajtohet së bashku me udhëzimet e tjera. Gjatë shqyrtimit të udhëzimeve për periudhën 2013-2016, analizës dhe përpunimit statistikor të të dhënave të vëna në dispozicion rezultoi se:

Udhëzimet për mënyrën se si do të procedohet me skemat kombëtare, nga momenti i aplikimit deri tek pagesa e projektit, për periudhën 2013-2017, janë të bazuar në studime të vjetra, të pa përditësuara me ndryshimet e faktorëve që ndikojnë në ndërtimin e hartave të rajonizimit, të cilat shërbejnë si orientues për mënyrën se si do të zbatohen skemat

⁵⁰ VKM 2013-2017 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga ...



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

në terren, si do të shpërndahen fondet dhe se kush janë zonat më të favorizuara dhe ato më pak të favorizuara për kryerjen e investimeve. Gjithashtu në hartat e rajonizimi të udhëzimeve të viteve të fundit (2016-2017) në një pjesë të madhe, nuk tregohet se mbi çfarë studimesh janë mbështetur.

Në masë të konsiderueshme në udhëzimet e vitit 2014-2017 nuk përcaktohen afatet se për sa ditë mbaron vlerësimi i dosjes në DB-të rretheve, nga komisioni i përbërë nga specialist të AZHBR dhe Drejtorive Bujqësore, nuk përcaktohet afati i kryerjes së verifikimit në terren të projektit dhe nuk përcaktohet afati i kontrollit administrative i dosjes së aplikantit nga AZHBR qendër.

Kriteret e përfutimit në udhëzimet e viteve 2013-2016 nuk kanë qenë të formuluar qartë, nuk kanë qenë të ndarë specifikisht me intervale si dhe ka munguar një formulë për llogaritjen e pikëve fituese saktësisht. Në rastin e blegtorisë, në udhëzim shprehet se, ai që ka numrin më të madh të krerëve fiton pikët maksimale 65 pikë, por nëse një fermer ka 200 krerë dhe dikush tjetër 210, nuk përcaktohet se sa pikë diferencë do të ketë fermeri me 200 krerë nga ai me 210, duke lënë liri veprimi për institucionet që të bëjnë vlerësimin e dosjeve sipas pikëve në mënyrë jo të drejtë, duke sjellë dhe penalizime të pa drejta ndaj fermerit.

Kanë munguar kriteret e penalizimit në udhëzimet për 2013-2017 për të gjithë përfutuesit, në rastet kur nuk pranojnë të kontrollohen nga inspektorët e AZHBR-së.

Kanë munguar kriteret e detajuara për mënyrën se çfarë informacioni duhet të përmbajë plan-biznesi dhe se si duhet të strukturohet ai për periudhën 2013-2017, duke rritur riskun e ecurisë së aktivitetit sipas këtyre planeve.

Në udhëzimet e viteve 2013-2016 shprehet se dosja e aplikantit, më konkretisht për aplikimet në skemat e vogla, (si blegtori, bletari, bimë medicinale, mbjellje e vreshtave), kthehet për tu riplotësuar për mangësi të vogla, dhe afati i riplotësimit nga 10 ditë në vitin 2013 ka ardhur duke u ulur në 5 ditë kohë për të riplotësuar dosjen. Në këto udhëzime nuk është përcaktuar se kush janë mangësitë e vogla për të cilat kthehet dosja për tu riplotësuar, duke krijuar liri veprimi për institucionet përgjegjëse për kthimin apo jo të një dosje. Në këtë mënyrë fermerit, i cili në një masë të madhe është i painformuar në kohën dhe me informacionin e duhur si dhe ndodhur përball burokracive të shumta nëpër institucionet shtetërore, për sigurimin e dokumentacionit, nuk i krijohen kushte të favorshme për të aplikuar, duke ulur ndjeshëm edhe besimin e tyre se mund të përfutojnë prej skemave.

Penalitet e aplikuar nga AZHBR për diferencat në sipërfaqe toke, numër krerësh, etj, sipas udhëzimeve për periudhën 2013-2016, nuk kanë qenë të formuluar në mënyrë të qartë. Konkretisht, thuhet se kur rezultojnë diferenca mbi 10 %, aplikantit i zbritet 20% e vlerës së financimit, por kjo në një lloj mënyre është e padrejtë, sepse si fermeri me diferencë 11% dhe fermeri me 21% diferencë, në rastin kur ata kanë për të përfutuar të njëjtën vlerë financimi, penalizohen të dy me 20%. Kjo mungesë saktësie dhe korrektësie, krijon mundësi që institucionet përgjegjëse të kenë liri-veprimi në aplikimin e penaliteteve në mënyrë të padrejtë.

Për skemat e mbështetjes në blegtori, konkretisht për numrin e krerëve, mbështetjen për prodhimin e qumështit, për prodhimin e mishit, në momentin e aplikimit, nga institucionet përgjegjëse, kërkohet informacion i saktë mbi numrin e krerëve që ka fermeri, informacion i cili merret nëpërmjet regjistrat RUDA, të cilin e administrojnë Drejtoritë e Bujqësisë në rrethe. Nga verifikimi i kryer në terren si dhe intervistat realizuar me specialistët përgjegjës për administrimin e këtij regjistri rezultoi se:

Ky regjistër është problematik dhe nuk është i përditësuar me informacion të saktë. Gjithashtu i lihet në dorë fermerit, i cili duhet të paraqitet pranë DB, për të dhënë informacionin herë pas here, për ndryshimet që ka ai mbi numrin e krerëve, dhe fermeri nuk kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme nga institucionet përgjegjëse, se sa krerë dele/dhi ka faktikisht. Një mangësi tjetër është se, AZHBR nuk ka akses në regjistrin RUDA por vetëm DB-të.

Në udhëzimet 2013-2016, nga viti në vit, ka ndryshime të shumta në çdo skemë, kryesisht për datat e aplikimit, për kriteret e konkurrimit dhe të përfutimit, numrin e dokumentacionit, për specifikat të çdo skeme, për vlerat e financimit, këto ndryshime janë kryer pa u shoqëruar me analizat përkatëse, duke krijuar pa qëndrueshmëri të udhëzimeve dhe shpërqendrim të aplikantëve, të cilët të ndodhur përballë mungesës së informimit të duhur, ulin besimin se mund të përfutojnë prej mbështetjes financiare.

Nga verifikimet e kryera në terren, nga analizat e dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe nga intervistat e zhvilluar me fermerët, rezultoi se: Numri i dokumentacionit të nevojshëm për tu plotësuar nga aplikanti, ujen në rritje nga viti në vit, duke ndikuar në rritjen e kostove financiare dhe kostove në kohë për aplikantin.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

si dhe duke e bërë më të vështirë aplikimin për mbështetje financiare. Këto dokumente (vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore, vërtetimin e pagesës së faturave të energjisë elektrike, vërtetimin se nuk është debitorë në ndonjë institucion financiar etj.) mund t’i verifikojë vetë AZHBR nëpërmjet aksesit që mund ti kërkojë MBZHRAU dhe MF institucioneve që i japin këto vërtetime.

Referuar strategjisë ndërsektoriale për zhvillim bujqësor dhe rural 2014-2020 (SNZHBR), një nga mekanizmat për realizimin e objektivave të kësaj strategjie, është edhe mbështetja financiare për skemat kombëtare. Në SNZHBR 2014-2020 përcaktohet si prioritet për tu zhvilluar sektori i akuakulturës, por nga verifikimi në terren, analiza e dokumentacionit si dhe të dhënave mbi financimet në këtë sektor rezultoi se: *vlera e financimit nga viti 2014-2017 është ulur me rreth 40%, duke e lënë mbrapa zhvillimin e këtij sektori dhe jo në përputhje me atë që parashikon strategjia.* Gjithashtu edhe mbështetja e prodhimit të mishit, me qëllim mbizotërimitin e tregut nga produkte vendase, është prioritet në SNZHBR 2014-2020⁵¹, *por faktikisht ky sektor është mbështetur financiarisht vetëm në vitin 2014, duke e lënë të “varfër” në vitet në vijim.*

Në një masë të konsiderueshme për aplikimin në skemat kombëtare (kryesisht prodhimi i qumështit, lëkura e kafshës, mbjelljet e reja të fruta-perimeve, prodhimi i mishit), në udhëzimet e periudhës 2013-2017, kërkohet nga fermeri si kusht vendimtar që të ketë kontrata me tregtar brenda ose jashtë vendit për të siguruar shitjen e produkteve të tij. Nga verifikimi në terren dhe nga pyetësorët e zhvilluar me fermerët, në të shumtën e rasteve shpreheshin se nuk kemi ku ti tregtojmë produktet tona, pasi tregu i brendshëm është i mbizotëruar nga produktet e huaja. Nga analiza e kryer ndaj udhëzimeve për vitet 2013-2017 rezultoi se: *ka munguar mbështetja financiare dhe vendimmarrja e qeverisë për sigurimin e tregut të brendshëm për produktet vendase të fermerit shqiptar.*

Viti 2017, sipas analizës së dokumenteve të vëna në dispozicion, konsiderohet një vit i mos-realizimit të objektivave për AZHBR, për shkak se, është ndikuar nga lëvizja e stafit në nivelet drejtuese të AZHBR, nuk është përgatitur relacioni për planifikimin e fondeve të skemave kombëtare për këtë vit, nga verifikimi në terren dhe intervistat e zhvilluara, procesi i aplikimit, kontrolli në terren, kontrolli administrativ, i kanë tejkaluar afatet e arsyeshme, duke zgjatur nga 2-3 muaj, dukuri e cila, krijon bindjen e fortë se: *ekzekutimi i pagesave do të jetë me vonesë si dhe do të ketë një numër të lartë përfituesish të prapambetur në vitin 2018. Këto shkaqe si pasojë e efikasitetit dhe efektivitetit të ulët gjatë ushtrimit të detyrave nga AZHBR, do të ulin ndjeshëm besimin e fermerëve si dhe do të ndikojnë negativisht në efektivitetin e skemave kombëtare.*

Gjatë shqyrtimit të VKM dhe Udhëzimit të vitit 2017 drejtimet që do të mbështeten financiarisht, janë pothuajse të njëjta me vitin 2016 dhe 2015, konkretisht:

- përmirësimin e teknologjisë së kultivimit dhe të mbrojtjes së bimëve;
- prodhimin e perimeve në ambiente të mbrojtura, mbarështimin e blegtorisë, bletarisë dhe akuakulturës;
- nxitjen e formalizimit, kooperimit dhe organizimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor (SHBB).⁵²

por ndryshime të konsiderueshme ka pësuar udhëzimi i 2017. Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezultoi se: janë shtuar në numër kriteret e konkurrimit dhe të përfitimit, numri i dokumenteve për t’u plotësuar, specifikat brenda skemave kanë ndryshuar, vlera e financimit për pjesën më të madhe të skemave është ulur, rimbursimi i normës së interesit është hequr si skemë etj. Kryesisht më shumë ndryshime janë bërë në sektorin e blegtorisë, ku nëpërmjet këtij udhëzimi, është ulur numri i krerëve për të cilat aplikohet, nga 300 në 200 krerë dele/dhi, gjithashtu ndaheshin në dy pjesë fondet e dhëna për krerët e deleve/dhive, pra 1,200 lekë merrnin 100 krerët e para, dhe 50 % të 1,200 lekëve merrnin krerët nga 101-200. Ndryshime ka pësuar sektori i akuakulturës, ku janë ulur

⁵¹ Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020.

⁵² VKM nr. 137, datë 22.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së



KONTROLLI I LARTË I SHITIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

ndjeshëm fondet për financim, krahasuar me vitet e mëparshëm, mbarëshëmi i lopëve, prodhimi i mishit, shitja e lëkurës së kafshës.

Nga pyetësorët e zhvilluar në terren me fermerët, rezultoi se: *ka një lloj penalizimi të fermerit me ndryshimet e vitit 2017 dhe ankesa ndaj këtyre ndryshimeve, kjo për shkak se nuk kanë informacionin e dubur për këto ndryshime, për shkak të rritjes së numrit të dokumentacionit, çka e vështirësonte më tepër aplikimin, por edhe se përfitonin shumë herë më pak se në vitet e mëparshme, p.sh nëse një fermer me 200 krerë dele/dhi në periudhën 2014-2016 përfitonte 2,400,000 lekë (200*1,200), në vitin 2017 përfiton 1,800,000 [(1,200*100)+(600*100)], pra duket qartë që ulet ndjeshëm financimi.*

Gjithashtu udhëzimi i 2017, ka mangësi në përcaktimin e afateve për vlerësimin administrativ të dosjes së aplikantit nga komisionet që ngriheshin në DB-të, verifikimin në terren të projektit, vlerësimin administrativ që i bëhet dosjes në AZHBR-qendër.

Grupi i auditimit për ti dhënë përgjigje të plotë nënpyetjes përkatëse, e gjykoi të arsyeshme mënyrën se si AZHBR ka zbatuar faktikisht procedurat konformë rregullave që përcaktohen në udhëzim. Sipas të dhënave të AZHBR, në total nga viti 2013-2017 janë 15-20 skema, të cilat kanë nënndarjet e tyre dhe përbëhet një numër prej 27 masash në vit. Fondi i alokuar i skemave kombëtare për periudhën 2013 - 2016 ka ardhur vazhdimisht në rritje, duke bërë që këto fonde të dyfishohen në fund të kësaj periudhe: nga 967 milion lekë në 2013 në 1,9979.7 milion lekë në 2016, të cilën e kemi ilustruar nëpërmjet grafikut të mëposhtëm, ku tregohet nëpërmjet trendit rritës të fondeve.

Nëpërmjet rritjes së fondeve nga viti në vit nënkuptohet, logjikisht, se duhet të ketë patjetër zhvillim gjithë përfshirës, pra të zhvillohet si biznesi i vogël edhe i madh, por ajo që ndodh është e kundërta, dukuri të cilën e kemi shpjeguar më poshtë.


Pasqyra nr. 7 Fondi për zhvillimin rural

Viti	2013	2014	2015	2016
Fondi për zhvillimin rural	967,000	1,680,000	1,750,000	2,058,000
Realizimi në lek	927,441	1,157,231	1,599,467	1,534,121
Numri i përfituesve	5601	8768	12718	11516
Realizimi në %	96%	69%	91%	75%

Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në periudhën 2013-2016, pjesën më të madhe të fondeve (40%) e zënë investimet 50-60%, më pas vjen blegtoaria me (26%), sektori i ullirit së bashku me financimin për luftimin e mizës së ullirit me (10%), bimët medicinale, sistemi i ujitjes, etj...

Grafiku nr. 4 Pesha në % e skemave 2013 - 2016



Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

Referuar të dhënave statistikore rezulton se, *nëpërmjet granteve është synuar zhvillimi i biznesit të madh, duke lënë pas zhvillimin e biznesit të vogël, fermerit, individit i cili nuk i disponon kapacitetet e nevojshme për të hapur një biznes. Kjo dukuri në një masë të konsiderueshme, nuk sjell produktin që pritet përmes subvencioneve për zhvillimin e gjithanshëm dhe të qëndrueshëm të bujqësisë dhe të zonave rurale.*

Grupi i auditimit për të krijuar një tablotë plotë dhe të qartë, vendosi që për trajtimin e kësaj çështjeje të fokusohet kryesisht në skemat kombëtare të vogla (4 prej tyre), të cilat zënë një pjesë të konsiderueshme të financimeve në bujqësi, janë mbizotëruese në Shqipëri, si dhe kanë ndryshimet më të shpeshta ndër vite në kriteret e përfitimit në fonde dhe në natyrë (Numër krerësh për blegtorinë, bletarinë, sipërfaqe për bimët medicinale, sipërfaqe për akuakulturën), si dhe përfshijnë territore të ndryshme (mal, fushë dhe det).

Skemat sa më poshtë vijon:

1. Blegtoria (më shumë bagëtitë e imta, financimi për prodhimin e qumështit, etj...)
2. Bimët medicinale
3. Bletaria
4. Akuakulturë.

Këto skema kanë numrin më të lartë të aplikimeve si dhe zënë pjesë të konsiderueshme në financimin total 2013-2016, në disa prej rajoneve (Berat, Fier, Shkodër, Vlorë) më të rëndësishme të vendit, krahasuar me rajonet e tjera. Pikërisht në këto rajone skemat të cilat i kemi përfshirë në auditim, janë më mbizotërueset, konkretisht: Qarku i Beratit, financimet e të cilit zënë 25 % të totalit. Brenda këtij Qarku, peshë të konsiderueshme zënë financimet në sektorin e ullirit (përfshirë këtu financimet në luftimin e mizës së ullirit), financimet në sektorin e blegtorisë së imët (dele, dhi), si dhe investimet 50-60% të cilat konsistojnë në: ndërtim ambientesh për përpunimin e vajit të ullirit, mekanika bujqësore, ambiente për përpunimin e prodhimeve blegtorale. Këto karakteristika gjenden edhe në Qarkun e Fierit në përgjithësi. Qarku i Shkodrës zë 9% të financimit total për periudhën 2013-2016 ndaj Skemave Kombëtare. Në këtë Qark skema mbizotëruese e cila zë afërsisht 40% të fondeve, është për bimët medicinale dhe më pas investimet 50-60%, të cilat konsistojnë në ndërtim ambientesh për grumbullim dhe përpunim të bimëve medicinale.

Nga verifikimi në terren si dhe nga intervistat zhvilluar me inspektorët e AZHBR-së nëpër qarqe, rezultoi se: *në disa raste, skemat kombëtare të cilësuar të vogla për shkak të vlerës së financimit në periudha të ndryshme kanë rezultuar të dështuara, nuk kanë pasur jetëgjatësi dhe nuk kanë qenë frytdhënëse. Kjo dukuri u vu re, konkretisht, në Rrethin Malësi e Madhe në Qarkun e Shkodrës, ku: në vitin 2013 janë dhënë fonde të shumta, rreth 20% e totalit të financuar atë vit, për mbjelljen e ullirit, financim i cili rezultoi i dështuar, për shkak të kushteve klimaterike në atë zonë, e cila nuk ishte e përshtatshme për kultivimin e ullirit, nga paaftësia e AZHBR, për orientimin e duhur të skemave dhe financimeve në përputhje me faktorët klimaterik dhe jo vetëm, të asaj zone, si dhe mungesës së studimeve të përditësuara, në të cilat përcaktohet rajonizimi i mbjelljeve.*

Grupi i auditimit për të vlerësuar zbatimin e procedurave të dhënies së granteve për zhvillim bujqësor dhe rural nga AZHBR, bëri kërkesë për dokumentacion, sa më poshtë vijon:

- kryesisht dosjet e aplikantëve të cilat kanë qenë përfitues 2013-2016,
- ekzekutimin e pagesave për përfituesit për vitet 2013-2016,
- numrin e ankesave të aplikantëve,
- numrin e përfituesve çdo vit të cilët si pasojë e vonësve administrative ose të mungesës së fondeve nuk kanë marrë financimet në vitin që kanë aplikuar,
- propozime të AZHBR ndaj MBZHRAU për planifikimin e fondeve çdo vit.

Nga verifikimi i dosjeve për vitet 2013-2016 të vëna në dispozicion të grupi të auditimit, të aplikantëve të cilat janë përfitues përforcohet gjetja e mësipërme për afatet, ku rezultoi se: *në një masë të konsiderueshme nuk janë respektuar afatet e verifikimit në terren nga AZHBR rajon për vitin 2013-2014, kanë zgjatur për 2-3 muaj kontrollin administrativ nga AZHBR qendër, duke sjellë efekte zinxhir për vonesa në çdo fazë të procesit.*

Gjatë verifikimit në terren dhe intervistave zhvilluar në Qarkun e Korçës me inspektorët e kontrollit të AZHBR rezultoi se: *Skemat më problematike për tu kontrolluar gjatë periudhës së verifikimit para dhe pas financimit, janë të sektorit të blegtorisë. Gjithashtu në të gjithë procesin e dhënies së mbështetjes financiare, faza më*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

problematike ishte aplikimi, sepse fermeri në mungesë informimi dhe këshillimi nga institucionet përkatëse, haste vështrësi në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm brenda kohës së kërkuar, duke e detyruar fermerin të paraqitet disa herë në zyrat e DB-së për të marrë informacionin e duhur.

Nga intervistat e realizuara me inspektorët e kontrollit të AZHBR në qark, rezultoi se: *inspektorët nuk kishin informacion për investimet e kryera në masën 50-60%, sepse këtë informacion e disponojnë vetëm inspektorët e kontrollit të AZHBR në qendër. Grupi i auditimit e vlerësoi të palogjikshme dhe performancë të ulët, mungesën e këtij informacioni, përderisa këta inspektorë janë pjesë e së njëjtës strukturë, dhe si rrjedhim, minimalisht, duhet të kenë informacion mbi vendndodhjen e investimit dhe ecurinë e tij.*

Për zbatimin me efektivitet të udhëzimeve për procedurat që do të ndiqen për zbatimin e skemave kombëtare, AZHBR duhet të hartoj dhe të miratoj çdo vit sipas ndryshimeve që ndodhin tek skemat, manualin e procedurave për implementimin e tyre.⁵³ Në këto manuale, pasqyrohet në mënyrë të detajuar i gjithë informacioni, se si kryhen funksionet nga çdo drejtori e AZHBR për zbatimin e skemave. Nga kërkesa që bëri grupi i auditimit, rezultoi se: *Për periudhën 2013 - 2017 AZHBR nuk ka përgatitur manualin e vitit 2014 dhe 2016, duke ndikuar negativisht në eficientësinë dhe efektivitetin e zbatimit të skemave kombëtare nga AZHBR për këto vite. Gjithashtu në manualin e vëna në dispozicion (2013-2015-2017), rezultojnë mangësira në përcaktimin e afateve për realizimin e detyrave, konkretisht për kontrollin në terren të aplikimeve nga DK, kontrollin administrativ të dosjeve nga DPAP.*

Në Udhëzimin e vitit 2015⁵⁴ për skemat: Mbështetja e investimeve në vlerën 50%; Ndërtimi i serave për kultivim perimesh, fidanësh dhe produkte të tjera bujqësore, Rimbursimi i Normës së interesit dhe Mbështetja e investimeve deri në 60% për blerjen e traktorëve, agregateve të ndryshëm; përcaktohet se AZHBR duhet të përgatisë për secilën skemë në mënyrë të detajuar manualin e procedurave dhe formularët standard për zbatimin e këtyre skemave. Nga analizimi i manualit të procedurave për vitin 2015, rezultoi se: *Vetëm rimbursimi i normës së interesit ishte parashikuar në këtë manual, kurse skemat e tjera jo. Në këto kushte është krijuar mundësia për subjektivizëm në kontrollin dhe monitorimin e këtyre skemave. Gjithashtu krijohet mundësia për vonesa në kontrollin administrativ dhe në terren të aplikimeve, këto vonesa reflektohen në dy drejtoritë e tjera të Autorizimit dhe të Ekzekutimit të Pagesave, duke i penalizuar në një lloj mënyre përfituesit e skemave si dhe duke ulur eficientësinë dhe efektivitetin e AZHBR në zbatimin e procedurave për administrimin e fondeve për zhvillimin e bujqësisë dhe të rajoneve.*

Grupi i auditimit bëri kërkesë për vendosjen në dispozicion të statistikave në lidhje me arsyet e skualifikimit që bëhen prej AZHBR ndaj aplikantëve për 2013-2017, dhe rezultoi se *AZHBR nuk kishte një databasë të plotë me informacionin e mësipërm që u kërkuar prej grupit të auditimit, por vetëm vitet 2015-2016, si dhe u vu re mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi midis drejtorive në dhënien e informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit. Nga tabelat e vendosura në dispozicion të grupit të auditimit për arsyet e skualifikimeve për vitet 2015-2016, rezultoi se: rreth 70% e zënë arsyet si pasojë e penaliteteve nga AZHBR, çka krijon bindjen e arsyeshme të grupit të auditimit se procesi i informimit të fermerit nuk ka rezultuar efektiv, pasi fermerët nuk i kanë marrë njohuritë e nevojshme për të shmangur penalitetet e shumta.*

Gjatë intervistës zhvilluar me Drejtorin e DAP, Përgjegjësen e SEP, si dhe nga verifikimi i shifrave të rakorduara nga dy drejtoritë DAP dhe DEP, rezultoi se: *sistemi që gjeneron vlerën për autorizimi për pagesë, shfaq probleme pasi nuk pasqyron të gjitha diferencat që dalin gjatë kontrolleve nga inspektorët, kryesisht mbas financimit të 70% të vlerës, çka i detyron specialistët të përpunojnë të dhënat manualisht.*

Në dhjetor të vitit 2016, nëpërmjet Udhëzimit⁵⁵, të dalë në datën 02.12.2016, i cili ka dalë për efekt të ndryshimeve të Udhëzimit të mëparshëm të këtij viti⁵⁶, është përcaktuar që brenda datave 1-16 Dhjetor të bëhen aplikimet për skemën e bletarisë, për shkak se deri në vitin 2016 kosheret e bletëve

⁵³Manuale të procedurave për implementimin e skemave kombëtare 2013-2017.

⁵⁴Udhëzim i MBZHRAU dhe MF Nr. 4, datë 25.02.2015 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

⁵⁵Udhëzimi Nr. 10 datë 22.11.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

⁵⁶Udhëzimi Nr. 2 datë 17.02.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.



KONTROLLI I LARTË I SHITIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

nuk kanë patur numra matrikullimi, dukuri e cila ka krijuar mundësi për subjektivizëm dhe liri veprimi për AZHBR në identifikimin e koshereve të bletëve, skualifikimin e aplikantëve dhe pagesa të pa drejta të ndjekura për 2013-2016 për këtë skemë, ndërkohë që për vitin 2016, nga AZHBR nuk janë planifikuar afatet se kur do të kontrollohen dhe afatet e pagesës së këtyre aplikantëve, duke i shpërqendruar ata dhe duke ulur efektivitetin e kësaj skeme. Kjo situatë e krijuar ka shkaktuar një numër të konsiderueshëm të aplikantëve të prapambetur për kosheret e bletëve, konkretisht, 405 aplikantë. Në vitin 2017 sipas të dhënave që i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultojnë se janë rreth 425 aplikantë të prapambetur nga viti 2016, ku shifër të konsiderueshme e zënë përfituesit e koshereve të bletëve. Pra shikojmë se, edhe pse po bëhet afërsisht një dekadë që AZHBR ushtron aktivitetin e saj si administratore e fondeve për skemat kombëtare, përsëri ajo rezulton "debitore" ndaj fermerëve, si pasojë e keqplanifikimit dhe keqadministrimit të të gjithë procesit për fondet e skemave kombëtare, dhe krijohet bindja, se duke ndjekur këtë rrugë, kjo dukuri do të vazhdojë pambarimisht, duke patur çdo vit të prapambetur dhe ulje të efektivitetit të AZHBR gjatë zbatimit të detyrave të saj. Në tabelën e mëposhtme kemi pasqyruar informacionin për aplikantët e prapambetur (përfitues por jo të paguar në vitin që u takonte të paguheshin), të cilët zënë një peshë të konsiderueshme si në numër edhe në vlerë ndaj totalit të përfituesve, konkretisht rreth 24% ndaj totalit të përfituesve dhe 14% ndaj totalit të vlerës.

Pasqyra nr. 8 Informacion Përfituesit e prapambetur në numër dhe vlerë 2013-2016

	Viti								Total	
	2013		2014		2015		2016		2013-2016	
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
Përfitues Total	5,593	846,608,972	1,782	1,097,116,486	3,138	1,434,717,710	2,684	1,405,168,705	13,197	4,783,611,873
Të prapambetur	1,764	175,979,907	-	-	769	200,179,168	515	118,862,513	3,048	495,021,588
Total në %		21%				14%		8%	24%	14%

Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Grupi i auditimit e gjykoj të arsyeshme që në këtë çështje të përfshinte dhe analizën e relacioneve të buxhetit për skemat që përgatit AZHBR, si dhe analizën statistikore të numrit të aplikantëve të prapambetur si pasojë e mospagesave në kohë, buxhetit për skemat e vogla dhe investimet. Gjatë analizimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion kryesisht, relacionet në të cilat AZHBR planifikon buxhetin dhe mënyrën se si do të shpërndahet sipas skemave, database-n me informacionin statistikor për skemat të cilat kanë numrin e aplikantëve të prapambetur nga viti në vit, rezulton se për skemat me pagesa direkte ose skemat e vogla, buxhetet e planifikuara nga viti 2013-2016 vijnë në rënie, konkretisht në vitin 2013 ishin 632,000 lekë të reja, (2014:600,000 lekë), (2015:500,000 lekë), (2016:500,000 lekë), pra një rënie e konsiderueshme e fondeve, rreth 21 %. Ndërkohë që fondet e planifikuara për investimet për 2013-2016 janë rritur me 30%.

Pasqyra nr. 9 Buxheti i Planifikuar 2013-2016

Në lekë

Nr	Skemat	2013	2014	2015	2016
		Plan	Plan	Plan	Plan
1	Totali i planifikuar	1,052,000,000	1,655,000,000	1,891,360,000	2,015,615,000
2	Bashkëfinancimi IPA	100,000,000	154,000,000	154,000,000	280,000,000
3	Informimi mediatik	5,000,000	130,000,000	35,000,000	35,000,000
4	Skemat për Bujqësin dhe Zhvillimin Rural	947,000,000	1,339,159,614	1,200,421,065	1,536,300,712
5	Skemat për Bujqësin dhe Zhvillimin Rural në % ndaj totalit	90%	81%	63%	76%
6	Financimi i aplikimeve të reja (skemat e vogla)	632,107,315	600,000,000	500,000,000	500,000,000
7	Financimi i aplikimeve të reja në % ndaj (4)	67%	45%	42%	33%

Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Referuar të dhënave statistikore për numrin e të prapambeturve që nuk janë paguar, rezulton: se skemat më problematike të cilat kanë numrin më të lartë të prapambeturve, janë skemat me pagesat direkte (dele/ dbi, mbjellje




KONTROLI I LARTË I SHËTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

vreshti, bletaria, bimë medicinale) fondi i të cilave nga 2013-2016 vjen duke u ulur. Skemat e investimeve, fondet e të cilave janë rritur, në një masë të madhe paguben brenda vitit në të cilin aplikojnë. Ndodhur në kushtet e mësipërme, gjithashtu, edhe nga intervistat zhvilluar me inspektorët e kontrollit në rajone, të cilët në një masë të madhe e kanë pohuar vështirësinë për kontrollin e skemave të vogla brenda afateve të arsyeshme, intervistat me inspektorët e DPAP, (të cilët nuk kanë afate të përcaktuara për realizimin e punës së tyre, që do të thotë se në një vit të caktuar, kontrolli administrativ, zgjat 1 muaj dhe në një vit tjetër zgjat 3 muaj) si dhe pyetësorëve me aplikantët, sipas grupit të auditimit rezultoi se:

Përfituesit e skemave direkte, ku zakonisht janë fermerët e vegjël, janë më të penalizuarit dhe më pak të favorizuarit nga AZHBR, ndërkohë mbështetur sa më sipër por edhe në shkresën nr. 4197, datë 27.10.2014, ku AZHBR i është drejtuar MBZHRAU, që theksobet nga ana e AZHBR që përparësi ti jepet financimit të skemës së investimeve në masën 50%, pra duket qartë që aplikantët për investime janë favorizuar më tepër nga AZHBR për vitet 2013-2016, duke ulur besimin e aplikantëve të skemave direkte se mund të përfitojnë si dhe duke i bërë më pak efektive këto skema.

Grafiku nr. 5 Buxheti i skemave të vogla 2013-2016



Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Relacionet e përgatitur nga AZHBR për planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve, kanë patur ndryshime në bazën e përgatitjes së tyre, që do të thotë se në vitin 2013, planifikimi dhe shpërndarja e fondeve është bazuar mbi sipërfaqet e projekteve përfituese me tarifën e pagesave të përcaktuara dhe pikërisht në këtë vit nuk kanë rezultuar përfitues të prapambetur për vitin e mëpashtëm, në vitet 2014-2015-2016 baza e përgatitjes së relacioneve ka ndryshuar rrënjësisht, ku fondet planifikoheshin sipas kërkesave të DB-ve për qarkun, rrethin dhe skemën, theksojmë se këto ndryshime kanë ndodhur pa u shoqëruar me arsyt dhe analizat përkatëse. Gjithashtu ka një numër të konsiderueshëm të rialokimeve brenda viteve (vlerat e të cilëve pësojnë ndryshime të konsiderueshme në muajt tetor-nëntor dhe më pas ndodhin ndryshime të vogla në vlerë). Konkretisht (2013:5 rialokime), (2014:5), (2015:6), (2016:5), pra mesatarisht 5 rialokime të fondit brenda vitit, ku ndodh që të ketë rialokime të fondeve edhe në muajin Dhjetor të vitit përkatës, dhe një ndër arsyt kryesore të kësaj dukurie është mungesa e afateve të përcaktuara për verifikimin në terren të aplikimeve, që do të thotë se një fermer i cili ka aplikuar në mars-prill, duhet të presë deri në fund të vitit për tu verifikuar e më pas nëse do të financohet apo jo brenda vitit. Kjo dukuri e krijuar, ka ndikuar negativisht në besimin e fermerëve për të marrë financimin që presin, si dhe ka ulur efektivitetin e skemave.

Megjithëse ndodhi ky ndryshim për mënyrën e përgatitjes së fondit, si dhe rialokimet e shpeshta të ndodhura brenda viteve, përsëri në fund të vitit rezultoi përfitues të prapambetur, si pasojë e keqplanifikimit dhe keqadministrimit të fondeve. Për këtë dukuri kemi bërë një analizë statistikore të ndryshimeve të fondeve nga momenti i parë deri në realizimin faktik të tij, dhe rezultoi se: realizimi faktik i buxhetit për skemat ndaj planifikimit të tij, ndryshon konsiderueshëm, rreth 43% nga fillimi i vitit 2013 deri në fund të tij, (2014:48%, ndryshim), (2015:64% ndryshim), (2016:12%), kemi vlerë të ulët të ndryshimit të fondit në vitin 2016, sepse në momentin e përgatitjes së relacionit, AZHBR ka marrë numër të konsiderueshëm të aplikimeve, duke bërë planifikim më të mirë se vitet e tjera. Gjithashtu vlera në % e totalit të skemave të vogla ndaj fondit të alokuar për skemat për bujqësinë dhe zhvillimin rural, vjen duke u ulur, nga 67% në 33% në vitin 2016, pra me 48% ulje, ndërkohë që buxheti në zërin "Transferi buxhetore" artikulli 606, vjen duke u rritur nga 2013-2016. Referuar vlerave të mësipërme, numrit të rialokimeve brenda viteve, kur përsëri edhe pse bëhen rialokime të fondeve kemi përfitues të prapambetur. Kështu në skemat e vogla, përforcohet më



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

shumë bindja e grupit të auditimit, se ka një keqplanifikim të fondeve për skemat kombëtare, veçanërisht të skemave të vogla. Nëse do të shikojmë edhe skemat në mënyrë të detajuar për vitin 2013, rezulton se, 10 skema ndaj totalit të tyre janë planifikuar më shumë dhe janë realizuar konsiderueshëm më pak, kjo dukuri ndodhë edhe në vitet e tjera. Të gjitha këto ndikojnë negativisht në besimin e aplikantit, ulin ndjeshëm efektivitetin e AZHBR dhe si rrjedhim efektivitetin e skemave kombëtare.

Si konkluzion:

- Viti 2017, konsiderohet një vit i mos-realizimit të objektivave, për shkak se:
 - është ndikuar nga lëvizja e stafit në nivelet e larta drejtuese të AZHBR,
 - ende nuk është përgatitur relacioni për planifikimin e fondeve sipas skemave kombëtare për këtë vit. Mospërgatitja e relacionit në vitin 2017 për mënyrën e shpërndarjes së fondit, sipas qarkut, rrethit dhe skemave, duke mos respektuar pikën 3 të Udhëzimit të 2017⁵⁷, është pasojë e performancës së ulët të AZHBR, e cila ka sjellë mungesën e orientimit të duhur të fondit për skemat kombëtare, duke ndikuar negativisht efektivitetin e tyre.
 - sipas vizitave në terren dhe intervistave të zhvilluara, procesi i aplikimit, kontrolli në terren, kontrolli administrativ kanë zgjatur tej mase, nga 2-3 muaj, mangësi e cila do të sjellë si pasojë ekzekutimin me vonesë të pagesave, si dhe do të rrisë numrin e përfituesve të prapambetur në vitin 2018.
 - Performanca e ulët e AZHBR gjatë ushtrimit të detyrave, do të çenojë besimin e fermerëve si dhe do të ndikojnë negativisht në efektivitetin e skemave kombëtare.
- Keq planifikimi, keq administrimi si dhe rialokimet e shpeshta të fondeve për skemat kombëtare brenda vitit, si pasojë e mungesës së kriterëve për planifikimin e tyre, mungesës së përcaktimit të afateve për verifikimin në terren, kontrollit administrativ të aplikantit/përfituesit, si dhe paaftësia e AZHBR për të përthithur të gjitha fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit për skemat kombëtare, e ka shndërruar atë në një “debitore” të rregullt ndaj përfituesve të këtyre skemave, duke krijuar përfitues të prapambetur çdo vit, duke ulur efektivitetin e skemave kombëtare dhe besimin e fermerëve se mund të përfitojnë nga buxheti i shtetit.
- Ulja e fondeve nga viti në vit për skemat e vogla dhe rritja e tyre për skemën e investimeve, ndërkohë që fondi total për bujqësinë ka ardhur në rritje, si dhe ndryshimet e shpeshta brenda vitit të buxheteve për këto skema, kanë ulur efektivitetin e AZHBR, kanë ndikuar negativisht tek aplikantët e këtyre skemave, duke i favorizuar më pak fermerët dhe më shumë aplikantët e investimeve, si dhe duke zvogëluar efektin e skemave të vogla në zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural.

Për këto rekomandojmë:

1. AZHBR të marrë masat e nevojshme për të përgatitur menjëherë relacionin për fondin e vitit 2017, gjithashtu të kryejë një planifikim dhe administrim më të mirë dhe më të saktë të buxhetit për skemat kombëtare, kryesisht të skemave të vogla, në momentin kur ka mbaruar procesi i aplikimit, duke rritur mundësinë që fondi i alokuar për skemat të mos pësojë ndryshime të shpeshta dhe të konsiderueshme gjatë vitit, të rriti aftësitë e saj për të përthithur të gjitha fondet që akordohen nga buxheti i shtetit për bujqësinë, me qëllim që të mos të krijohen përfitues të prapambetur dhe skemat kombëtare të jenë efektive.

Vazhdimisht

- Udhëzimi i vitit 2017 ka penalizuar aplikantët me kriteret e vendosura, kryesisht ata të skemës së blegtorisë, lidhur me përfitimin financiar prej saj, pasi: nëse një fermer me 200 krerë dele/dhi në periudhën 2014-2016 përfitonte 240,000 lekë (200*1,200), në vitin 2017 përfiton 180,000 [(1,200*100)+(600*100)], pra duket qartë që ulet ndjeshëm financimi dhe përfitimi. Këto ndryshime kanë rritur mundësitë për uljen e besimit ndaj skemave dhe uljen e efektivitetit të tyre, duke i bërë blegtorët të painteresuar ose në kërkimin e formave jo të rregullta për përfitimin e fondeve në këtë masë.

Për këtë rekomandojmë:

⁵⁷ Udhëzim nr. 8, datë 31.03.2017 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe...” të ndryshuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

2. AZHBR t'i propozojë Ministrisë së Bujqësisë rregullimet e nevojshme në udhëzimin e përbashkët të zbatimit të skemave kombëtare në përgjithësi dhe atyre të blegtorisë në veçanti në drejtim të përputhjes së tyre me politikat ndërsektoriale të zhvillimit të bujqësisë dhe rural.

Në udhëzimin për skemat kombëtare 2018

- Studimet e MBZHRAU janë të vjetra në kohë dhe të pa përditësuara me ndryshimet e faktorëve (klimaterik, mjedisor), duke ndikuar negativisht në udhëzimet për përcaktimin e procedurave për skemat kombëtare si dhe në hartat e rajonizimit, duke rritur tek këto të fundit mundësinë për pasaktësi dhe në uljen e efektivitetit të fondeve buxhetore për skemat kombëtare.

Për këtë rekomandojmë:

3. Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të marrin masat e nevojshme që të përditësojnë studimet mbi të cilat ndërtohen hartat e rajonizimit, si dhe të kryejnë analiza vjetore mbi ecurinë e skemave kombëtare dhe problematikat që i shoqëron, me qëllim rritjen e efektivitetit të granteve për zhvillimin e bujqësisë.

Brenda vitit 2018

- Mungesa e statistikave për arsyet e skualifikimit për periudhën 2013 - 2014, statistikave për ankesat që kanë fermerët ndaj AZHBR, si dhe mungesa e koordinimit, bashkëpunimit midis drejtorive të saj, tregon mungesë efektiviteti në veprimtarinë e këtij institucioni.

Për këtë rekomandojmë:

4. AZHBR të krijojë një databasë të saktë dhe të plotë me informacionin për skualifikimet, ankesat, të kryejë përpunime statistikore, me qëllim përgatitjen e informacionit të saktë për tu raportuar, si dhe të forcohet bashkëpunimi midis drejtorive të saj.

Vazhdimisht

Ky rekomandim është vlerësuar dhe konfirmuar dhe nga observacionet e AZHBR, me nr. 639/3 prot., datë 29.12.2017, dhe janë shprehur se do të ngarkohet specialisti i Sektorit të Riskut, Parandalimit të mashtrimit, Analizës dhe Raportimit për përgatitjen e kësaj database me informacion të saktë dhe të plotë.

- Në udhëzimet 2013-2016 nuk kanë qenë të formuluar saktësisht, kriteret e përfitimit nëpërmjet intervaleve me vlerat përkatëse, si dhe formula e saktë për llogaritjen e pikëve ndaj aplikantëve, duke rritur mundësinë për t'i penalizuar ata dhe ulur efektivitetin e skemave.

- Mungojnë kriteret e penalizimit për të gjithë përfituesit e mbështetjes financiare, për rastet në të cilat, ata nuk pranojnë të kontrollohen nga AZHBR, duke ndikuar negativisht në eficientësinë dhe efektivitetin e punës së inspektorëve të kontrollit.

Për këto rekomandojmë:

5. Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me AZHBR të marrin masat e nevojshme për përcaktimin e penaliteteve, në rastet kur përfituesit e fondeve të skemave kombëtare nuk pranojnë të kontrollohen prej inspektorëve të AZHBR.

Duke filluar nga skemat e vitit 2018

- Në udhëzimet 2013-2017 kanë munguar kriteret e detajuara për mënyrën e strukturimit të plan-biznesit, për paraqitjen e informacionit të saktë, real dhe të qëndrueshëm, dukuri e cila ka rritur riskun e ecurisë së biznesit dhe të fondeve të dhëna për mbështetjen e tyre.

Për këtë rekomandojmë:

6. Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të marrin masat e nevojshme që të përcaktojnë kriteret specifike dhe të qarta, për mënyrën e përgatitjes, vlerësimit dhe monitorimit të plan-biznesit në rastin e financimit të projekteve të që kërkojnë ky dokument, me qëllim të paraqitet informacion real dhe të qëndrueshëm, për të minimizuar riskun e dështimit të projektit.

Duke filluar nga skemat e vitit 2018

AZHBR në observacionin e datës 29.12.2017, me nr. 639/3 prot., ka sqaruar se formati i plan-biznesit është i detajuar në Udhëzimin e përbashkët midis Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave për periudhën (2015-2017). Megjithatë, grupi i auditimit të KLSH evidenton se informacioni i pasqyruar në planet e biznesit është shpesh herë jo real dhe jo i qëndrueshëm.

- Nga shqyrtimi i procedurave të dhënies së granteve, si dhe nga pyetësorët zhvilluar me aplikantët dhe përfitues të skemave kombëtare, numri i dokumenteve për tu plotësuar ka ardhur në rritje nga viti



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

në vit, duke rritur kostot financiare dhe atyre kohore për fermerin, për më tepër vështirësinë në fazën e aplikimit, me ndikim në efektivitetin e skemave kombëtare.

Për këtë rekomandojmë:

7. *Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave të marrin masat e nevojshme që një pjesë të dokumenteve (kryesisht vërtetimet, OSHEE, sigurimet shoqërore) që i kërkojnë aplikantit për tu plotësuar, të verifikohen prej AZHBR vetë, nëpërmjet aksesit që duhet të jepet në institucionet që japin këto vërtetime, me qëllim lehtësimin e aplikantit në kosto financiare dhe në kohë për përgatitjen e tyre.*

Duke filluar nga skemat e vitit 2018

- Disa prej skemave (prodhimi i mishit, akuakultura) nuk janë mbështetur në mënyrë konstante me fonde, duke i lënë të "varfra" për nga zhvillimi i tyre dhe duke u mospërbushur objektivat e SNZHBR 2014-2020 në lidhje me këta sektorë.⁵⁸

- Në disa raste, skemat kombëtare të cilësuar të vogla për shkak të vlerës së financimit në periudha të ndryshme kanë rezultuar të dështuara, nuk kanë pasur jetëgjatësi dhe nuk kanë qenë frytdhënëse, që tregon për një punë të dobët monitoruese të AZHBR.

Për këtë rekomandojmë:

8. *Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të shmangin lancimin e skemave për të cilat fermerët nuk janë të interesuar, si dhe të marrin masat e nevojshme, që të mbështeten financiarisht në mënyrë të qëndrueshme disa prej sektorëve të cilat janë përcaktuar dhe si objektiva në SNZHBR 2014-2020.*

Menjëherë

- Nga vizitat në terren, si dhe nga intervistat e realizuara me inspektorët e kontrollit të AZHBR dhe specialistët e DB, administrimi i regjistrit RUDA kryhej vetëm nga DB. Mungesa e aksesit të AZHBR në këtë regjistër, pasaktësitë e informacionit në RUDA, kanë ndikuar negativisht në punën e inspektorëve të kontrollit, duke ulur eficientësinë dhe efektivitetin gjatë identifikimit dhe vlerësimit të numrit të kafshëve të gjalla për vitet 2013 - 2017.

Për këtë rekomandojmë:

9. *Ministria e Bujqësisë të marrë masa për përditësimin e regjistrit të blegtorisë (RUDA), si dhe t'i krijojë akses AZHBR në marrjen e të dhënave të nevojshme, për të shmangur kostot e tepërta të fermerëve në aplikimin për përfitim nga grantet buxhetore për zhvillimin e bujqësisë.*

Menjëherë

- Nga intervistat e zhvilluara me punonjësit e AZHBR si dhe pyetësorët me aplikantët, arrihet në konkluzionin se faza më e vështirë në të gjithë procesin e dhënies së granteve, është ajo e aplikimit, si pasojë e mungesës së informacionit të duhur dhe në kohën e duhur, si dhe numrit të lartë të dokumentacionit për tu plotësuar, duke e vështirësuar aplikimin si dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e tij.

- Mungesa e informacionit për inspektorët e kontrollit në qark ndaj investimeve 50-60% ka ndikuar negativisht në performancën e punonjësve të AZHBR në qark.

- Mungesa e manualeve të implementimit të procedurave për skemat kombëtare për vitet 2014 dhe 2016, mungesa e hartimit të procedurave të veçanta për disa nga skemat në vitin 2015 sipas përcaktimeve të bëra në udhëzim⁵⁹, si dhe mangësitë në manualët e 2013-2015-2017, ka ulur eficientësinë dhe efektivitetin e AZHBR në zbatimin me korrektësi të procedurave për administrimin e fondeve për zhvillim bujqësor dhe rural.

- Mungesa për vitet 2013-2016 e matrikullimit të koshereve të bletëve ka krijuar mundësi për subjektivizëm dhe liri veprimi për AZHBR në identifikimin e koshereve të bletëve, skualifikimin e aplikantëve dhe pagesa të pa drejta të ndjekura për këtë periudhë, ndërkohë që për vitin 2016, mungesa e planifikimit të afateve për kontrollin dhe pagesën e përfituesve të kësaj skeme, nga AZHBR, ka sjell shpërqendrimin e tyre ata dhe ka ulur efektivitetin e kësaj skeme.

Për këto rekomandojmë:

⁵⁸Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020.

⁵⁹Udhëzim i MBZHRAU dhe MF Nr. 4, datë 25.02.2015 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

10. AZHBR të marri masat e nevojshme që në manualët për implementimin e procedurave të skemave kombëtare, të jenë në përputhje me udhëzimet e çdo viti që nxjerr MBZHRAU dhe MF, si dhe të përcaktojë saktësisht afatet për realizimin e detyrave nga çdo drejtori, me qëllim shmangien e krijimit të vonesave dhe rritjen e korrektesisë ndaj aplikantëve.

Menjëherë

- Pasaktësitë e sistemit që gjeneron automatikisht vlerën e autorizuar për tu paguar, kryesisht pas pagesës së 70% të vlerës, si dhe puna e kryer manualisht nga DAP dhe DEP, ul ndjeshëm eficienten e këtyre drejtorive si dhe rrit kostot në kohë.

Për këtë rekomandojmë:

11. AZHBR të marri masat e nevojshme për të rregulluar pasaktësitë që rezultojnë prej sistemit që gjeneron vlerën për tu financuar ndaj përfituesve, me qëllim shmangien e punës manuale, gabimeve njerëzore që mund të krijohen prej punës manual si dhe për rakordim të plotë e të saktë.

Menjëherë

3.3. A janë arritur objektivat në administrimin e skemave dhe fondeve për mbështetjen e zhvillimit të bujqësisë?

Politikat shtetërore në fushën e bujqësisë përqendrohen në objektivat dhe masat, që veprojnë drejtpërsëdrejti në tregjet agro-ushqimore dhe të ardhurat nga ferma, e lidhur kjo në masë të konsiderueshme me financimin e skemave kombëtare. Me masat për zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimit të zonave rurale synohet të arrihen objektivat e përgjithshëm, si më poshtë:

- a) rritja e të ardhurave për popullsinë rurale, duke rritur mirëqenien e saj, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës dhe të jetesës, si dhe duke krijuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë;
- b) rritja e prodhimit nëpërmjet nxitjes së konkurrueshmërisë dhe të progresit teknik, si dhe garantimit të një përdorimi optimal të faktorëve të prodhimit dhe në veçanti të punës;
- c) stabiliteti i tregut, duke garantuar qëndrueshmëri në prodhimin bujqësor;
- ç) cilësia dhe siguria ushqimore, duke garantuar që zinxhiri ushqimor të ketë një cilësi të qëndrueshme dhe të mos shkaktojë pasoja të dëmshme në shëndetin e njerëzve;
- d) mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, duke garantuar që bujqësia të ruajë burimet natyrore;
- dh) ulja e varfërisë, e cila synon zvogëlimin e pabarazive ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme, si edhe të prapambetjes së zonave rurale, më pak të favorizuara, duke zhvilluar veprimtari alternative dhe plotësuese, që gjenerojnë punësim, me synim ngadalësimin e largimit të popullsisë nga fshatrat, si dhe duke fuqizuar biznesin e vogël dhe të mesëm.⁶⁰

Parë në tërësi, grupi i auditimit të KLSH, analizoi arritjen e këtyre objektivave në përgjithësi nëpërmjet rasteve të skemave kyçe për nga rëndësia (informimin), numrin e konsiderueshëm të aplikantëve (mbrojtja nga miza e ullirit) dhe vlera e lartë në totalin e skemave (investimet), si dhe auditimin e një prej fazave më të rëndësishëm të skemave kombëtare: atë të monitorimit.

3.3.1 A kanë ndikuar fondet për publicitetin në efektivitetin e granteve të dhëna?

Informimi mediatik i publikut është një aspekt i rëndësishëm për efektivitetin e fondeve buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural, menaxhimi dhe zbatimi i suksesshëm i të cilit siguron informacion të përshtatshëm, planifikim të kujdesshëm të aktiviteteve të publikimit, si dhe audiencën e synuar. Objektivi kryesor në këtë rast është njohja e publikut lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, duke rritur kapacitetet e prodhimit, për të modernizuar teknologjinë e mbi të gjitha, për të përmirësuar produktet dhe sigurinë ushqimore. Në mënyrë më të detajuar duhet të synohet rritja e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë për rolin dhe kontributin e buxhetit të shtetit në zhvillimin bujqësisë në vendin tonë; sigurimin e informacionit transparent mbi mundësitë e ofruara nëpërmjet masave për të gjitha grupet e synuara; për të evidentuar rezultatet e zbatimit të fondeve në zhvillimin rural të Shqipërisë etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Në përputhje me masat e caktuara vjetore, informimi mediatik i drejtohet përfituesve potenciale të granteve buxhetore, të cilët mund të jenë fermerë individualë dhe subjekte me status fizik, juridik ose SHBB (Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor). Efektiviteti i përdorimit të këtij fondi varet në mënyrë të konsiderueshme, krahas të tjerave, nga dhënia në kohë, në sasi dhe në mënyrë korrekte e këtij informacioni mediatik.

Fondet buxhetore të akorduara për zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave për vlerën gjithsej, sektorët që do të mbështeten (prodhimi i frutave; perimeve ne sera, përmirësimi racor, nxitja e kreditimit etj.), masa e mbështetjes (Mbështetje për përmirësimin e teknologjisë së kultivimit dhe mbrojtjes së bimëve, mbështetja e sektorit të akuakulturës, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, etj.), si dhe masa e përfitimit për secilin prej tyre. Në një zë të veçantë të këtyre vendimeve është përcaktuar fondi për informimin mediatik të publikut, lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Në periudhën e auditimit vlerat e këtij fondi kanë lëvizur nga 5,000,000 për vitin 2013, në 13,000,000 lekë në 2014 dhe 35,000,000 për secilin vit në periudhën 2015-2017.

Për vitin 2017, meqenëse të dhënat mbi numrin e përfituesve nuk kishin dalë akoma dhe pasqyra nuk behet e krahasueshme me periudhat e mëparshme, është marrë në konsideratë për analizë vetëm periudha 2013-2016.

Pasqyra nr. 10 Disa tregues mbi efektivitetin e fondeve për informim mediatik 2013-2016

Emërtimi	2013	2014	2013/2014	2015	2015/2014	2016	2016/2015
Fonde gjithsej	927,441,471	1,215,369,710	131.0	1,599,467,670	131.6	1,534,121,127	95.9
Fonde për informim	5,000,000	13,000,000	260.0	35,000,000	269.2	35,000,000	100.0
<i>Në përqindje ndaj fondeve</i>	<i>0.54</i>	<i>1.07</i>	<i>-</i>	<i>2.19</i>	<i>-</i>	<i>2.28</i>	<i>-</i>
Aplikues	6,483	21,086	325.3	13,028	61.8	20,321	156.0
Përfitues	5,601	8,772	156.6	12,718	145.0	11,516	90.5
Numri i skemave	19	15	78.9	19	126.7	15	78.95

Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga analiza në dinamikë konstatohet se në vitin 2014 ky fond rritet 87 % në krahasim me një vit më parë dhe rritet gati trefish në 2015, duke mbetur i pandryshuar për vitet në vijim. Veç kësaj, vërehet dhe një rritje e konsiderueshme e përqindjes së parave të shpenzuara ndaj fondeve buxhetore gjithsej nga 0.5 % në vitin 2013 në 2.3 % në vitin 2016. *Nga ana e AZHBR, nuk ka pasur ndonjë relacion mbi motivet e rritjes së këtij fondi, por është parë thjeshtë si fond që duhet shpenzuar sipas destinacionit të caktuar.* Megjithëse vlera e fondit për informim mediatik përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave, *AZHBR nuk ka përgatitur strategji komunikimi për të përcaktuar objektivat, grupet e synuara, mjetet, treguesit etj., dhe një set indikatorësh për të matur efektivitetin e kësaj pjese të rëndësishme të fondeve buxhetore.*


Rritja e vëllimit të fondeve për informimin e publikut është shqyrtuar edhe në raport me numrin e skemave të caktuara për çdo vit. Në mënyrë të arsyeshme, rritja e numrit dhe llojit të skemave përfituese do të kërkonte edhe një informacion shtesë për publikun, i cili detyrimisht sjell për pasojë dhe rritjen e shpenzimeve për këtë qëllim. *Të dhënat tregojnë se rritja e parave buxhetore për informim mediatik nuk ka lidhje me numrin e skemave përfituese, pasi numri i tyre për çdo vit ka qenë midis 15-19 skemave. Për më tepër, që në vitin 2014 dhe 2016 ndërsa rriten fondet për informim ulet nga 19 në 15 numri i skemave përfituese.* Gjithashtu, duhet theksuar se në periudhën 2013 - 2017, në pjesën më të madhe nuk kemi ndryshim as të llojit të skemave. *Të gjitha këto demonstrojnë se nuk është synuar dhe nuk ka pasur një përdorim me efektivitet të fondeve për informimin mediatik të publikut për skemat kombëtare të zhvillimit të bujqësisë dhe rural.*



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Një nga indikatorët e drejtpërdrejtë të efektivitetit të përdorimit të fondeve për informim është rritja e numrit të aplikuesve nga viti në vit, si rezultat i rritjes së vëllimit të informacionit, për shkak të rritjes së vlerës së fondeve. Sipas të dhënave të AZHBR, në vitin 2014 fondet për informimin e publikut janë rritur 2.6 herë ndërsa aplikuesit 3.25 herë, gjë që nuk ndodh në periudhat e mëvonshme. Kështu, në vitin 2015 vazhdojnë të rriten shpenzimet për publicitetet gati 2.7 herë, ndërsa numri i aplikuesve ka rënie të ndjeshme në krahasim me një vit më parë, mbi 8 mijë. Lubatje të tilla tregojnë se nuk ka një lidhje të fortë midis informacionit të shpërndarë publikut dhe aplikuesve për grante në skemat kombëtare.

Grafiku nr. 6 Ecuria e fondeve për informim dhe e numrit të aplikuesve 2013 - 2016



Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH


Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AZHBR, rezulton se për fondin e informimit mediatic të publikut, është kërkuar zbatimi i VKM nr. 1195 datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, bashkëprodhimin e programeve dhe reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizive ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”. Efektiviteti i shpenzimeve buxhetore për informim varet në mënyrë të konsiderueshme dhe nga cilësia e dhënies së këtij informacioni, i cili shprehet në raportin midis aplikuesve dhe përfituesve. Krahas të disa faktorëve të tjerë, cilësia e informacionit sjell si pasojë prirje të njëjtë të aplikimeve për grante dhe përfituesve të tyre nga fondet buxhetore. Çdo përthyerje e këtij raporti, demonstroi më së paku cilësi të dobët informacioni ose shpenzimet për këtë qëllim nuk kanë pasur ndonjë efekt të dukshëm dhe të matshëm në arritjen e objektivave për të cilën shpenzohen. Sipas të dhënave të AZHBR, konstatohet se ka ndryshime të theksuara në numrin e aplikuesve nga viti në vit, ndërsa ka tendencë në rritje të përfituesve të granteve nga skemat kombëtare.

AZHBR është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programeve për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, dhe në këtë kuadër edhe të atyre për informimin e publikut, si pjesë e shpenzimeve buxhetore. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, AZHBR në shpenzimin e fondeve për informacionin mediatic të publikut ka përdorur procedurën e përcaktuar në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008, duke u kufizuar në përgatitjen e shfaqjen e disa spoteve televizive dhe botimin e njoftimeve në median e shkruar. Megjithatë duke filluar nga viti 2015, në VKM-të për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, vlera e fondeve për informacionin mediatic të publikut është zgjeruar në fonde për aktivitete informuese për publikun, AZHBR ka vazhduar me zbatimin e VKM nr. 1195. Nga kjo arrihet në konkluzionin se, AZHBR nga viti 2015 e në vazhdim ka pasur mundësitë ligjore që të zgjerojë mjetet e komunikimit me publikun edhe me fletëpalosje, broshura, postera, takime informative rajonale, workshop-e etj., për të mos u kufizuar vetëm në spote televizive dhe botim njoftimesh në gazeta.

Grafiku nr. 7 Ecuria e numrit të aplikuesve dhe të përfituesve 2013 - 2016



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”



Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Kjo tregon se informacioni i transmetuar ka qenë me cilësi të ulët, dhe për pasojë mungesë efektiviteti të shpenzimeve për këtë qëllim.

Me rëndësi në efektivitetin e përdorimit të fondeve për aktivitete informuese është mënyra e menaxhimit dhe administrimit të tij nga ana e AZHBR. Siç është cilësuar më lart, AZHBR në përdorimin e këtij fondi është bazuar në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008. Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj dhe analizoj në dinamikë veprimtarinë e AZHBR për përdorimin e këtij fondi, duke cilësuar vitin 2013 si vit bazë me eficiencë dhe efektivitet optimal në treguesit e mësipërm të munguar, si dhe me kohëzgjatje normale për zbatimin e procedurës përkatëse.

Kështu, në vitin 2014 janë përcaktuar në VKM për informacionin mediatic të publikut lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural 13,000,000 lekë ose 2.6 herë më shumë se një vit më parë. Procedura ka nisur me datë 17.04.2014, pothuajse 22 ditë pas daljes së VKM-së dhe ka përfunduar me nënshkrimin e kontratës me datë 23.04.2014 me afat deri më 24.05.2014, pra për një muaj. Sipas VKM përkatës, periudha e aplikimit është pothuajse e shtirë plotësisht në periudhën 2-30.5.2014. Në urdhrin përkatës për blerjen dhe zhvillimin e spotit/reklamës publicitare është përcaktuar, krahas të tjerave, objekti i spotit në 10 sektorët që mbështeten nga skemat kombëtare, spoti prej 30 sekonda në transmetim në 3 variante dhe 60 sekonda spoti kryesor, periudha e shfaqjes 15-30 ditë, fondi limit në të njëjtën vlerë me atë në VKM prej 13,000,000 lekë etj. *Kjo tregon se nga ana e AZHBR është konsideruar si një fond që duhet shpenzuar domosdoshmërisht, meqë është vendosur në VKM, pa përcaktuar dhe tregues të efektivitetit të këtij fondi.* Komisioni i zhvillimit të procedurës po në këtë datë ka përcaktuar shpeshhtësinë e shfaqjes 2 - 4 herë në ditë, periudhën e fillimit datë 22.04.2014 dhe përfundim sipas specifikimeve teknike, pra libet e hapur, kur në urdhrin është 15 - 30 ditë, është përcaktuar objekti i reklamës në 13 sektorë, pra janë shtuar 3 të tjerë në krahasim me urdhrin: Ujitja me pika, Rehabilitimi i blloqeve të ullishteve dhe mbarështimi intensiv i kërmillit. Gjithashtu janë përcaktuar dhe televizioni kombëtar TVSH për 15 ditë, pa motivuar afatin, duke cilësuar mundësisht dhe TV Klan, Top Channel dhe Vizion Plus edhe në TV të tjera me natyrë informative, si dhe 11 televizione lokale me emërtimet përkatëse, pa pasur ndonjë kriter të veçantë. Gjithashtu është shtuar dhe publikimi i reklamës në jo më pak se 3 gazeta me tirazh më të madh të përzgjedhur nga vetë operatori me format ¼ faqe, e cila nuk ka qenë e vendosur në urdhrin përkatës për fillimin e kësaj procedure. Në raportin përfundimtar të datës 22.04.2014 është vendosur të propozohet subjekt i përzgjedhur “Unlimited media” me pikët më të shumta (95) dhe 2 subjektet e tjera janë skualifikuar, si dhe me 99.8 % të fondit limit. Në procesverbal nuk është cilësuar asnjë nga treguesit e tjerë si numri i spoteve, kohëzgjatja, numri i tv, gazetave shpeshhtësia, periudha etj., si dhe komisioni nuk ka në përbërje asnjë specialist në fushën e medias dhe të komunikimit. Mbi këtë bazë është lidhur kontrata e porosisë më datë 23.04.2014 me afat deri më 24.05.2014, pa përcaktuar në shifra fikse për TV Klan, Top Channel dhe Vizion Plus edhe në TV të tjera me natyrë informative (Ora News, A1 Report, News 24, Agon Channel dhe Vizion Plus), po kështu dhe botimet në gazeta. Në të njëjtën datë është nënshkruar shtesë kontrate për të ndryshuar dy tv lokale në Gjirokastrë dhe Fier me shkakun se nuk kanë shtrirje në të gjithë territorin e qarqeve, sikur nuk është njohur më parë që në ftesën për ofertë. Nga monitorimet e komisionit rezultojnë se në tv lokale mungon ai i Fierit, Kukësi nuk ka sjellë CD dhe në dy kanale



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

të tjera nuk jepen datat e fillimit dhe të përfundimit të dhënies së spotit, si dhe në CD e sjella nga operatori fitues është përfshirë TV Alpo i cili në shtesën e kontratës është zëvendësuar me TV GJ.

Për vitin 2015 fondi i përcaktuar në VKM është 35,000,000 lekë dhe urdhri për krijimin e grupit të punës për përcaktimin e specifikimeve teknike të procedurës së publicitetit ka dalë më datë 05.02.2015. Në këtë urdhër është përcaktuar dhe komisioni për zhvillimin e procedurës me përbërje dhe në të njëjtën datë është mbajtur procesverbali për specifikimet teknike për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe transmetimin e spoteve/reklamave. Në këtë procesverbal është përcaktuar blerja dhe zhvillimi i 7 spoteve, pa përcaktuar periudhën e transmetimit të reklamës. Në përcaktimin e fondit limit, komisioni pretendon të jetë bazuar në studimin e tregut për prodhimin e spoteve duke marrë oferta nga 3 subjekte dhe duke llogaritur mesataren për 11,733,333 lekë pa TVSH ose jo më shumë se 40 % e fondit total prej 35,000,000 lekë. Sipas dokumentacionit në dosjet përkatëse ofertat që kanë shërbyer për përllogaritjen e fondit janë pa datë dhe pa numër protokolli, të cilat nuk plotësojnë kushtet e një dokumenti justifikues dhe argumentues për një çështje të tillë monetare. Për më tepër, që AZHBR në përcaktimin e fondit për këtë qëllim mund të bazohet në përvojat e mëparshme. Mjafton të theksojmë se çmimi mesatar për sekondë krabasuar me ofertat e vitit 2014 është 6.6 herë më i lartë. Kjo do të thotë se do të mjaftonin 2 milion lekë për prodhimin e spoteve dhe mbi 9 milion lekë janë shpenzime pa efektivitet.

Në urdhër është përcaktuar prodhimi i 7 spoteve, me transmetim 2-4 herë në ditë, me kohëzgjatje 30-45 sekonda dhe shpeshësi 30 ditë për 6 spote dhe gjatë gjithë vitit spoti kryesor. Në po të njëjtën datë komisioni i specifikimeve teknike ka përcaktuar prodhimin e 7 spoteve me kohë zgjatje jo më pak se 30 sekonda dhe transmetim 2 herë në ditë për 30 ditë (kur ofertat janë marrë për transmetim vetëm 30 sekonda dhe transmetim një herë në ditë) si dhe reklamimi në gazeta në jo më pak se 5 gazeta (në një kohë që ofertat janë marrë për 3 të tilla dhe nuk është e përfshirë në urdhër) pa përcaktuar kohëzgjatjen. Në mënyrë të veçantë është vendosur transmetimi i spotit institucional në vlerë 2 milion lekë. Kontrata e datës 03.03.2015, ka kohëzgjatje të spoteve: 2 nga 50 sekonda; 1 është 47 sekonda, pra jashtë përcaktimeve në urdhër, në ofertë dhe nga komisioni i specifikimeve teknike; shfaqja në 9 tv kombëtare nga 8 dhe në 12 nga 10 tv lokale të përcaktuara nga komisioni i specifikimeve teknike. Po ashtu dhe shfaqja e tyre është ndarë në 4 faza, pa përcaktuar shpeshësinë e tyre, ndryshe nga sa është përcaktuar në specifikimet teknike: faza e parë deri më 03.04.2015 që përkon me përfundimin e aplikimeve sipas Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave; faza e dytë 20.04.2015 deri më 15.05.2015 dhe faza e tretë 05.09.2015-25.09.2015 për spotin institucional i cili nuk i ka shërbyer informimit të aplikueseve, pasi aplikimet janë mbyllur më datë 03.04.2015. Kjo tregon se shpenzimet për aktivitet informuese janë keqmenaxhuar dhe nuk janë përdorur me efektivitet.

Për vitin 2016 janë parashikuar 35 milion lekë për aktivitete informuese për publikun lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural në VKM nr. 91, datë 10.02.2016, për periudhë e aplikimit 15 mars - 13 prill, sipas Udhëzimit nr. 2, datë 17.02.2016. Në datë 17.02.2016 ka dalë Urdhri nr. 63 për krijimin e komisionit të specifikimeve teknike me afat dy ditor zbatimi. Më datë 26.02.2016 komisioni ka mbajtur procesverbalin (pra më shumë se 3 javë pas afatit të përcaktuar në urdhër) ka përcaktuar numrin e spoteve prej 9 të tilla. Për përcaktimin e fondit që nevojitet për prodhimin e spoteve kanë përdorur 3 oferta dhe ju ka rezultuar 40 % e fondit total. Duhet theksuar se ofertat nuk përmbajnë numër dhe datë protokolli, si dhe fjar është më e rëndësishmja, megjithëse 2 spote më shumë dhe të gjithë me kohëzgjatje më të madhe 30-50 sekonda se një vit më parë, kushtojnë aq sa ishin një vit më parë, duke përforcuar konkluzionin e mungesës së përdorimit me efektivitet të fondeve për këtë qëllim. Ndryshe nga një vit më parë, kur spoti institucional për 1 herë në ditë për 30 ditë në tv kombëtare për 30 sekonda është vlerësuar 2,000,000 lekë, në vitin 2016 është përcaktuar 5,000,000 lekë, me të njëjtat kushte, pra 3,000,000 lekë më shumë, të cilat janë plotësisht pa asnjë lloj efektiviteti. Si përfundim, komisioni arrin në përfundimin për 8 spote jo më pak se 30 sekonda 2 herë në ditë për 30 ditë, jo më vonë se data 13 mars; spoti institucional për një muaj në periudhën shtator/tetor; botimi në 5 gazeta për jo më pak se 30 ditë.

Me datë 29.02.2016 ka dalë Urdhri për blerjen prodhimin e spoteve/reklamave publicitare 2016 për 9 spote (8+1 institucional), 8 jo më pak se 2 herë në ditë për 30 ditë jo më vonë se data 13 mars 2016



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

dhe spoti institucional për një muaj në periudhën shtator/tetor; botimi në 5 gazeta për jo më pak se 30 ditë.

Më datë 07.03.2016 është lidhur kontrata, me afat 07.03.2016 deri më datën 30.11.2016, kur në fakt aplikimet mbyllen më datë 13.04.2016; e ndarë në dy faza duke u mbyllur më 11.04.2016 (fillon më datë 13.03.2016) *faza e parë për 8 spote (pra 2 ditë para përfundimit të afatit të aplikimit); faza e dytë shtator-tetor promovimi i AZHBR. Në këtë mënyrë arrihet në konkluzionin se një pjesë e konsiderueshme e këtij fondi ka shkuar për promovimin e AZHBR se sa të skemave kombëtare, aq më tepër që është mbyllur 3 ditë para aplikimeve.*

Për vitin 2017, janë akorduar 35,000,000 lekë për aktivitete informuese për publikun lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, aplikime të periudhës 2 - 31 maj sipas Udhëzimit të datës 31.03.2017. Gjatë periudhës së auditimit, në këtë vit janë përcaktuar në Udhëzimin e përbashkët kriteret e përdorimit të fondit: jo më shumë se 40 % për ideim, krijim dhe prodhimin e 9 spoteve jo më pak se 30 sekonda, jo më pak se 2 herë në ditë për 30 ditë rresht dhe botimi në 5 gazeta me tirazhin më të madh. Më datë 20.04.2017 është mbajtur procesverbali për specifikimet teknike për prodhimin e 9 spote me 40 % të fondit limit, dhe shfaqjen për jo më pak se 30 sekonda për jo më pak se 2 herë në ditë, jo më vonë se data 02.05.2017 dhe jo më pak se 5 gazeta, *por që nuk ka dokumentacion argumentues.* Kontrata është lidhur më datë 26.04.2017 me afat 02.05.2017 deri më 31.05.2017. Megjithëse, janë 9 spote, 8 televizionev kombëtare dhe natyrë informuese, 11 lokale dhe 10 gazeta për një periudhë 25 ditore, me më pak sekonda për spot dhe një muaj më pak për spotin institucional.

Në të gjitha udhëzimet e përbashkëta të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave të dala çdo vit për zbatimin e skemave kombëtare është përcaktuar midis të tjerave, që MBZHRAU dhe AZHBR hartojnë dhe zbatojnë një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për skemat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfutuar mbështetje financiare nga fondi i programit për mbështetjen e prodhimit bujqësor dhe zhvillimin rural. *Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR janë mjaftuar vetëm me spotet publicitare dhe botimin në median e shkruar, pa patur një plan informimi dhe ndërgjegjësimi të mirëfilltë në shërbim të të gjitha grupeve të interesit.*

Megjithëse fondet për informim përbëjnë mbi 2% të fondeve gjithsej ato nuk kanë qenë objekt auditimi nga ana e sektorit përkatës në AZHBR.

Si konkluzion,

- Nga analiza në dinamikë e fondeve për informim konstatohet se në 2014 janë shtuar 87 % në krahasim me një vit më parë, rriten gati trefish në 2015, e shoqëruar kjo dhe me një rritje të konsiderueshme në përbërje të buxhetit të shpenzuar gjithsej nga 0.5 % në vitin 2013 në 2.3 % në vitin 2016. Të dhënat tregojnë se rritja e parave buxhetore për informim mediatik nuk ka lidhje me numrin e skemave përfituese, pasi numri i tyre për çdo vit ka qenë midis 15-19 skemave. Për më tepër, që në vitin 2014 dhe 2016 ndërsa rriten fondet për informim ulet nga 19 në 15 numri i skemave përfituese. Gjithashtu, duhet theksuar se në periudhën 2013 - 2017, në pjesën më të madhe nuk kemi ndryshim as të llojit të skemave. Të gjitha këto demonstrojnë se nuk është synuar dhe nuk ka pasur një përdorim me efektivitet të fondeve për informimin mediatik të publikut për skemat kombëtare të zhvillimit të bujqësisë dhe rural.

- Sipas të dhënave të AZHBR, në vitin 2014 fondet për informimin e publikut janë rritur 2.6 herë ndërsa aplikuesit 3.25 herë, gjë që nuk ndodh në periudhat e mëvonshme. Kështu, në vitin 2015 vazhdojnë të rriten shpenzimet për publicitetet gati 2.7 herë, ndërsa numri i aplikuesve ka rënie të ndjeshme në krahasim me një vit më parë, mbi 8 mijë. Luhatje të tilla tregojnë se nuk ka një lidhje të fortë midis informacionit të shpërndarë publikut dhe aplikuesve për grante në skemat kombëtare.

Ky konkluzion është vlerësuar dhe konfirmuar dhe nga observacionet e AZHBR, me nr. 639/3 prot., datë 29.12.2017, dhe janë shprehur se në strukturën e re të AZHBR, sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.190, datë 06.11.2017, Sektori i ri i Promocionit dhe Komunikimit do të përdorë kanale të ndryshme komunikimi duke ndihmuar në informimin e fermerëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

- Në periudhën 2013-2016 ka ndryshime të theksuara të raportit aplikues: përfitues nga 41.5 % në vitin 2014 në 98 % në 2015, duke demonstruar më së paku cilësi të dobët informacioni ose shpenzimet për këtë qëllim nuk kanë pasur ndonjë efekt të dukshëm dhe të matshëm në arritjen e objektivave për të cilën shpenzohen.

Për këto rekomandojmë:

1. AZHBR të hartojë një relacion të veçantë mbi mënyrën e përdorimit të fondit për informimin e publikut për të argumentuar nevojat e domosdoshme, duke e lidhur me numrin e skemave, numrin e aplikuesve, ndryshimet, numrin e përfatuesve etj., me synim ofrimin e informacionit sasior dhe cilësor për fermerët, duke rritur efektivitetin e këtyre shpenzimeve buxhetore.

Çdo vit, menjëherë pas alokimit të buxhetit

- Nga ana e AZHBR, nuk ka pasur ndonjë relacion mbi motivet e rritjes së këtij fondi, por është parë thjeshtë si fond që duhet shpenzuar sipas destinacionit të përcaktuar në VKM. AZHBR nuk ka përgatitur strategji komunikimi për të përcaktuar objektivat, grupet e synuara, mjetet, treguesit etj., dhe një set indikatorësh për të matur efektivitetin e kësaj pjese të rëndësishme të fondeve buxhetore.

Për këtë rekomandojmë:

2. AZHBR të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë strategjinë e komunikimit, duke përcaktuar objektivat, grupet e synuara, mjetet, treguesit etj., si dhe një set indikatorësh për të matur efektivitetin e kësaj pjese të rëndësishme të fondeve buxhetore.

Brenda tremujorit të parë 2018

- Megjithëse duke filluar nga viti 2015, në VKM-të për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, vlera e fondeve për informacionin mediatik të publikut është zgjeruar në koncept, në fonde për aktivitete informuese për publikun, AZHBR ka vazhduar me zbatimin e VKM nr. 1195 datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, bashkëprodhimin e programeve dhe reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizive ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, megjithëse ka pasur mundësitë ligjore që të zgjerojë mjetet e komunikimit me publikun edhe me fletëpalosje, broshura, postera, takime informative rajonale, workshop-e etj., për të mos u kufizuar vetëm në spote televizive dhe botim njoftimesh në gazeta.

Për këtë rekomandojmë:

3. AZHBR ta përdorë fondin për informimin e publikut duke zgjeruar mjetet e komunikimit edhe me fletëpalosje, broshura, postera, takime informative rajonale, workshop-e etj., për të mos u kufizuar vetëm në spote televizive dhe botim njoftimesh në gazeta.

Çdo vit, para periudhës së aplikimit

- Veprimtaria menaxhuese e AZHBR në periudhën 2013-2016 për fondin e informimit është shoqëruar me mangësi të natyrave të ndryshme si: kanë munguar në këtë proces specialistë të komunikimit; ka raste të nisjes me shumë vonesë të zbatimit të procedurës; nuk janë përcaktuar tregues të efektivitetit të fondit; diferenca në tregues të ndryshëm (periudhë, kohëzgjatje, numër spotesh etj) midis urdhrimit të nisjes së procedurës, përcaktimeve të komisionit dhe kontratës së nënshkruar për këtë qëllim; gjatë monitorimit kanë rezultuar mangësi në transmetimin e spoteve të cilat kanë ndikuar në rezultatet e informacionit; në përcaktimin e fondit limit, komisioni pretendon të jetë bazuar në studimin e tregut për prodhimin e spoteve duke marrë oferta nga 3 subjekte, të cilat janë pa datë dhe pa numër protokolli, pra nuk plotësojnë kushtet e një dokumenti justifikues dhe argumentues për një çështje të tillë monetare; vonesa në zbatimin e urdhrave për këtë procedurë etj.

- Në vitin 2015, çmimi mesatar për sekondë krahasuar me ofertat e vitit 2014 në vitin 2015 është 6.6 herë më i lartë, që do të thotë se mbi 9 milion lekë janë shpenzime pa efektivitet; janë transmetuar spote në dy periudha (faza) jashtë afatit të aplikimit, çka tregon se këto shpenzime nuk kanë qenë në funksion të informimit të fermerëve.

- Për vitin 2016, ndryshe nga një vit më parë, kur spoti institucional është vlerësuar 2,000,000 lekë, në vitin 2016 është përcaktuar 5,000,000 lekë, me të njëjtat kushte, pra 3,000,000 lekë më shumë, të cilat janë plotësisht pa asnjë lloj efektiviteti, si dhe është paguar shfaqja e spotit jashtë afatit të aplikimeve



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

për promovimin e AZHBR, dhe jo të skemave kombëtare, aq më tepër që është mbyllur 3 ditë para aplikimeve.

Për këto rekomandojmë:

4. AZHBR të marrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin rigoroz të procedurës së ideimit, prodhimit dhe shfaqjes së spoteve publitare, duke përfshirë specialistë të komunikimit, në funksion të emetimit të informacionit të nevojshëm dhe cilësor për skemat kombëtare, duke rritur efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve.

Vazhdimisht

Ky rekomandim është vlerësuar dhe konfirmuar dhe nga observacionet e AZHBR, me nr. 639/3 prot., datë 29.12.2017, dhe janë shprehur se në strukturën e re të AZHBR, sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.190, datë 06.11.2017, është detyrë funksionale e sektorit të ri të Promocionit dhe Komunikimit.

- Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR nuk kanë hartuar dhe zbatuar një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për skemat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfitur mbështetje financiare nga fondi i programit për mbështetjen e prodhimit bujqësor dhe zhvillimin rural, sipas kërkesës së vendosur në udhëzimin përbashkët për zbatimin e skemave kombëtare.

Për këtë rekomandojmë:

5. Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të hartojnë dhe të zbatojnë planin e informimit dhe ndërgjegjësimi të grupeve të interesit për skemat, kriteret dhe kushtet e përfitimit të mbështetjes financiare nga fondi buxhetor për zhvillimin e bujqësisë dhe të rajoneve.

Brenda muajit shkurt 2018

- Megjithëse fondet për informim përbëjnë mbi 2% të fondeve gjithsej ato nuk kanë qenë objekt auditimi nga ana e sektorit përkatës në AZHBR.

Për këtë rekomandojmë:

6. Sektori i auditit të brendshëm në AZHBR të ushtroj një auditim tematik mbi menaxhimin e fondit për informimin e publikut, duke evidentuar dhe adresuar problematikat përkatëse.

Çdo vit, pas përfundimit të përdorimit të fondeve për informim

Ky rekomandim është vlerësuar dhe konfirmuar dhe nga observacionet e AZHBR, me nr. 639/3 prot., datë 29.12.2017, dhe janë shprehur se Sektori i Auditit të Brendshëm do të ushtrojë auditim tematik për auditim tematik për menaxhimin e fondit për informimin e publikut.

3.3.2 Sa efektive kanë qenë financimet buxhetore për mbrojtjen e ullirit në vendin tonë?

Duke filluar nga viti 2014, një ndër sektorët që është mbështetur nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural është dhe prodhimi i ullirit, nëpërmjet mbrojtjes së ullishtave nga dëmtimi prej mizës së ullirit, në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit, në vlerën jo më shumë se 35,000 lekë/ha. Duke analizuar përfituesit dhe masën e përfitimit për periudhën 2014-2016 konstatohet se, janë cilësuar për skemën e mbrojtjes së ullishtave nga dëmtimi prej mizës së ullirit 65.8 % e numrit gjithsej të përfituesve dhe 6 % e fondit buxhetor gjithsej.

Mbrojtja e ullishteve nga dëmtimi prej mizës së ullirit është paraprirë nga kriteret e përfitimit, procedura që do të ndiqet, veprimtaria monitoruese, verifikuese dhe pagesa për këtë shërbim. VKM - të kanë përcaktuar mbrojtjen e ullishteve nga dëmtimi prej mizës së ullirit, në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit, në vlerën jo më shumë se 35,000 lekë/ha. Në vitin 2014, për fermerët përfitues të propozuar nga DB në rrethe dhe përzgjedhur nga Ministria e Bujqësisë, gjë që nuk është përcaktuar në vitet e tjera, po ashtu nuk është përcaktuar dhe numri i rrënjëve për ha, dhe më pas jo më pak se 100 rrënjë, pra duke demonstruar një mungesë qëndrueshmërie në treguesit e kriterëve të përfitimit. Po ashtu ka ndryshime dhe në procedurat që duhet të ndiqen në lidhje me shkallën e hartave kadastrale që në 2014 nuk përcaktohet, pastaj është vendosur në shkallën 1:5000; në fillim vetëm listat emërore pastaj dhe me firmë; afati i dorëzimit të listave lëviz nga 15 mars në 20 maj etj. AZHBR-ja, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike, do të shpallë kriteret dhe subjektet fituese që do të realizojnë shërbimin. Metodologjia e luftimit të



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

mizës së ullirit, specifkimet teknike të preparatit që do të përdoret për trajtim, si dhe koha e trajtimit do të përcaktohen nga ekspertë të fushës në funksion të luftimit me efikasitet të dëmtuesit dhe mbrojtjes së mjedisit. Sipërmarrësi i shërbimit (operatori ekonomik), kryen shërbimin e kontraktuar në koordinim me pronarët e ullishtave dhe njofton AZHBR-në për përfundimin e shërbimit në secilin bllok, duke sjellë më pas listat e firmosura nga përfutuesit me sipërfaqen e trajtuar dhe numrin e rrënjëve. *Një fazë e rëndësishme për efikasitetin e kësaj skeme është verifikimi që duhet të bëhet nga AZHBR, i cili ka evoluar pas vitit 2014 në monitorimin dhe verifikimin e këtij shërbimi nëpërmjet grupeve të posaçme në të cilën përfshihen dhe specialistë të DB në rrethe.*

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj dokumentacionin e vënë në dispozicion për administrimin e kësaj skeme sipas viteve 2014, 2015, 2016 dhe 2017. Sipërfaqja dhe fondet e shpenzuara në periudhën 2014 - 2016 jepen në pasqyrën e mëposhtme, ndërsa për vitin 2017 fondet përkatëse janë administruar nga Ministria e Bujqësisë.

Pasqyra nr. 11 Sipërfaqja e ullishtave të mbrojtura nga miza sipas qarqeve 2014-2016

Emërtimi	2014	2015	2016
Sipërfaqja gjithsej Ha	2.109,73	3.081,28	3.687,60
<i>Vlorë</i>	<i>496,4</i>	<i>607,6</i>	<i>1.324,2</i>
<i>Tiranë</i>	<i>68,3</i>	<i>184,6</i>	
<i>Berat</i>	<i>810,9</i>	<i>818,7</i>	
<i>Fier</i>	<i>681,7</i>	<i>1.309,7</i>	<i>2.363,4</i>
<i>Lezhë</i>	<i>52,4</i>	<i>55,6</i>	
<i>Elbasan</i>		<i>105,1</i>	
Fonde të shpenzuara lekë	73.704.175	107.429.635	128.952.422

Burimi: Të dhëna të AZHBR, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, AZHBR gjatë alokimit të fondeve ka propozuar dhe Ministria e Bujqësisë miratuar këto vlera të fondeve sipas viteve për mbrojtjen e ullishteve nga miza.

Në 2014 sipërfaqja e trajtuar 2109.73 ha e shtrirë në 5 qarqe me pjesën më të madhe në Berat 38.4 %; në 2015 në 6 qarqe 3081.27 ha me përqendrim në Fier me 42.5 % dhe në vitin 2016 vetëm në 2 qarqe Vlorë dhe Fier një sipërfaqe prej 3687.6 Ha nga 5,352 të përcaktuar nga DB në qarqe. Pra nëse konsiderohen domosdoshmëri përcaktimet e DB ato në fakt nuk janë zhvilluar sipas kërkesës, duke ulur ndjeshëm efektin e kësaj mase në shkallë vendi.

Pasqyra nr. 12 Fondet e alokuara dhe të përdoruar 2014 - 2016

Në lekë

Viti	Programuar	Realizuar	Diferenca
2014	73.840.386	73.704.175	(136.211)
2015	107.845.549	107.429.635	(415.914)
2016	187.331.788	128.952.422	58.379.366)
Gjithsej	369.017.723	310.086.232	(58.931.491)

Burimi: Të dhëna të AZHBR, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sipas udhëzimit të vitit 2014, DB do të përcaktojnë paraprakisht të dhënat mbi hartat kadastrale të blloqeve që do të trajtohen; listën emërore të pronarëve dhe sipërfaqet përkatëse të ullishtave për të gjithë sipërfaqen që do të trajtohet; fillimin dhe përfundimin e periudhës së trajtimit, për secilin bllok, të cilat duhet të dorëzohen në AZHBR-Qendër, në rrugë protokollare brenda datës 15 maj 2014.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Sipas VKM nr. 173, datë 26.3.2014, mbrojtja e ullishtave nga dëmtimi prej mizës së ullirit, në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit jo më shumë se 35,000 lekë/ha, duhet cilësuar se në vitin 2008 ka qenë përcaktuar me VKM 17,000 lekë/ha (VKM nr. 10, datë 04.01.2008). Sipas udhëzimit përkatës trajtimi do të kryhet në blloqe me sipërfaqe jo më të vogla se 50 ha të cilët përcaktohen nga Drejtoritë e Bujqësisë (DB) në qarqe.

Me Urdhrin nr. 1479, datë 29.05.2014 është krijuar komisioni i përcaktimit të fondit limit. Megjithëse në dosje ndodhen tre oferta të paplotësuara, pa datë dhe njeri nga subjektet me aktivitet shitje artikuj të ndryshëm, ky komision mbi bazën e sipërfaqeve të sjella nga DB ka vendosur kufirin maksimal 35,000 lekë për ha dhe ka llogaritur fondin limit gjithsej për 5 lote: Berat, Fier, Vlorë, Tiranë dhe Lezhë, prej 61,533,655 lekë. *Një veprim i tillë nuk është në përputhje me VKM Nr. 1, datë 20.01.2007 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, i ndryshuar.* Gjithashtu, ky komision duhej të merrte në konsideratë të dhënat e DB për sipërfaqet nëse ato janë në blloqe mbi 50 Ha; numrin mesatar të rrënjëve për ha sipas loteve, pasi sipas teknikave të këtij shërbimi është e lidhur me vendosjen e kurtheve që të jetë efektiv dhe me sa më pak ndotje mjedisore.

Në përcaktimin e fondit limit, komisioni nuk ka marrë në konsideratë numrin e rrënjëve për ha, i cili është përcaktues në vendosjen e pesticidit që lufton mizën e ullirit. Kjo pasi sipas metodikes së sjellë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, për çdo dy rrënjë ullinj përdoret një pako pesticid (ECO TRAP-kurth), për një efekt sa më të mirë dhe me ndikime sa më të vogla në mjedis.

Sipas dokumentacionit të sjellë nga DB konstatohet se nënshkrimet e fermerëve (Fieri) pothuajse janë të njëjta, d.m.th fiktive; hartat kadastrale nuk provojnë se janë blloqe mbi 50 ha; nuk ka datën e fillimit dhe të përfundimit të trajtimit për secilin bllok; Lezha nuk ka paraqitur harta kadastrale por harta administrative, po kështu dhe Vlora. *Pra dokumentacioni i sjellë nga DB nuk është në përputhje me udhëzimin përkatës duke ulur ndjeshëm efektivitetin e kësaj mase për efekt të përcaktimit të fondit limit dhe monitorimit të kryerjes së këtij shërbimi.*

Sipas metodikes së Fakultetit të Bujqësisë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, baza kryesore për të patur një mbrojtje efektive për mizën e ullirit, është i nevojshëm monitorimi i dëmtuesit si dhe vlerësimi i dendësisë së tij, i cili fillon në fund të muajit Qershor. Mbi këtë bazë përcaktohen kufijtë e ndërhyrjes: për ullinj të për tavolinë kur vërehet prezenca e çpimeve të para dhe për ato për vaj 10-17 % të infeksionit aktiv. Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, drejtoritë e bujqësisë i kanë përcaktuar sipërfaqet dhe dërguar në AZHBR që në mesin e muajit maj (p.sh, Berati i ka dërguar më datë 13.05.2014, Vlora më 12. 05.2014 etj.)

KVO e ka shpallur fituesin, pa marrë shpjegime lidhur me vendosjen e numrit mesatar të rrënjëve të ullirit sipas loteve jo mbi bazën e faktit, por mbi bazën e ofertës. Kështu sipas dokumenteve të DB Vlorë, në fakt janë mesatarisht 150 rrënjë për ha, tenderi është shpallur fitues duke vendosur 240 rrënjë për ha, pra 90 rrënjë më shumë ose 37 %; për Fierin janë në fakt 153 rrënjë mesatarisht për ha dhe në tender janë marrë për 240 rrënjë për ha, ose 36 %; për Tiranën nga 191 rrënjë për ha në fakt, janë kontraktuar 240 ose 21 % më shumë, ndërsa në Fier nuk janë përcaktuar numër rrënjësh për sipërfaqe. Vendosja e një numri më të madh të kurtheve (ECO Trap) për ha, duke mos zbatuar metodikën e dhënë për këtë rast nga institucionet shkencore të vendit ul ndjeshëm efektivitetin e shërbimit për luftimin e mizës, rrit ndotjen e ambientit dhe në të njëjtën kohë ul efektivitetin e shpenzimeve të skemave kombëtare. Nga përlogaritjet. *Mbi bazën e trajtimit të mësipërm rezulton se mbi 40 % e këtij fondi ka qenë i panevojshëm që të shpenzohet dhe është përfituar padrejtësisht nga paaftësia e KVO prej operatorëve ekonomikë 24,807,177 lekë.*

Oferta fituese ka të kontraktuar me furnizuesin 250,000 “kurthe” dhe në kontratën me AZHBR për 253,296 copë, pra për 3,296 copë më shumë ose 800,928 lekë të përfituara, por të pajustificuara (3,296 x 243 lekë/copë) me kontratën e furnizimit.

Grupi i auditimit të KLSH i gjeti të bazuara një pjesë të konsiderueshme të observacioneve të AZHBR të datës 29.12.2017, lidhur me këtë çështje, të cilat gjejnë pasqyrim dhe saktësim në trajtimin e mësipërm.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Ofertuesi ka paraqitur për certifikate origjine sasinë prej 120.000 copë të datës 19.06.2014, dhe kontratë furnizimi të datës 20.05.2014 me subjekt importues të certifikatës së origjinës për 250,000 copë, pasi afati i përdorimit është 6 muaj.

Megjithëse në kontratën e furnizimit të datës 20.05.2014 çmimin e një ecotrapit e ka të përcaktuar jo më shumë se 200 lekë për copë, bashkimi i operatorëve është shpallur fitues me çmimin e ofertuar 218 lekë për copë.

Gjithashtu, sipas metodikës dhe etiketës së ofertuesit të shpallur fitues, eco-trap siguron një efekt më të mirë kur vendoset në fazën e forcimit të bërthamës së ullirit (mesi i qershorit, ditët e para të korrikut) në një kohë që tenderi është zhvilluar më datë 23.07.2014 dhe kontrata është nënshkruar më datë 12 gusht 2014, duke ulur ndjeshëm efektivitetin e përdorimit të tij.

Sipas TV “Ora news” në Tetorin e vitit 2014 në zonën e Lushnjës ka qenë problem miza e ullirit, megjithëse ka qenë përfshirë në trajtim për luftimin e mizës së ullirit, gjë që tregon për efektivitet të ulët të kësaj investimi.

AZHBR në observacionet e paraqitura në datën 29.12.2017, ka shpjeguar se ullishtet e Lushnjës nuk kanë qenë të përfshira në sipërfaqet e trajtuara nga ana e saj. Grupi i auditimit pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, e gjykoi të pabazuar këtë observacion, sepse një ndër qarqet e përfshira për trajtim për mizën e ullirit ishte dhe Fieri, çka nënkupton se rrjedhimisht duhet të ishte e përfshirë edhe zona e Lushnjës, si njësi administrative pjesë e këtij qaraku.

Në Vlorë, sipas dokumentacionit të pagesave të datës 18.09.2014 sipërfaqja e zonës Mifol prej 85.47 ha ka filluar trajtimin më datë 30.08.2014 dhe ka përfunduar për 3 ditë, listat e nënshkruara të përfituesve me nënshkrimin e kryeplakut mban datën 27.08.2014, pra kanë nënshkruar para kryerjes së shërbimit si dhe janë të njëjlojta, duke theksuar se 12 ha i janë vendosur QTTB Vlorë, e cila nuk ka dhe nuk duhet të ketë prodhim ullinj, si dhe 1 ha fshati Aliban pa adresë fare. Në këtë mënyrë 13 nga 85.47 ha ose 15.2 % e fondit për këtë sipërfaqe është fiktiv.

Për sipërfaqen tjetër prej 410.916 ha, nuk janë shënuar fare emrat e përfituesve, por inicialet e emrit dhe mbiemri, firmat janë të njëjta, nuk ka datë se kur është nënshkruar; si dhe numri kadastral/emërtimi i parcelës janë pakuptim, pasi Vlora nuk ka dorëzuar së bashku me listën hartë kadastrale.

Nuk ka përputhje afati i fillimit dhe mbarimit të trajtimit të blloqeve me përmbledhësen e operatorit ekonomik dhe aktverifikimit të punonjësve të AZHBR.

Operatori ekonomik ka paraqitur në ofertë fillimin me datë 10.08.2014 dhe në fakt ka filluar me datë 26.08.2014, ka ofertuar 32 ditë punë dhe 16 Ha në ditë në fakt janë 12 ditë pune; njoftimi për fillimin e trajtimit për bashkinë Vlorë është për datën 10.09.2014;

Verifikimi është kryer për një ditë, datë 03.09.2014 nga përfaqësuesit e AZHBR, të cilët janë shprehur për numrin e rrënjëve dhe numrin e ecotrapeve, sipërfaqen, duke verifikuar brenda ditës veprimtarinë disa ditore dhe të një grupi punonjësish.

Në Lezhe, listat janë me gabime, përsëritje emrash, pa nënshkrimin e autoriteteve zyrtare, nuk përputhet lista e DB me atë të OE për numrin e rrënjëve, psh Hekuran Bala 238 rrënjë nga DB dhe 138 në listën e trajtimit; Lulëzim Meta 2.5 ha dhe 950 rrënjë në trajtim 0.6 ha dhe 170 rrënjë etj.

Në Berat, sipas dokumentacionit në dosje listat nuk janë nënshkruar nga zyra e kadastrës dhe ato vendore, nënshkrimet pothuajse janë të njëjlojta dhe janë të nënshkruara 119 raste të pronës shtet, e cila përbën 9.4 % të sipërfaqes gjithsej të trajtuar për Beratin prej 810.9241 ha. Komisioni i verifikimit Isuf Mamani, Kujtim Pelivani dhe Ajet Hyka është kryer më datë 06.09.2014. Për rastin e Beratit firmat nuk përputhen nga aplikantët në përfituesit. Një pjesë e fotografive janë të njëjlojta në të gjitha lotët. Në vitin 2014 nuk përputhen asnjë nga firmat e fermerëve në propozim me ato në realizim të shërbimit, për më tepër që janë firmosur një numër i konsiderueshëm me pronar “shtet”.

Dokumentacioni i sjellë nga DB nuk përputhet me kërkesat e udhëzimit pasi nuk janë shoqëruara me hartë kadastrale dhe firmat e përfituesve janë pothuajse të gjitha njëjloj, për më tepër që në rastin e Beratit është firmosur dhe për prona me emërtimin “shtet”.

Në specifikimet teknike nuk është vendosur niveli i përmbajtjes së lëndës vepruese për çdo ecotrap; Drejtoritë raionale të bujqësisë Elbasan nuk kanë fokusuar bllokun që do të trajtohet me të oittha



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

shenjat treguese të shoqëruara me legjendën, në kundërshtim me udhëzimin përkatës; firmat e pronarëve të blloqeve janë të gjitha njësoj; po ashtu edhe DR e Lezhës; e cila gjithashtu në përmbledhëse shkruan 100 rrënjë për ha dhe nga rezultatet del 324 rrënjë.

Fituesi i lotit të Beratit ka kontraktuar blerjen e 80 mijë eco-trape dhe i kontraktuar dhe paguar për 81873 copë; Për Lezhën është llogaritur 239.4 leke për copë ose 8.8 % më shumë; Megjithëse Fieri dhe Lezha i referohen të njëjtit lot (1523002) certifikatat e analizave mbajnë të dhëna të ndryshme për përmbajtjen; Fituesi i Elbasanit që është i njëjtë me atë të Lezhës, çmimi për ecotrap është 243.97 lekë ose 11 % më shumë; etiketa mban datën e prodhimit 5 /2014; për te njëjtin lot prodhimi ka paraqitur dy certifikata analizë me të dhëna të ndryshme; certifikata e analizës nuk përputhet me të dhënat e etiketës së paraqitur për përmbajtjen e të dhënave; Për Beratin çmimi 250 lekë për copë ose 13.6 % më shumë; numri i ecotrapeve 1873 më shumë se sa sasia e kontratës së furnizimit 80,000 copë; Për Vlorën 276.36 lekë ose 25.6 % më shumë.

Tenderi mbajtur më 15.07.2015, në një kohë që preparati ka efekt në fazën e fillimit të forcimit të bërthamës fundi i muajit qershor dhe fillimi i muajit korrik.

Për Fierin Kontrata e furnizimit me çmim të eco-trapeve jo më shumë se 220 lekë për copë, në preventiv është vendosur çmimi i blerjes 282 lekë për copë ose 28 % më tepër. Për Fierin: kontrata nënshkruar më 02.07.2015, në ofertë është përcaktuar afati i kryerjes së shërbimit 1-25.08.2015, pra jashtë afateve të efektit maksimal fund Qershori fillimi i muajit Gusht, fatura mban datën 26.08.2015, dorëzuar më datë 2.08.2015; nuk ka njoftuar AZHBR për përfundimin e punës në secilin bllok.

Për Elbasanin: fatura 20.08.2015, afati i përfundimit Shtator 2015 në ofertë; Për Lezhën: kontrata datë 03.07.2015, fatura 24.08.2015, afati i përfundimit Gusht - Shtator 2015 në ofertë; Për Beratin 28.08.2015.

Në dosjen e dokumenteve të monitorimit për qarkun e Fierit, nuk është shënuar data e fillimit dhe përfundimit të trajtimit të secilit bllok; janë të nënshkruar dhe të vërtetuar për sipërfaqen e ullishteve me pronar shtet; fotot janë të copëzuara që i përkasin vetëm një blloku dhe jo të gjitha blloqeve.

Në rastin e Vlorës janë edhe foto që nuk vlejnë për monitorimin si ato për preparatin në disa kopje edhe të zmadhuara; një pjesë e fotografive janë njëloj për Vlorën dhe Sarandën; në rastin e Elbasanit janë 3 foto të cilat nuk pasqyrojnë drejtpërdrejtë monitorimin e procesit.

Në vitin 2016 fondi limit 156,109,823 lekë sipas shkresës së thesarit; në një shkresë të Ministrit të datës 01.04.2016 janë 187,331,788 lekë aq sa është parashikuar në fondin limit të komisionit.

Komisioni për përcaktimin e fondit limit më datë 21.03.2016, ka përjashtuar trajtimin e 3 blloqeve pasi nuk mund të provohet nëse janë në bllok, si dhe në një rast në Peqin një bllok i vetëm shtetëror, janë bazuar në oferta pa datë dhe nr. prot., si dhe në eksperiencat e mëparshme. Përcaktimi i fondit limit 35,000 lekë për ha është i gabuar pasi nuk merr në konsideratë numrin e rrënjëve për ha e lidhur kjo me nr. eco-trapeve, si dhe në eksperiencat e mëparshme duhej të kontrollohej emërtimi i blloqeve dhe mbi bazat e hartave kadastrale.

Në vitin 2016: Në Fier në fakt 167, që do të thotë 90 eco-trape për ha, në fakt kontraktuar 100 ecotrape +10; megjithëse për Vlorën nuk ka pasur numër rrënjësh, është përcaktuar numri i eco-trapeve.

Kontrata më datë 22.07.2016 për Fierin me vlerë gjithsej 82,644,808 lekë me afat nga data 01-31.08.2016 për 2363.36 ha, fatura datë 25.08.2016 për këtë shumë. Kërkesa për pagesë mban datën 25.08.2016 për sipërfaqen 2363.7055 ha, me vlerë 12.081 lekë më shumë se oferta;

Procesverbali i monitorimit dhe marrjes në dorëzim nga komisioni është i datës 25.08.2016, në të njëjtën ditë më kërkesën për pagesë, me datë përfundimi të shërbimit 22.08.2016 dhe për dy ditë kanë verifikuar këtë sipërfaqe dhe kanë numëruar vendosjen e 237,354 eco-trape-ve. Në procesverbalin e datës 01.08.2016 nuk janë shprehur për sasinë e ecotrapeve; megjithëse firmat e përfituesve janë njëloj, ato janë vërtetuar dhe nga komisioni me nënshkrimet e tyre; *Fotografitë e vendosura për monitorim janë të njëjtit që janë vendosur dhe për qarkun e Vlorës; Nuk përputhen nënshkrimet e përfituesve nga propozimet e DB me ato të përfituesve të dorëzuar nga operatori; hartat nuk janë kadastrale, nuk kanë legjendë, nuk kanë shkallën*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Me observacionet e paraqitura nga AZHBR me nr 639/3, janë shprehur se inspektorët nuk mund të kundërshtojnë nënshkrimet pasi nuk e kanë të përcaktuar në procedurë dhe për më tepër nuk janë ekspertë të fushës. Sipas grupit të auditimit vërtetësia dhe originaliteti i nënshkrimeve të përfituesve rrit besueshmërinë e procesit dhe AZHBR nuk duhet të shmanget nga kjo dukuri.

Në ofertë, afati i përfundimit 04 - 30.08.2016 për lotin e Vlorës; etiketa e përdorur është ajo e vitit 2015, por janë fshirë seria dhe data prodhimit; Procesverbali i monitorimit dhe marrjes në dorëzim është mbajtur në një ditë, 30.08.2016 në të njëjtën datë me përfundimin e shërbimit dhe njoftimin për pagesë, pa cilësuar nëse është monitoruar të cilët janë shprehur për sasi sipërfaqeje, numër PMB për 1324.53 ha. Në këtë mënyrë ky procesverbal është formal, pasi nuk është as monitorim dhe as verifikim për vetë madhësinë e territorit dhe treguesit për verifikim. Megjithëse për këtë lot janë ofertuar 100 PMB për ha ose 132,424 gjithsej, sipas procesverbalit janë vendosur 134,687 ose 263 copë më shumë, me çmim oferte 262.61 për copë janë mbi 69 mijë lekë. Në procesverbalin e verifikimit të preparatit të përdorur nuk është vendosur sasia e eco-trapeve. Nënshkrimet e përfituesve megjithëse janë të gjitha njëloj, janë nënshkruar duke i vërtetuar dhe nga grupi i monitorim-verifikimit; në lista janë nënshkruar dhe firmosur edhe 14 ha, 12 nga të cilët të QTTB Vlorë dhe 2 Ha të fshatit Aliban; në disa raste nuk është vendosur emri i fermerit por vetëm inicialet e tyre, rasti i Vunoi-t.

Veç kësaj në vitin 2017, Ministria e Bujqësisë në kundërshtim me VKM nr. 137, datë 22.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programimit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2016”, si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Financave nr. 8, datë 31.03.2017, më datë 16.05.2017 ka kërkuar që shuma 202,256,506 lekë e akorduar për mbrojtjen e ullishteve nga dëmtimi i mizës së ullirit të kalojë në aparatit të Ministrisë së Bujqësisë. Kjo pasi vetëm 100 milion lekë do të vihen në dispozicion për mbrojtjen nga miza e ullirit dhe pjesa e tjetër për dëmtuesit e bujqësisë. Kjo shumë i ka kaluar Ministrisë së Bujqësisë më datë 31.07.2017, pra jashtë afateve për të dhënë efektin e duhur në interes të fermerëve dhe zhvillimit rural.

Si konkluzion:

- Mungesë qëndrueshmërie në treguesit e përfitimit të skemës së mbrojtjes ullishteve nga dëmtimi i mizës, pasi në periudhën 2014 - 2016 ka ndryshuar përcaktimin e fermerëve përfitues nga Ministria e Bujqësisë në DB, në përcaktimin e numrit të rrënjëve për ha, ndryshimit të formës dhe afatit të paraqitjes së listave etj., duke sjellë si pasojë çorientimin e përfituesve dhe ulje të efektivitetit të kësaj skeme.

- Sipas të dhënave në vitin 2014 sipërfaqja e trajtuar prej 2109.73 ha është e shtrirë në 5 qarqe me pjesën më të madhe në Berat 38.4 %; në 2015 në 6 qarqe 3081.27 ha me përqendrim në Fier me 42.5 % dhe në vitin 2016 vetëm në 2 qarqe Vlorë dhe Fier një sipërfaqe prej 3687.6 Ha nga 5,352 të përcaktuar nga DB në qarqe. Pra, nëse konsiderohen domosdoshmëri përcaktimet e DB ato në fakt nuk janë zhvilluar sipas kërkesës, duke ulur ndjeshëm efektin e kësaj mase në shkallë vendi si dhe në aplikimin e të gjithë fondit të akorduar.

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit janë shfaqur mangësi në përcaktimin e fondit limit mbi bazën e ofertave të cilët nuk plotësojnë kërkesat përkatëse të një dokumentacioni zyrtar argumentues për këtë qëllim por kanë vendosur kufirin maksimal prej 35,000 lekë të përcaktuar në VKM për këtë skemë.

- Në përcaktimin e fondit limit, komisioni nuk ka marrë në konsideratë numrin e rrënjëve për ha, i cili është përcaktues në vendosjen e pesticidit që lufton mizën e ullirit. Kjo pasi sipas metodikës së sjellë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, për çdo dy rrënjë ullinj përdoret një pako pesticid (ECO TRAP-kurth), për një efekt sa më të mirë dhe me ndikime sa më të vogla në mjedis.

- Sipas dokumentacionit të sjellë nga DB konstatohet se nënshkrimet e fermerëve pothuajse janë të njëjta, d.m.th fiktive; hartat kadastrale nuk provojnë se janë blloqe mbi 50 ha; nuk ka datën e fillimit dhe të përfundimit të trajtimit për secilin bllok; Lezha nuk ka paraqitur harta kadastrale por harta administrative. Në kështu dhe Vlorë. Pra dokumentacioni i sjellë nga DB nuk është në përputhje me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

udhëzimin përkatës duke ulur ndjeshëm efektivitetin e kësaj mase për efekt të përcaktimit të fondit limit dhe monitorimit të kryerjes së këtij shërbimi.

- Efektiviteti i luftimit të mizës së ullirit varet në mënyrë të konsiderueshme nga monitorimi i dëmtuesit si dhe vlerësimi i dendësisë së tij, i cili fillon në fund të muajit qershor, në fakt listat e DB janë dorëzuar që në mesin e muajit maj, pra para se të kryhet ky monitorim.

- KVO e ka shpallur fituesin, pa marrë shpjegime lidhur me vendosjen e eco-trapeve numrit mesatar të rrënjëve të ullirit sipas loteve jo mbi bazën e faktit, por mbi bazën e ofertës. Kështu, në vitin 2014, në DB Vlorë, në fakt janë mesatarisht 150 rrënjë për ha, tenderi është shpallur fitues duke vendosur 240 rrënjë për ha, pra 90 rrënjë më shumë ose 37 %; për Fierin janë në fakt 153 rrënjë mesatarisht për ha dhe në tender janë marrë për 240 rrënjë për ha, ose 36 %; për Tiranën nga 191 rrënjë për ha në fakt, janë kontraktuar 240 ose 21 % më shumë, ndërsa në Fier nuk janë përcaktuar numër rrënjësh për sipërfaqe; Oferta fituese ka të kontraktuar me furnizuesin 250,000 "kurthe" dhe në kontratën me AZHBR për 253,296 copë, pra për 3,296 copë më shumë ose 800,928 lekë të përfituara, por të pajustificuara (3,296 x 243 lekë/copë) me kontratën e furnizimit;

Grupi i auditimit të KLSH i gjeti të bazuara një pjesë të konsiderueshme të observacioneve të AZHBR të datës 29.12.2017, lidhur me këtë çështje, të cilat gjejnë pasqyrim dhe saktësim në trajtimin e mësipërm.

Megjithëse në kontratën e furnizimit të datës 20.05.2014 çmimin e një eco-trapi e ka të përcaktuar jo më shumë se 200 lekë për cop, bashkimi i operatorëve është shpallur fitues me çmimin e ofertuar 218 lekë për copë, sipas metodikes dhe etiketës së ofertuesit të shpallur fitues, eco-trap siguron një efekt më të mirë kur vendoset në fazën e forcimit të bërthamës së ullirit (mesi i Qershorit, ditët e para të Korrikut) në një kohë që tenderi është zhvilluar më datë 23.07.2014 dhe kontrata është nënshkruar më datë 12 gusht 2014, duke ulur ndjeshëm efektivitetin e përdorimit të tij; sipas TV "Ora news" në tetorin e vitit 2014 në zonën e Lushnjës ka qenë problem miza e ullirit, megjithëse ka qenë përfshirë në trajtim për luftimin e mizës së ullirit, gjë që tregon për efektivitet të ulët të këtij investimi.

- Në fazën e monitorimit janë shfaqur mangësi në lidhje me sjelljen e listave të nënshkruara para përfundimit të kryerjes së shërbimit; janë përfshirë në Vlorë 12 ha të QTTB Vlorë, e cila nuk ka dhe nuk duhet të ketë prodhim ullinj, si dhe 1 ha fshati Aliban pa adresë fare, pra 13 nga 85.47 ha ose 15.2 % e fondit për këtë sipërfaqe është fiktiv; për sipërfaqen tjetër prej 410.916 ha; në Berat, sipas dokumentacionit në dosje listat nuk janë nënshkruar nga zyra e kadastrës dhe ato vendore, nënshkrimet pothuajse janë të njëjlojta dhe janë të nënshkruara 119 raste të pronës shtet, e cila përbën 9.4 % të sipërfaqes gjithsej të trajtuar për Beratit prej 810.9241 ha nuk janë shënuar fare emrat e përfituesve, por inicialet e emrit dhe mbiemri, firmat janë të njëjta, nuk ka datë se kur është nënshkruar; si dhe numri kadastral/emërtimi i parcelës janë pa kuptim, pasi Vlora nuk ka dorëzuar së bashku me listën hartë kadastrale; verifikimi nga përfaqësuesit e AZHBR është kryer për një ditë, datë 03.09.2014, të cilët janë shprehur për numrin e rrënjëve dhe numrin e eco-trapeve, sipërfaqen, duke verifikuar brenda ditës veprimtarinë disa ditore dhe të një grupi punonjësish, gjë që është e pamundur; Fituesi i lotit të Beratit ka kontraktuar blerjen e 80 mijë eco-trape dhe i kontraktuar dhe paguar për 81,873 copë; fotot janë të copëzuara që i përkasin vetëm një blloku dhe jo të gjitha blloqeve.

- Në vitin 2017, Ministria e Bujqësisë në kundërshtim me VKM nr. 137, datë 22.02.2017 "Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programimit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2016", si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Financave nr. 8, datë 31.03.2017, më datë 16.05.2017 ka kërkuar që shuma 202,256,506 lekë e akorduar për mbrojtjen e ullishteve nga dëmtimi i mizës së ullirit të kalojë në aparatën e Ministrisë së Bujqësisë. Kjo pasi vetëm 100 milion lekë do të vihen në dispozicion për mbrojtjen nga miza e ullirit dhe pjesa e tjetër për dëmtuesit e bujqësisë, duke i kaluar Ministrisë së Bujqësisë më datë 31.07.2017, pra jashtë afateve për të dhënë efektin e duhur në interes të fermerëve dhe zhvillimit rural.

Për sa më sipër rekomandojmë:

1. AZHBR të studiojë dhe të analizojë me hollësi aplikimin dhe rezultatet e kësaj skeme, të evidentojë mangësitë dhe dobësitë e saj, duke parë mundësinë e kalimit në subvencionimin e eco-trapeve



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

drejtpërdrejtë të fermerëve aplikues, mbi bazën e numrit të rrënjëve dhe faturës së rregullt tatimore për blerjen e tyre. Kjo gjë bëhet më e domosdoshme në kushtet e shkrirjes së DB në qarqe dhe rrethe.


Brenda tremujorit të parë 2018

3.3.3 A është përdorur me ekonomicitet mbështetja financiare e investimeve në bujqësi?

Sipas përcaktimeve në VKM në skemat investuese janë përfshirë këto kategori: investimet 50-60 % të vlerës; fondet për subvencion të normës së interesit, investimet për serat me ngrohje qendrore, si dhe nga fondet kundërpartit. Në auditim nuk janë përfshirë në analizë investimet për serat me ngrohje qendrore, por tre kategoritë e tjera. Shqyrtimi dhe analiza e tyre në mënyrë të detajuar dhe të veçantë të këtyre tre kategorive të skemave kombëtare është bërë për faktin se në vlerë ato kanë përqindjen më të lartë, shërbejnë më shumë në perspektivë zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural, si dhe i japin mundësi grupit të auditimit të vërejë në terren ecurinë e tyre gjatë dhe pas investimit, për pasojë dhe vlerësimin e veprimtarisë së AZHBR në qendër jo vetëm në procedurat administrative, por edhe ato verifikuese, kontrolluese dhe monitoruese.

Duke filluar nga viti 2014, ka filluar mbështetja e projekteve të investimeve, niveli i të cilit ka qenë deri në 50% - 60% të vlerës së projektit të paraqitur në aplikim në drejtime të ndryshme. Kështu në vitin 2014, me investime është mbështetur me ngritje ambientesh për grumbullim dhe ruajtje të prodhimit, linja për standardizim dhe/ose përpunim prodhimi, mekanikë bujqësore etj, jo më shumë se 15 milion lekë për një subjekt. Në vitin 2015 është drejtuar në mbështetjen e investimeve deri në masën 60% të vlerës për traktorë dhe/ose agregate të tjera, linja për standardizimin, mbështetje për energjinë e rinovueshme; etj. Në vitin 2016 dhe 2017 është vendosur për vlerën maksimale 20 milion lekë dhe në drejtim të ngritjes dhe/ose rikonstruksionit të ambienteve për grumbullim, përpunimin dhe ruajtje të produkteve bujqësore etj., të ambienteve për mbarështim të kafshëve etj., linja dhe/ose makineri dhe pajisje për standardizimin, makineri dhe pajisje për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës etj. *Nisur nga fakti i ndryshimeve të mëdha brenda një periudhe 5 vjeçare të nivelit të financimit, vlerës dhe aq më tepër të drejtimit të investimit, tregon se nuk ka një strategji me objektiva të qarta dhe të matshme për të orientuar zhvillimin e bujqësisë në përputhje me strategjinë ndërsektoriale 2014-2020.*

Grafiku nr. 8 Ecuria e projekteve të investimeve 50-60 % në periudhën 2014-2016




Burimi: Të dhëna të AZHBR, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Grupi i auditimit të KLSH analizozi realizimin e fondeve të programuara për investime në periudhën 2014-2016, nga ku konstatohet se *ato zënë mesatarisht gjysmën e fondit vjetor për skemat kombëtare, gjë që tregon se AZHBR dubet të ketë një vëmendje të veçantë në drejtim të menaxhimit të kësaj skeme, për më tepër që nga ana proceduriale varet tërësisht prej specialistëve të zyrës qendrore të saj.*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

Grafiku nr.9 Numri përfituesve dhe vlera e përfitimit të investimeve 50 - 60%, 2014-2016



Burimi: Të dhëna të AZHBR, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Ndërsa numri i përfituesve në periudhën 2014-2016 është midis 40-48 subjektsh pra në përqindje të papërfillshme, vlera e investimit gjithsej të akorduar është rritur nga 542,429,585 lekë në 778.618.395 ose 43 %. Duhet theksuar se gjithsej për 4 vite, investimet 50-60% zënë vendin e parë me 39 % të fondeve buxhetore gjithsej. Investimet më të mëdha në vlerë janë përfituar nga qarku Fier dhe në vijim nga Tirana dhe Durrësi. *Renditje e zonës së Tiranës dhe Durrësit me vlerën e investimit më të lartë në periudhën 2014-2016 tregon se më shumë ka përfituar zhvillimi i biznesit në tërësi, se sa ai i lidhur me rajonet bujqësore të zhvilluara, ndërkohë që ka qarqe si ai Dibrës që nuk ka fare apo Kukësi vetëm një përfitues në vitin 2015.*

Duhet theksuar se përfitimi i investimeve sipas subjektit, llojit territorit, shumës etj., nuk shoqërohet me pasqyrimin e kësaj liste pranë AZHBR ose drejtorive dhe zyrave të bujqësisë në rrethe, ose paraqitja në website-n zyrtar të këtyre institucioneve, përfshirë dhe Ministrinë e Bujqësisë.

Vlera mesatare më e lartë e një projekti është në vitin 2015 në shumën 18,146,985 lekë. Duke i kategorizuar investimet në tre drejtime: ngritje/rikonstruksion ambientesh për grumbullim dhe ruajtje të prodhimit; blerje linja prodhimi dhe blerje traktori dhe makineri e pajisje bujqësore, në përgjithësi midis 67-80 % janë projekte të financuara në fushën e ndërtimit dhe diferenca linja prodhimi dhe agregate bujqësore. *Kjo tregon se ose kriteret e vendosura nuk kanë siguruar mbështetje prioritare intensifikimit të bujqësisë ose veprimtaria informuese e AZHBR ka qenë kuptuar e diferencuar. Veç këtyre paraqitja e projekteve të fryra dhe në pjesën më të madhe me zëra shpenzimesh të fshehta, të pamundura për tu verifikuar nga ana e specialistëve të AZHBR, si dhe mungesa e inxhinierëve të fushës, e bën joshëse këtë formë mbështetjeje me investime, por që deformon arritjen e objektivave të zhvillimit bujqësor dhe rural.*

Në secilin vit janë përcaktuar kriteret e përfitimit, kriteret konkurruese, si dhe procedura që do të ndiqet e cila përfshin: aplikimin dhe kërkesën për financim. Duke analizuar 133 përfituesit gjithsej në periudhën 2014-2016, konstatohet se në 13 raste ose 10% e tyre janë të njëjtët subjekte që kanë përfituar nga dy raste në dy vite edhe të njëpasnjëshme, kryesisht në Lezhë dhe Korçë. Kjo për shkak edhe të mungesës së kufizimeve në kriteret që të mos lejojë aplikimin për një periudhë të caktuar 5-7 vjeçare, për të siguruar jo vetëm një shpërndarje më të gjerë, por në të njëjtën kohë për të zbutur riskun e dështimit të investimeve, mjaft i pranishëm në fushën e bujqësisë. *Për më tepër që një pjesë e konsiderueshme e tyre janë përfitues dhe në skemat e tjera të ashtuquajtura "të vogla", si dhe janë kreditorë në banka të ndryshme, duke shkaktuar për pasojë mungesën e masivizimit të përfitimeve si dhe rritjen e riskut të dështimit.* Në këtë mënyrë, kriteret e vendosura për financimin e investimeve, për të shmangur kriteret e "forta" që të mos përfundojnë si kredi të zakonshme, kanë rënë në kurthin e skemave të "lira", me mundësi abuzimi dhe pamundësi kthimi të vlerës së investimit.

Nga dy auditime të Sektorit të Auditit të Brendshëm dhe nga shqyrtimi i dosjeve të përfituesve ka rezultuar se ka mangësi në dokumentacionin përkatës në lidhje me lejet, plan-bizneset etj.

Nga ana e inspektorëve rajonal të AZHBR nuk njihet vendndodhja dhe ecuria e investimeve në territorin përkatës duke ulur ndjeshëm monitorimin e zhvillimit të projekteve të tilla në dobi të zhvillimit bujqësor dhe rural.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

II. Gjatë periudhës së auditimit, AZHBR-së i janë vënë në dispozicion për t'i administruar edhe fondet kundërparti, të mbledhura prej saj të dhëna nga Qeveria Japoneze dhe këto fonde janë përdorur nga AZHBR-ja në formën e kreditimit pa interes me maturim 7-vjeçar, me qëllim nxitjen dhe rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, si dhe përpunimin e tyre. Vlera e fondit, drejtimit dhe masa e financimit përcaktohen me VKM, ndërsa procedura, kriteret e përgjithshme të përfitimit të kredisë dhe mënyra e administrimit të fondit, përcaktohen me Udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe atij të Financave.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se në periudhën 2013-2017, ka pasur aplikime dhe përfitime për këto fonde në 3 vjet, të cilat përfaqësojnë 3.5 % të fondit gjithsej, buxhetor dhe atij kundërparti.

Pasqyra nr. 13 Të dhëna mbi përdorimin e fondit kundërparti sipas qarqeve 2013 - 2015

Nr.	Qarku	2013		2014		2015		2014 - 2015		Gjithsej	
		Nr	Vlera lekë	Nr	Vlera lekë	Nr	Vlera lekë	Nr	Vlera lekë	Nr	Vlera lekë
1	Elbasan					1	21.327.646	1	21.327.646	1	21.327.646
2	Fier	3	29.332.500							3	29.332.500
3	Gjirokastrë	1	3.500.000	2	44.549.050			2	44.549.050	3	48.049.050
4	Korçë	1	15.000.000							1	15.000.000
5	Lezhë	1	12.000.000			1	22.941.761	1	22.941.761	2	34.941.761
6	Tiranë	1	15.000.000			1	13.050.918	1	13.050.918	2	28.050.918
7	Vlorë	1	6.000.000							1	6.000.000
	Gjithsej	8	80.832.500	2	44.549.050	3	57.320.325	5	101.869.375	13	182,701,875
	Ne dispozicion		173.095.454						130.517.500		303,612,954
	% përdorimit		46,7						78,1		60,2

Burimi: Të dhëna të AZHBR, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme, konstatohet se, AZHBR ka arritur të vërë në përdorim të zhvillimit të bujqësisë vetëm 60.2% të fondit gjithsej të vënë në dispozicion, ose nuk janë përdorur për investime 120,911,079 lekë, në një kohë që burimet dhe rrugët e financimit të zhvillimit rural konsiderohen të pamjaftueshme. Kjo tregon se AZHBR nuk ka arritur të informojë dhe të shpërndajë njohuritë e duhura dhe të mjaftueshme tek fermerët, personat fizik dhe juridikë që të aplikojnë në përfitim e kësaj kredie pa interes. Në vitin 2013, nuk është akorduar fermerëve as gjysma e shumës së akorduar (46.7 %) për shkak se aplikimet kanë qenë të pakta në numër, me mangësi për t'u kualifikuar, dhe më kryesorja, janë konsideruar monopol i zyrave në qendër, duke mos ju kërkuar punonjësve rajonal promovimin e kësaj mundësie në zhvillimin bujqësor dhe rajonal. Për shkak se në vitin 2014, është arritur që të bëhet e mundur përfitimi i kredisë për 1/3 e vlerës së vënë në dispozicion, me VKM ka kaluar në vitin 2015.

Bazuar në shpërndarjen gjeografike konstatohet se kanë përfituar 7 nga 12 qarqet, si dhe numrin (3) dhe vlerën më të madhe prej 26% të fondit është dhënë në qarqet e Gjirokastrës, Fier, Lezhë etj., gjë që nuk përputhet me zhvillimin bujqësor dhe rural në të gjithë vendin dhe me nivelin e zhvillimit brenda tij.

Me VKM nr. 239, datë 27.03.2013 është akorduar shuma prej 173,095,454 lekë me përdorim brenda vitit 2013 në 7 drejtime kryesore si: blerje dhe instalim të dhomave frigoriferike; ndërtimin apo modernizimin e komplekseve blegtorale dhe instalimin e impianteve të tyre ndihmëse; blerjen e traktorëve e të mekanikës bujqësore etj. Për secilin prej këtyre drejtimeve, përcaktohet masa e financimit në masën 50%, 60% dhe 80% si dhe kufiri maksimal i vlerës prej 8, 15, 30 dhe 35 milion lekë. Me qëllim përdorimit e shumës së vënë në dispozicion VKM i ka dhënë mundësi AZHBR që të fillojë disa herë në vit procedurën e pranimit dhe vlerësimit të aplikimeve, deri në përdorimin e plotë të fondeve të mbledhura.



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

Suksesi i subjekteve të cilët kërkojnë dhe arrijnë të përfitojnë kredi pa interes, por në të njëjtën kohë dhe evitimi i problematikave në vijim për kthimin e kredisë për AZHBR, varet në mënyrë të konsiderueshme nga veprimtaria e saj në shqyrtimin e aplikimeve për zbatimin e kriterëve të përcaktuara në kuadrin rregullator përkatës dhe vendim-marrjen përkatëse.

Grupi i auditimit të KLSH analizoi dosjet e fituesve lidhur me administrimin e këtij fondi nga AZHBR. Dhënia e kredive pa interes kryhet nga një komision vlerësimi dhe miratimi prej 6 anëtarë me përfaqësues nga Ministria e Financave (1), Ministria e Bujqësisë (2) dhe (3) nga AZHBR, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e saj. Komisioni mbledhet sa here të jetë e nevojshme për vlerësimin e shpalljen e fituesve, si dhe për të shqyrtuar huatë që janë pjesërisht ose plotësisht të padisbursuara. Sipas protokollit të mbledhjeve, konstatohet se Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim asnjëherë huatë e padisbursuara pjesërisht ose plotësisht.

Megjithëse, AZHBR-ja mund të fillojë disa here në vit procedurën e pranimit dhe vlerësimin të aplikimeve, deri në përdorimin e plotë të fondeve të mbledhura⁶¹, Udhëzimi i përbashkët nr. 5, datë 02.05.2013 e kufizon aplikimin brenda datës 31.05.2013, duke kufizuar numrin e aplikimeve, për më tepër në kushtet e një informacioni të mangët në kohë, vëllim dhe cilësi.

Që të shërbejë komisioni, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AZHBR ngrihet sekretariati i cili brenda 5 ditëve nga mbarimi i afatit të aplikimit ja përcjell dosjet dhe dokumentacionin e depozituar nga aplikuesit Komisionit të Vlerësimit dhe të Miratimit. Procesi i vlerësimit përfundon 15 ditë pas dorëzimit të dosjeve të plota dhe pas këtij procesi i përcillet AZHBR lista e fituesve. Ankesat paraqiten brenda 10 ditëve, të cilat i dërgohen Ministrisë të Bujqësisë dhe vendos për pranimin ose refuzimin e ankimimit.

Sipas procesverbalit të datës 10.06.2013, komisionit i janë dorëzuar 29 aplikime, të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e formularit përkatës të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5 datë 02.05.2013, për shkak se nuk cilësohet nëse aplikantët plotësojnë ose jo kushtet për përfitim. Më datë 05.07.2013, pra jashtë afatit prej 15 ditë që nevojiten për vlerësim, është hartuar procesverbali i shqyrtimit të aplikimeve nga ku janë kualifikuar 9 subjekte dhe persona fizikë, dhe janë skualifikuar 20 të tjerë për mungesë dokumentacioni, pra 69 % e dosjeve janë të paplota. Nga aplikantët e kualifikuar vetëm 5 prej tyre janë vlerësuar me pikë, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit. Nga auditimi i dosjeve të përfituesve konstatohen mangësi të shumta, marrja në konsideratë e të cilave nga komisioni i vlerësimit do të bënte skualifikimin e tyre.

- ✓ Kështu në rastin e subjektit "Amaltea", kanë ndryshuar kriteret e vlerësimit nga sipërfaqe tokë are në tokë truall për të rritur vlerën hipotekore, e cila edhe në këto kushte nuk plotëson kërkesat prej 150% të vlerës së kredisë së përfituar; ndërtimi është mbi tokë arë dhe jo në tokë të ndryshuar destinacioni për ndërtime, gjë që do paraqesë pamundësi të marrjes së lejes së shfrytëzimit për ndërtimin e stallës; në plan-biznes nuk plotëson kriteret e numrit të krerëve të lopëve pasi ka 33, kur ferma duhet të ketë 50 krerë etj.
- ✓ Personi fizik "Erjon Aliaj" për blerje dhe instalim dhome frigoriferike është kualifikuar jashtë zonave prioritare të përcaktuara në VKM nr. 239; mungon vërtetimi i pagesës së taksës së tokës; prona e hipotekuar nuk është e siguruar etj.
- ✓ Personi juridik "Maçi 03" është kualifikuar për ndërtim stallë viçash për majmëri, kur zonë prioritare është për stallë lopësh, si dhe mungon dokumentacioni i numrit të krerëve; hipoteka në dokumente nuk mbulon 150 % të kredisë së vendosur për t'ju dhënë etj.
- ✓ Subjekti "Skandërbeg", nuk ka dokument në lidhje me numrin e krerëve të lopëve gjendje, po ashtu edhe përfituesi "Vëllezërit Smaka" etj.

Duhet të theksojmë se dosjet dhe procedurat përkatëse të vitit 2013 kanë qenë objekt auditimi dhe më parë nga ana e KLSH.

Sipas të dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se në vitin 2013 janë akorduar kredi pa interes për 8 persona fizik dhe juridik, nga 9 të kualifikuar, pasi njëri prej tyre është tërhequr.

⁶¹ VKM nr. 239, datë 27.03.2013 "Për miratimin e mënyrës së re të përdorimit të fondeve kundërpartit, të mbledhura nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Kontratat e kredi-dhënies janë lidhur në fund-Korrikun dhe fillim-Gushtin 2013 për kredi pa interes në 4 drejtime: për ndërtimin apo modernizimin e komplekseve blegtorale për prodhimin e qumështit e të mishit, si dhe instalimin e impianteve të tyre ndihmëse në 4 raste me 59 % të fondit; blerje makineri bujqësore në 2 raste me 11% të fondit dhe për përpunim vaji dhe dhoma frigoriferike nga 15%. *Duhet theksuar se kredia e fundit e akorduar në Lushnjë nuk përfshihet në zonat prioritare të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët, duke vepruar në kundërshtim me kuadrin rregullator përkatës.*

VKM nr. 374 datë 11.6.2014, për kredi pa interes janë akorduar 130,517,500 lekë për të menaxhuar AZHBR brenda vitit 2014. Këshilli i Ministrave duke parë që nuk është përdorur fondi në dispozicion, me Vendimin nr. 954, datë 29.12.2014 e ka shtyrë afatin për aplikime deri në mars 2015. Fondet kundërparti për këtë vit është vendosur të përdoren për: ndërtim/rikonstruksion të stallave, pularive apo modernizim të komplekseve blegtorale dhe instalim të impianteve të tyre ndihmëse; si dhe për ndërtim/rikonstruksion (përfshirë edhe serra), blerje dhe instalim të linjave për ruajtje, përpunim dhe ambalazhim të produkteve bujqësore, blegtorale. *Nga sa më sipër vërehet se dalja e VKM është bërë me mjaft vonesë në krahasim me fillimin e vitit, si dhe është kufizuar në dy fusha të investimit duke barazuar kufirin e financimit të investimit në 25 milion lekë për dy fushat, dhe duke vendosur 70% dhe 80% masën e financimit. Ndryshimet e përvitshme të kufirit të sipërm të financimit dhe të masës së financimit për të njëjtën fushë investimi, si dhe dalja me vonesë e VKM përkatëse, përpos të tjerave, ulin ndjeshëm aftësinë thithëse dhe efektivitetin e këtyre fondeve.*

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, në vitin 2014 ka pasur 4 thirrje për aplikim. Sipas listës së aplikimeve të datës 01.08.2014, kanë dorëzuar dokumentacion 10 subjekte dhe persona fizik, 8 nga të cilët kanë pasur mangësi në dokumentacion ose 80 % e tyre. Sipas procesverbalit të komisionit të po kësaj date, i është lënë detyrë sekretariatit të dërgoj njoftimin për dokumente shtesë për 10 subjektet e vlerësuara brenda një periudhe 5 ditore. *Sekretariati nuk e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 10, datë 25.06.2014, pasi: Aplikimet për financim duhej të ishin mbyllur brenda 15 ditëshit të parë të muajit korrik 2014, dhe sekretariati duhej t’ia përcillte komisionit brenda 5 ditëve (pika 4.2 e Udhëzimit) dhe në fakt ja ka paraqitur 10 ditë me vonesë; si dhe nuk ka përgatitur formularin nr. 4 për aplikantët me mungesa në dokumentacion.*

Komisioni i Vlerësimit dhe Miratimit (KVM) ka keqinterpretuar dhe zbatuar pikën 4.3 të Udhëzimit lidhur me kërkesën e informacionit dhe dokumenteve shtesë për qëllime vlerësimi, pasi aplikuesit nuk kanë plotësuar dokumentacionin ligjor kriter kualifikimi (pika 5 e udhëzimit), për të kaluar më pas në nivel shqyrtimi dhe vlerësimi nga komisioni, por siç cilësohet në udhëzim behet me qëllim rikonfirmimin e dokumentacionit ekzistues.

Në mbledhjen tjetër të KVM të datës 11.08.2014 për thirrjen e parë, i janë përgjigjur thirrjes për dokumente shtesë vetëm 3 subjekte, duke miratuar fitues 2 prej tyre: personin fizik Klejdi Zika dhe “GPMB 1” Shpk fitues me kusht regjistrimin në ZRPP të kontratës së qirasë, pa përcaktuar numrin e pikëve.

Nga auditimi i dosjes së përfituesit Klejdi Zika, konstatohet se:

- * Përfituesi është vëllai i aplikueses për linjë përpunim vere Ina Imeri, e cila është skualifikuar për mosplotësim dokumentacioni;
- * Përfituesi ka aplikuar më parë tek skema mbështetje 50 % dhe kalon tek kredi pa interes; është i biri i pronarit të subjektit juridik “Derveni” dhe sipas dokumenteve aplikon për rikonstruksion stalle blegtorale në fshatin Kashisht të Memaliajt. Sipas deklaratës noteriale të një pjesëtari të familjes, vërtetohet se ai është dakord për ndërtimin e në stalle në një sipërfaqe kullosore në bashkëpronësi;
- * Vërtetim për aplikim leje ndërtimi i datës 27.05.2014 i kryetarit të komunës së fshatit Memaliaj nuk përshkruan asgjë mbi lejen, vetëm duke cilësuar “Z. Klejdi Zika plotëson të gjitha kriteret ligjore për të aplikuar për për tu pajisur me leje ndërtimi për objektin e kërkuar si VKM e cilësuar më lart”;
- * Në biznes-planin e paraqitur nuk ka historik; nuk ka përshkrim të produktit, konsumatorët, konkurrentët, çmime e tregut, synimet e biznesit të vendosura dhe të krahasuara me shifra; nuk ka biznes në 3 vitet e fundit; investimi i ri ka vetëm përshkrim të përgjithshme, pa vendosur asnjë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

- shifër; nuk ka kontrata ekzistues dhe as nuk parashikon konkretisht se me kë do të lidhi kontratë; nuk ka asnjë përshkrim për listën e makinerive dhe pajisjeve dhe specifikimet teknike;
- ✘ Vlerën e stallës në ofertë e ka 30,547,795 lekë dhe kërkon 80 % të vlerës, kur VKM përcakton 70 %;
 - ✘ Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve është vendosur tabela nr. 1, viti normal para investimit me fitim neto 5,1489,599 lekë, kur nuk pasqyron të ketë fare akoma këtë lloj biznesi para investimit; nuk përcakton fare numrin e krerëve, por rrit artificialisht prodhimin dhe ul shpenzimet për vitin e parë pas investimit;
 - ✘ Raporti i vlerësimit është kërkuar nga Reshat Zika dhe jo nga Klejdi Zika;
 - ✘ Leja e ndërtimit, jepet për rikonstruksion i stallave në fshatin Bylysh në parcelën ku poseduesit deklarojnë para noterit se është sipërfaqe kullosore dhe lejojnë ndërtimin e një stalle të re;
 - ✘ Kontrata e huasë datë 04.09.2014, për shumën 21,383,456 lekë, ka dhe kontratën hipotekore të datës 29.08.2014 për dy pasuri, që nuk janë në emër të AZHBR, por të qiramarrësit Klejdi Zika;
 - ✘ Gjatë zbatimit aplikanti nuk disponon foto të punimeve të fshehura, zbankim dheu me vlerë 1,603,000 lekë dhe 808,500 lekë

Sipas thirrjes së dytë të datës 11.08.2014, janë paraqitur 3 aplikime, 2 nga të cilët janë skualifikuar për mungesë dokumentacioni dhe vetëm njëri kualifikohet për t'i lënë afat 5 ditor për plotësim dokumentacioni. Personi fizik në këtë rast nuk ka sjellë dokumentacion shtesë dhe nuk ka përfituar. Në thirrjen e tretë kanë aplikuar 10 subjekte, nga të cilët sipas sekretariatit vetëm 1 nuk plotëson dokumentacionin e kërkuar, për të cilët KVM i ka gjetur që nuk plotësojnë kushtet për një sërë dokumentesh, duke ju lënë një afat 5 ditor për plotësimin e dokumenteve shtesë.

Në thirrjen e 4-të janë 8 aplikues, për të cilët më datë 29.09.2014 komisioni ka vendosur t'ju lërë 5 ditë afat për dokumente shtesë. Sipas procesverbalit të datës 13.10.2014 janë shpallur fitues 4 subjekte: Agroalko Shpk, Roland Llojku, Euroalb Shpk dhe Rexhep Rraja. Nga shqyrtimi i dosjeve të 2 prej fituesve konstatohet se:

1. Përfituesi Rexhep Rraja, Ndërtim dhome frigoriferike në Fushë-Krujë, me aktivitet bar-kafe; ka përfituar dhe nga skema e financimit 50-60 % të investimit; në Plan-biznesi “Ndërtim dhe montim dhomash frigoriferike” i maj 2014, investim në tokën e marrë me qira me afat 9 vjeçar sipërfaqe 4000 m², i mungojnë faqet 4 dhe 5; pasqyrat financiare të shtatorit 2014; Sipërfaqja e truallit të disponueshëm 300 m², nevoja për dhoma frigoriferike 360 m² (30x12); leja e dhënë për Rrahman Rraja; Raporti i kontrollit i datës 03.02.2015 nuk ka situacion, ka diferenca të theksuara në krahasim me blerjet gjatë verifikimit; shuma e autorizuar më datë 11.02.2015 është 80 % e gjithë shumës së blerjeve prej 26,000,004 lekë dhe shuma e paguar 13,050,918 lekë, megjithëse ka diferenca në verifikim.
2. Roland Llojku: rikonstruksion stalle për mbarështim bagëtitsh në Vreshtas, Shushicë Elbasan; dokumenti vetëdeklarimit pa datë, po ashtu pa datë dhe pa firmë të sekretariatit formulari nr. 5 për propozimin e sekretariatit; lista e dokumenteve e pa firmosur nga përfaqësuesi i AZHBR, kërkesa për financim pa firmën e aplikantit dhe as të marrësit në dorëzim; sipas projektit janë 2 objekte; sipas biznes-planit aplikuesi ka mbaruar studimet universitare për juridik dhe i punësuar në familje në biznes ndërtimi, pra nuk ka asnjë lidhje me zhvillimin bujqësor dhe rural, rikonstruksion të objektit të marrë me qira, në fakt janë 2 objekte, nuk ka të dhëna numerike për çmimet, produktet, numrin e krerëve etj, nuk parashikohen kontratat strikte, nuk ka numër krerësh, ka prodhim qumështi të imtash dhe lope në plan-biznes, nuk ka kosto të përmendur; oferta me vlerë 32,314,577 lekë nuk përcaktohet se kujt është; është regjistruar si person fizik me qendër në Tiranë, njësia bashkiake nr. 10 me fushë të veprimtarisë sera, fermë dhe blegtori, pra 1 ditë para kërkesës për kredi; Për leje ndërtimi ka shërbyer një vërtetim i kryetarit të Komunës Shushicë, me paragrafin e fundit: “bazuar në legjislacionin në fuqi, për punime mirëmbajtjeje nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi”, leja e ndërtimit sipas formatit ligjor mban datën 06.11.2014, pra është shpallur fitues në mungesën e lejes së ndërtimit, e cila përcakton se ka 2 kate mbi tokë pra janë financuar stalla për bagëti dykatëshe; oferta në plan-biznes nuk përputhet me



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

zëra me atë të cilën është vepruar në fakt; në kërkesën për pagesë nuk është shënuar shuma e parave të kërkuara; Formulari i verifikimit dhe kontrollit në vend nuk është firmosur nga Inspektori 2 Shkelzen Qylhanxhiu; formulari i kontrollit në vend i datës 16.03.2015 nuk është i firmosur nga inspektori Bianka Kashifi, po ashtu dhe raporti i kontrollit; situacioni nr. 2 nuk përputhet me ofertën e vendosur krahas situacionit dhe faturës së TVSH-së; në dosje mungon situacioni nr. 3 dhe nr. 4 etj.

Nga sa më lart konstatohet se nga ana e AZHBR-së procedura e vlerësimit të dosjes së aplikantëve që janë shpallur fitues është shoqëruar me probleme të shumta, kryesisht në plan-bizneset të cilat mund të ndikojnë ecurinë e kthimit të kredisë në të ardhmen.

Pas akordimit të fondit kundërpartit për kredi pa interes, përcaktuese mbetet faza e monitorimit. Nëse procedura e përzgjedhjes dhe e vlerësimit të plan-biznesit është kryer siç duhet, projekti i investimit garanton shlyerjen e kredisë sipas grafikut përkatës. AZHBR ka kryer një verifikim në terren në Shtator 2014, në zbatim të rekomandimeve të KLSH për përfituesit e kredive pa interes 2012 - 2013, gjë që tregon se ato nuk kanë qenë të përfshira në aktivitetin monitorues prej saj. Sipas këtij verifikimi për 18 projekte investimesh, në 9 prej tyre nuk garantohej kthimi i kredisë ose në 50 % prej tyre. Për më tepër që grupi i verifikimit nuk shprehet me shifra për realizimin e plan-biznesit, por është ndalur thjeshtë dhe vetëm nëse zhvillon aktivitet ose jo, shtoj këtyre që në rastin e mekanikës bujqësore është mjaftuar nëse është në punë ose jo. Grupi i auditimit të KLSH verifikoj në terren një rast (Simon Gjoka) në të cilin mjete mekanik nuk ishte venë në punë fare, për shkak defekti.


Mangësitë gjatë zbatimit të procedurës së dhënies së kredive pa interes, në një masë të konsiderueshme shfaqen në të ardhmen në grafikun e shlyerjes së kredisë. Sipas të dhënave të AZHBR përfituesit e kredive pa interes për vitin 2013, deri në maj 2017 nuk kanë shlyer detyrimet korrente për shumën 25,368,500 lekë ose 80 % të detyrimit, ndërsa përfituesit 2014 – 2015 nuk janë korrekt me këstet e shlyerjes për 11,549,563 lekë ose 60 % të detyrimit të periudhës. Duhet theksuar se nga 5 përfitues në vitin 2014, 3 prej tyre nuk kanë shlyer asnjë këst nga kredia pa interes e marrë prej tyre, ndërsa për vitin 2013, 2 përfitues nuk kanë shlyer asnjë këst dhe 11 të tjerët kanë shlyer shumë pak, duke detyruar AZHBR që të hapë procese gjyqësore për 6 prej tyre. Në mos-shlyerjen e detyrimeve ka ndikuar negativisht dhe lançimet e titullarëve të Ministrisë së Bujqësisë, për iniciativa për amnisti të këtyre detyrimeve, heqjen nga lista e debitorëve për t’ju krijuar mundësi aplikimi dhe përfitimi në të ardhmen⁶². Veç kësaj, këtu ka ndikuar edhe mungesa e monitorimeve nga ana e AZHBR mbi ecurinë e tyre në përputhje me plan-bizneset, duke dhënë shembullin e modelit jo të duhur për zhvillimin e bujqësisë nëpërmjet investimeve. Kështu, rezultatet e kredive pa interes nuk kanë shërbyer për rritjen e kulturës financiare të fermerëve të mbijetesës dhe të atyre që fermën e shohin si një biznes, njëloj me fushat e tjera të ekonomisë.

Sipas një informacioni të Sektorit të Monitorimit të nëntorit 2017, në periudhën korrik 2016-nëntor 2017 janë kryer kontrole për 20 subjekte përfitues në mbështetje të investimeve 50% të vlerës së projektit të vitit 2014. Nga këto kontrole ka rezultuar se në 4 raste ose 20 % të projekteve ka mangësi të ndryshme si mospërputhje të makinerive me kërkesën për autorizimin e pagesës, operacioni nuk funksionon sipas kontratës, subjekti nuk vazhdon aktivitetin sipas objektit të financimit etj., çka do të thotë në fund të fundit se 1/5 e projekteve të financuara nuk kanë ndihmuar në zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural.

Grafiku nr. 10 Financimi gjithsej, detyrimet korrente dhe të pashlyera 2013-2015



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"



Burimi: Të dhëna të AZHBR, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga sa më sipër konstatohet se AZHBR është mjaftuar vetëm me financimin e investimeve dhe nuk ka monitoruar vazhdimësinë e tyre, pasi në periudhën 2013-2017 janë financuar 155 projekte dhe janë kontrolluar (monitoruar) pas përfutimit një pjesë e tyre të vitit 2013 dhe 2014, ose përafërsisht vetëm 30 prej tyre, nga të cilët së paku 20 % kanë shfaqur probleme në vijimësinë e tyre, si dhe 60% e kredisë pa interes nuk kthehet sipas grafikut të shlyerjes.

Si përfundim, rezultatet tregojnë se fondet e investimeve të përfutuara nuk janë shfrytëzuar si duhet në aspektin ekonomik, për të gjeneruar më pas të ardhura të mjaftueshme për të shlyer detyrimin e tyre, duke shfrytëzuar dhe ndarjen e risqeve, për të mbështetur zhvillimin e zinxhirit të vlerës që të mund të zhvillojnë projekte të besueshme për financim.

Mbështetja, përmes subvencionit të normës së interesit është aplikuar në periudhën 2013-2016 në masën 70 % të normës së interesit, për 5 vite radhazi, për kreditë deri në 25,000,000 lekë për vitin 2013 dhe në masën 70% të normës së interesit, për 7 vite radhazi, për kreditë deri në 30,000,000 lekë në periudhën 2014-2016, ndërsa është hequr në vitin 2017, për kreditë e marra për një drejtim investimi të përcaktuar në VKM-të përkatëse.

Pasqyra nr. 14 Të dhëna mbi numrin e përfituesve dhe vlerën e përfutuar për subvencion normë interesi 2013-2016

Viti	Alokuar lekë	Realizuar lekë	Nr. përfitues
2013	58,000,000	42,722,404	57
2014	30,000,000	26,731,241	38
2015	26,000,000	22,149,985	37
2016	4,900,712	10,364,925	19
	118,900,712	101,968,555	151


Burimi: Të dhëna të AZHBR

Përgjithësisht vërehet se aplikuesit për subvencion normë interesi kredie janë ato që kanë aplikuar dhe për financim 50 - 60 % të projektit, gjë që tregon se rreziku i mos-vazhdimit të aktivitetit deri në dështimin e tij është akoma më i madh për shkak të mungesës së likuiditeteve. Aplikimi dhe përfitimi njëkohësisht për financim projekti dhe subvencion normë interesi është e vështirë të evidentohet, për shkak se aplikuesi shfaqet njëherë si subjekt dhe herë tjetër si person fizik. Mungesa e plotë e monitorimit të këtyre projekteve të financuar me kredi bankare dhe të subvencionuar normën e interesit e bën edhe më të dobët efektin e kësaj mase në zhvillimin e bujqësor dhe rural.



KONTROLLI I LARTË I SHËTËTIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

Grafiku nr. 11 Fondet kundërpartit të planifikuara dhe të realizuara 2014-2016



Burimi: Të dhëna të AZHBR, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Si konkluzion:

- Brenda një periudhe 5 vjeçare ka pasur ndryshime të mëdha të nivelit të financimit, vlerës dhe aq më tepër të drejtimeve të investimit, që tregon se nuk ka një strategji me objektiva të qarta dhe të matshme për të orientuar zhvillimin e bujqësisë në përputhje me strategjinë ndërsektoriale 2014-2020.
- Renditje e zonës së Tiranës dhe Durrësit me vlerën e investimit më të lartë në periudhën 2014-2016 tregon se më shumë ka përfituar zhvillimi i biznesit në tërësi, se sa ai i lidhur me rajonet bujqësore të zhvilluara, ndërkohë që ka qarqe si ai Dibrës që nuk ka fare apo Kukësi, të cilat edhe si pasojë e mungesës së aplikimeve, kanë vetëm një përfitues në vitin 2015.
- Vlera mesatare më e lartë e një projekti është në vitin 2015 në shumën 18,146,985 lekë. Duke i kategorizuar investimet në tre drejtime: ngritje/rikonstruksion ambientesh për grumbullim dhe ruajtje të prodhimit; blerje linja prodhimi dhe blerje traktori dhe makineri e pajisje bujqësore, në përgjithësi midis 67-80 % janë projekte të financuara në fushën e ndërtimit dhe diferenca linja prodhimi dhe agregate bujqësore. Kjo tregon se ose kriteret e vendosura nuk kanë siguruar mbështetje prioritare intensifikimit të bujqësisë ose veprimtaria informuese e AZHBR ka qenë kuptuar e diferencuar. Veç këtyre paraqitja e projekteve të fryra dhe në pjesën më të madhe me zëra shpenzimesh të fshehta, të pamundura për tu verifikuar nga ana e specialistëve të AZHBR, si dhe mungesa e inxhinierëve të fushës, e bën joshëse këtë formë mbështetjeje me investime, por që deformon arritjen e objektivave të zhvillimit bujqësor dhe rural.

Për këto rekomandojmë:

1. AZHBR të marrë masat e nevojshme për sigurimin e qëndrueshmërisë së kësaj skeme, si dhe të sigurojë shpërndarje territoriale dhe drejtimit e projektit të investimeve në favor të zhvillimit të bujqësisë dhe atij rural, nëpërmjet propozimit të kriterëve dhe dokumentacionit të duhura për këtë qëllim.

Brenda muajit shkurt 2018

- Përfitimi i investimeve sipas subjektit, llojit territorit, shumës etj., nuk shoqërohet me pasqyrimin e kësaj liste pranë AZHBR ose drejtorive dhe zyrave të bujqësisë në rrethe, ose paraqitja në website-n zyrtar të këtyre institucioneve, përfshirë dhe Ministrinë e Bujqësisë.

Për këtë rekomandojmë:

2. AZHBR të rrisë transparencën e veprimtarisë së saj, duke pasqyruar në website-n zyrtar të dhëna mbi aplikuesit, përfituesit, projektin e investimit, vendndodhjen etj., duke i shërbyer njëkohësisht dhe rritjes së efektivitetit të kësaj mase.

Vazhdimisht

Ky rekomandim është vlerësuar dhe konfirmuar dhe nga observacionet e AZHBR, me nr. 639/3 prot., datë 29.12.2017, dhe janë shprehur se nëpërmjet krijimit të strukturës së re, AZHBR do të pasqyrojë në vazhdimësi në website-n zyrtar të dhëna mbi aplikuesit, përfituesit, etj.

- Duke analizuar 133 përfituesit gjithsej në periudhën 2014-2016, konstatohet se në 13 raste ose 10% e tyre janë të njëjtët subjekte që kanë përfituar nga dy raste në dy vite edhe të njëpasnjëshme, kryesisht në Lezhë dhe Korçë. Kjo për shkak edhe të mungesës së kufizimeve në kriteret që të mos lejojnë aplikimin për një periudhë të caktuar 5-7 vjeçare, për të siguruar jo vetëm një shpërndarje më të gjerë, por në të njëjtën kohë në të zbutur rishikim e dëshmimit të investimeve mbi të arriturit në fushën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

bujqësisë. Për më tepër që një pjesë e konsiderueshme e tyre janë përfitues dhe në skemat e tjera të ashtuquajtura "të vogla", si dhe janë kreditorë në banka të ndryshme, duke shkaktuar për pasojë mungesën e masivizimit të përfitimeve si dhe rritjen e riskut të dështimit.

Për këtë rekomandojmë:

3. AZHBR të analizojë me hollësi përfituesit e investimit të deritanishëm mbi bazë risku, duke ndihmuar me monitorime dhe këshillime më të shpeshta, përfituesit më të rrezikuar, si dhe të shmangë përsëritjen e këtyre rasteve në të ardhmen, duke krijuar mundësinë e shembullit të mirë në investime dhe rritjen e efektivitetit të tyre.

Vazhdimisht

- Nga dy auditime të Sektorit të Auditit të Brendshëm dhe nga shqyrtimi i dosjeve të përfituesve ka rezultuar se ka mangësi në dokumentacionin përkatës në lidhje me lejet, planbizneset etj.

Për këtë rekomandojmë:

4. Sektori i auditit të brendshëm në AZHBR të kryejë auditimin e çdo periudhe aplikimi, pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit dhe shpalljes së përfituesve, duke evidentuar mangësitë dhe përgjegjësitë përkatëse-

Për çdo vit, menjëherë pas shpalljes së përfituesve.

- Nga ana e inspektorëve rajonal të AZHBR nuk njihet vendndodhja dhe ecuria e investimeve në territorin përkatës duke ulur ndjeshëm monitorimin e zhvillimit të projekteve të tilla në dobi të zhvillimit bujqësor dhe rural.

Për këtë rekomandojmë:

5. AZHBR të njohë inspektorët rajonal me të gjitha projektet e financuara të investimeve, duke ju vënë detyrë përgatitjen dhe dorëzimin e një raporti periodik mbi aktivitetin dhe përputhjen e tij me plan-biznesin e paraqitur.

Vazhdimisht

- AZHBR ka arritur të vërë në përdorim të zhvillimit të bujqësisë vetëm 60.2% të fondit gjithsej kundërpartit të vënë në dispozicion, ose nuk janë përdorur për investime 120,911,079 lekë, në një kohë që burimet dhe rrugët e financimit të zhvillimit rural konsiderohen të pamjaftueshme.

- Bazuar në shpërndarjen gjeografike konstatohet se kanë përfituar kredi pa interes 7 nga 12 qarqet, si dhe numrin (3) dhe vlerën më të madhe prej 26% të fondit është dhënë në qarkun e Gjirokastrës, Fier, Lezhë etj., gjë që nuk përputhet me zhvillimin bujqësor dhe rural në të gjithë vendin dhe me nivelin e zhvillimit brenda tij.

Për këtë rekomandojmë:

6. AZHBR të analizojë në mënyrë të hollësishme shkaqet mos thithjes së investimeve si dhe të forcojë kapacitetet e veta veta njerëzore dhe institucionale për të bërë të mundur përdorimin e të gjitha burimeve të mundshme të financimit në dobi të zhvillimit bujqësor dhe rural në të gjithë territorin e vendit.

Brenda tremujorit të parë 2018

- Dokumentacioni dhe procedura e dhënies së kredisë pa interes është shoqëruar me mangësi të shumta të cilat kanë sjellë pasojë në efektivitetin e ulët deri dhe të munguar të kësaj skeme.

Për këtë rekomandojmë:

7. AZHBR të marrë masa që të shmangë të gjitha mangësitë dhe të metat e evidentuara në këtë auditim, duke u shoqëruar me evidentimin e përgjegjësisë, për të siguruar suksesin e projektit të financuar me kredi pa interes dhe rritjen e efektivitetit të masë së investimeve në bujqësi.

Vazhdimisht

- Përfituesit e kredisë pa interes për vitin 2013, deri në maj 2017 nuk kanë shlyer detyrimet korrente për shumën 25,368,500 lekë ose 80 % të detyrimit, ndërsa përfituesit 2014 - 2015 nuk janë korrekt me këstet e shlyerjes për 11,549,563 lekë ose 60 % të detyrimit të periudhës. Duhet theksuar se nga 5 përfitues në vitin 2014, 3 prej tyre nuk kanë shlyer asnjë këst nga kredia pa interes e marrë prej tyre, ndërsa për vitin 2013, 2 përfitues nuk kanë shlyer asnjë këst dhe 11 të tjerët kanë shlyer shumë pak, duke detyruar AZHBR që të hapë procese gjyqësore për 6 prej tyre. Në mos shlyerjen e detyrimeve ka ndikuar negativisht dhe lançimet e titullarëve të Ministrisë së Bujqësisë, për iniciativa për amnisti të këtyre detyrimeve, heqjen nga lista e debitorëve për t'ju krijuar mundësi aplikimi dhe përfitimi në të ardhmen.

Për këtë rekomandojmë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

8. Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR duhet të shprehen dhe të zbatojnë politika të qarta lidhur me zbatimin e detyrimeve në investime, me qëllim që të shmangët deformimi i objektivave për financimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural dhe rritjen e efektivitetit të fondeve buxhetore në këtë drejtim.

Vazhdimisht

- Në periudhën Korrik 2016-Nëntor 2017 janë kryer kontrole për 20 subjekte përfitues në mbështetje të investimeve 50% të vlerës së projektit të vitit 2014. Nga këto kontrole ka rezultuar se në 4 raste ose 20 % të projekteve ka mangësi të ndryshme si mospërputhje të makinerive me kërkesën për autorizimin e pagesës, operacioni nuk funksionon sipas kontratës, subjekti nuk vazhdon aktivitetin sipas objektit të financimit etj., çka do të thotë në fund të fundit se 1/5 e projekteve të financuara nuk kanë ndihmuar në zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural.

Për këtë rekomandojmë:

9. Sektori i monitorimit në AZHBR të hartojë dhe të zbatojë një plan monitorimi periodik, me objektiva të qarta duke u përqendruar në ecurinë e projekteve të investimeve mbi bazën e planbizneseve të paraqitura, si dhe të koordinojë veprimtarinë tij me drejtoritë tjera brenda AZHBR për rregullimin dhe përmirësimin e situatës.

Brenda muajit janar dhe vazhdimisht

Ky rekomandim është vlerësuar dhe konfirmuar dhe nga observacionet e AZHBR, me nr. 639/3 prot., datë 29.12.2017, dhe janë shprehur se do të merren masa për hartimin dhe zbatimin e një plani monitorimi periodik.

3.3.4 Sa i ka shërbyer monitorimi i granteve zhvillimit të bujqësisë?

Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, së pari duhet të kemi njohuri se çfarë nënkuptojmë me këtë funksion shumë të rëndësishëm për nga natyra e tij. Monitorimi është mbikqyrja e aktiviteteve të cilat janë në proces, për të siguruar që ato po operojnë konform procedurave dhe programeve, për të arritur objektivat dhe qëllimet e performancës. Në rastin e AZHBR, me miratimin e Ligjit “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” në vitin 2007⁶³, i cili rregullon programimin e masave të politikave të lidhura me bujqësinë dhe zhvillimin rural, ofron dhe bazën ligjore për institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave bujqësore duke krijuar dhe AZHBR, për zbatimin e skemave të mbështetjes kombëtare, si dhe futjen e parimeve të monitorimit dhe vlerësimit të skemave kombëtare të mbështetjes.⁶⁴ Ligji ofron bazën ligjore për politikat kombëtare të mbështetjes, të cilat nxirren në bazë vjetore në Planin Kombëtar të Veprimit, i cili është pjesë përbërëse e strategjisë ndërsektoriale 2014-2020. Për zbatimin e bazës së ligjore të planit kombëtar kërkohet miratimi i tyre me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave. Në SNZHBR 2014-2020⁶⁵ thuhet se, plani i veprimit përcakton masat për zbatimin e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural në vitin përkatës, kryesisht:

- kushtet, kriteret, dhe procedurat për zbatimin e masave;
 - planin financiar për zbatimin e masave;
 - mekanizmat institucionalë;
 - procedurat për monitorimin dhe vlerësimin e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural;
- dhe se zbatimi i këtij plani është përgjegjësia e AZHBR-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave në MBZHRAU.

Grupi i auditimit për të dhënë informacion të plotë, të saktë, për të arritur në konkluzione të qarta dhe për të dhënë rekomandime konkrete për këtë çështje, bëri kërkesë për dokumentacion sipas një linje hierarkie, për të arritur deri tek vet AZHBR në lidhje me element të monitorimit, sa më poshtë vijon:

◀ Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

◀ Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020.

◀ VKM 2013-2017 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

⁶³ Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

⁶⁴ Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020.

⁶⁵ SNZHBR 2014-2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

◀ Udhëzim 2013-2017 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

◀ VKM nr. 1443, datë 31.10.2008 “Për Krijimin e AZHBR, si Agjencia e Pagesave”, të ndryshuar.

◀ Urdhër i Kryeministrit 2013-2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së agjencisë për zhvillim bujqësor dhe rural”.

◀ Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë nr. 3, datë 30.12.2008 “Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR.

◀ Rregullore e brendshme e funksionimit të AZHBR.

◀ Manualet për implementimin e procedurave 2013-2017.

◀ Aktivitetin monitoriues të AZHBR për 2013-2017.

Gjithashtu në SNZHBR 2014-2020 përcaktohen edhe disa tregues monitorimi që do të përditësohen me informacion nga AZHBR, të cilët konsistojnë në normën e rritjes reale ekonomike të sektorit bujqësor, produktivitetin e punës në këtë sektor dhe të punësuarit në agro-përpunim. Pra nga sa thamë më sipër, arrijmë të kuptojmë se *jo në mënyrë të drejtpërdrejtë por të tërthortë AZHBR, si një nga institucionet kryesore për zbatimin e SBZHBR 2014-2020, duhet që në një lloj mënyrë të monitorojë ecurinë e granteve dhe efektin që kanë ato në zhvillimin bujqësor dhe rural për të përditësuar me informacion treguesit e mësipërm.*

Nga intervista realizuar në datën 14.11.2017, me specialisten e sektorit të raportimit, si një nga strukturat përgjegjëse monitorimin dhe përgatitjen e raporteve me informacion për arritjen e objektivave nga AZHBR dhe raportimin e tyre tek Autoriteti Menaxhues dhe MBZHRAU, rezultoi se *nuk kishin asnjë njohuri për SNZHBR 2014-2020, nuk ishin përditësuar me informacion treguesit e monitorimit të përcaktuar në strategji dhe për më tepër nuk ju ishte vënë ende në dispozicion kjo strategji, megjithëse kanë kaluar 3 vjet nga miratimi i saj, që tregon një mungesë përgjegjshmërie dhe bashkëpunimi nga ana e institucioneve (MBZHRAU dhe AZHBR).*

Në VKM 2013-2017 për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi për bujqësinë dhe zhvillimin rural rezultoi se *nuk përmendet asnjëherë funksioni i monitorimit të skemave kombëtare.* Për periudhën 2013-2017 nëpërmjet udhëzimeve për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, rezulton se *nuk përcaktohet monitorimi i skemave kombëtare të vogla, por theksohet, se Sektori i Auditit të Brendshëm AZHBR është përgjegjës për auditimin dhe likuidimin financiar të përfituesve të skemave.* Nga sa më sipër rezulton se: *Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, sektori i auditit të brendshëm ka kryer vetëm dy auditime financiare për skemat kombëtare të vogla për vitet 2014 dhe 2015, dhe jo për vitet 2013 dhe 2016. Ky sektor për 2013-2016 ka audituar 283 dosje të përfituesve nga skemat kombëtare të vogla nga 10518 në total, pra rreth 3%, si dhe gjetjet dhe rekomandimet kryesore konsistojnë në mangësitë e dosjeve të përfituesve në dokumentacion, kryesisht të vërtetimi të sigurimeve shoqërore, kartës së identitetit.*

Gjithashtu bazuar tek këto udhëzime, në kriteret e aplikimit për investimet 50% dhe rimbursimin e normës së interesit për kredit e marra nga fermerët, kërkohej biznes-plan me afate 3-7 vjet, çka të lë të nënkuptosh se fermeri i cili përfiton fondet, minimalisht do të duhej të monitorohej herë pas here për të parë ecurinë e tij në përputhje me planin e biznesit, ku më e rëndësishme ishte nëse fermeri e kishte tjetërsuar aktivitetin e tij, ecuria e aktivitetit nga çfarë kishte planifikuar në biznes-plan, etj. Nga sa më sipër rezultoi se *në udhëzimet 2013-2017 përdorej termi verifikim për skemat kombëtare të vogla pra e thënë ndryshe inspektim i faktit me planin dhe jo monitorim, por megjithëse nuk përcaktohej monitorimi i tyre, nuk përcaktohej as se sa herë duhet të verifikohet fermeri i cili ka përfituar fondet, që do të thotë, se ka krijuar subjektivizëm dhe liri-veprimi për AZHBR në ushtrimin e këtij funksioni.*

Për të krijuar një tablo më të qartë për këtë periudhë, grupi i auditimit analizoi dhe VKM për krijimin e AZHBR⁶⁶, urdhrat e Kryeministrit për strukturën e agjencisë⁶⁷, rregulloren e brendshme⁶⁸,



KONTROLLI I LARTË I SHITIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Udhëzimin e Ministrit për procedurat e funksionimit të institucionit, manualet e implementimit të procedurave, aktivitetin e AZHBR në lidhje me monitorimin për 2013-2014-2015, pra e thënë ndryshe mjedisin jashtë dhe brenda kontrollit menaxherial. Ajo që rezultoi ishte se: referuar VKM-së së krijimit, Urdhrit e Kryeministrit për vitet 2013-2014, Udhëzimit të Ministrit të MBZHRAU, nuk ka patur një sektor për monitorimin e granteve në fushën e bujqësisë dhe AZHBR kryente thjesht inspektimin dhe jo monitorimin e skemave kombëtare.

Referuar Shkresës zyrtare drejtuar grupit të auditimit me protokoll nr. 727, datë 14.11.2017, nga Përgjegjësi i sektorit të monitorimit, rezultoi se AZHBR për vitet 2013-2014-2015 nuk ka patur sektor monitorimi, dhe nuk është kryer monitorimi i skemave kombëtare. Gjithashtu megjithëse ky sektor sipas Urdhrit të Kryeministrit u krijua në Dhjetor të vitit 2015, ka nisur nga puna e tij në datën 07.11.2016, pra rreth 10 muaj me vonesë, për shkak të mos plotësimit në kohë të strukturës me staf, mungesës së manualeve të punës, pra ky sektor ka vetëm një vit që ushtron detyrat e tij. Aktualisht ky sektor ka 5 specialist për monitorim.⁶⁹

Pasqyra Nr. 15 Kilometrat e përshkruara nga makinat e AZHBR 2015-2016

Muaji	2015		2016		2015		2016	
	Km	%	Km	%	Karburant	%	Karburant	%
Janar	4,671	5	3,621	3	1,005	6.9	340	2.0
Shkurt	11,104	12	3,533	2	1,710	11.7	530	3.1
Mars	7,579	8	5,313	4	1,180	8.1	500	2.9
Prill	2,646	3	4,574	3	410	2.8	580	3.3
Maj	10,704	11	35,274	25	1,630	11.2	4,650	26.8
Qeshor	12,650	13	10,088	7	1,920	13.2	835	4.8
Korrik	5,729	6	10,879	8	890	6.1	1,233	7.1
Gusht	2,725	3	5,495	4	420	2.9	740	4.3
Shtator	8,217	9	4,796	3	1,260	8.6	502	2.9
Tetor	6,879	7	7,036	5	1,070	7.3	932	5.4
Nëntor	8,188	8	21,890	15	1,170	8.0	2,740	15.8
Dhjetor	15,408	16	31,184	22	1,920	13.2	3,780	21.8
Gjithsej	96,500	100	143,683	100	14,585	100.0	17,362	100.0

Burimi: Të dhëna të AZHBR, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga intervista realizuar me Përgjegjësin e sektorit të monitorimit në datën 14.11.2017, rezultoi se deri në datën 13.11.2017, përgjegjësi i sektorit nuk ka patur dijeni dhe në dispozicion listën me investimet e kryera me fondet e AZHBR, pra e thënë ndryshe nuk ka ditur se kë duhet të monitorojë, por ka monitoruar 20 investime nga 137 në total, vetëm duke u bazuar në një listë të vënë në dispozicion nga Drejtoresha e Përgjithshme e mëparshme, pra jashtë çdo kriteri, nga të cilat 4 investime prej tyre nuk ishin duke funksionuar sipas kushteve të përcaktuara në kontrat dhe theksojmë se vihet re një mungesë bashkëpunimi dhe koordinimi midis strukturave të AZHBR.

Gjithashtu nga kjo intervistë rezultoi, se ky sektor, megjithëse po bëhen 2 vjet nga krijimi i tij, deri në korrik të vitit 2017, nuk ka patur një manual për ushtrimin e funksionit të tij, nuk ka një kalendar për kryerjen e monitorimeve, nuk ka një metodologji për përcaktimin e kriterëve për mënyrën se si duhet të monitorohen investimet, kush investim do të monitorohet në bazë të riskut dhe se sa herë do të monitorohet brenda 5 viteve, duke e ulur shumë eficientë dhe efektivitetin e këtij sektori, dhe rrjedhimisht efektivitetin e fondeve të dhëna për periudhën 2013-07.2016.

Në tabelën më sipër kemi pasqyruar informacionin për kilometrat e përshkruara nga makinat që përdoren nga inspektorët e kontrollit për të kryer verifikimin. Kutit të cilat i kemi me ngjyrë , janë pikërisht muajt të cilët kanë km më të larta. Shikojmë se në vitin 2015 km më të larta janë në muajt Shkurt, Maj dhe Dhjetor, çka do të thotë se nuk ka një lidhje logjike të km të përshkruar me muajt kur duhet të kryehet verifikimi, pra nëse periudha e aplikimit është në muajt mars-prill, rrjedhimisht km më të larta të përshkruara duhet të jenë në muaj Maj-Qershor, dhe jo Shkurt apo Dhjetor, me qëllimin që brenda muajve Nëntor-Dhjetor të kryen pagesat e fundit ndaj përfituesve. Sasia e lartë e km të përshkruar në periudhën Nëntor-Dhjetor, (megjithëse në këtë periudhë kryhen verifikime për pagesën e 30% të

⁶⁷ Urdhër i Kryeministrit 2013-2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së agjencisë për zhvillim bujqësor dhe rural”

⁶⁸ Rregullore e brendshme e funksionimit të AZHBR 2012-2016.

⁶⁹ Urdhër nr. 156, datë 01.12.2015 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së agjencisë për zhvillim bujqësor dhe rural”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

vlërës së financimit, përsëri gjatë kësaj kohe kontrollohen vetëm 10% të përfituesve dhe jo 100% për të justifikuar sasinë më të lartë të km në këto muaj), në vitin 2015 si dhe në vitin 2016 tregon që verifikimi në terren nga Drejtoria e Kontrollit zgjat më tepër se sa duhet, duke e lënë aplikantin në pritje deri në fund të vitit për tu verifikuar e më pas nëse do paguhet apo jo.

Referuar rregullores së vjetër të AZHBR dhe manualeve të implementimit të procedurave 2013-2014-2015, nuk përcaktohej në asnjë kapitull, monitorimi i skemave kombëtare, me përjashtim të sektorit të raportimit, ku një nga detyrat e tij ishte, monitorimi i zbatimit dhe i arritjes së objektivave nëpërmjet rezultateve. Dy ndër objektivat më kryesor të AZHBR, janë: Zbatimi i skemave të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Hartimi i raporteve dhe analizave në përputhje me zhvillimin e bujqësisë.

Nga intervista e realizuar me specialisten e sektorit të raportimit në datën 14.11.2017, rezultoi se nuk është monitoruar asnjë prej këtyre objektivave, dhe nuk dispononte informacion për realizimin e këtyre objektivave. Kjo dukuri ka qenë edhe për periudhën 2016-2017 me hyrjen në fuqi të rregullores së re, ku përsëri një nga detyrat e këtij sektori, ishte monitorimi i zbatimit dhe arritjes së objektivave.

Si konkluzion:

- Mungesa e përcaktimit në udhëzimet e përbashkëta të MBZHRAU dhe MF në periudhën 2013-2017, funksionit të monitorimit për skemat kombëtare të vogla, përveç verifikimit para financimit dhe pas financimit 70 % të vlerës së investimit, ka ulur efektivitetin e fondeve të dhëna ndaj fermerit.

Për këtë rekomandojmë:

1. *Ministria e Bujqësisë dhe MF në udhëzimin e përbashkët që miratojnë çdo vit për skemat kombëtare, të përcaktojnë edhe monitorimin e skemave kombëtare të vogla, me qëllim matjen e efektivitetit të fondeve të dhëna për këto skema.*

Menjëherë

- Mungesa e sektorit të monitorimit për periudhën 2013-2015, mungesa e analizës për përcaktimin e numrit të duhur të stafit të kësaj strukture, me qëllim mbulim sa më të mirë të monitorimit të investimeve, si dhe fillimi i aktivitetit të kësaj strukture rreth 10 muaj me vonesa nga momenti i krijimit, ka sjell ulje të efikasitetit dhe efektivitetit të AZHBR në ushtrimin e këtij funksioni, ka ndikuar negativisht në efektivitetin e fondeve të dhëna për skemat kombëtare.

- Mungesa e manualit të detajuar për sektorin e monitorimit, metodologjisë për kryerjen e monitorimit, ka sjell ulje të efektivitetit gjatë ushtrimit të detyrave të këtij sektori dhe ulje të efektivitetit të fondeve të dhëna.

Për këto rekomandojmë:

2. *Sektori i monitorimit AZHBR, të kryejë analizë për përcaktimin e numrit të nevojshëm të stafit, të marri masat e nevojshme për përgatitjen e një manuali specifik për këtë aktivitet, ku të përmbajë metodologjinë, kalendarin, frekuencën e monitorimit (minimalisht një investim të monitorohet 1 herë në vit) dhe analizën e riskut mbi bazën e të cilit do të përzgjidhen investimet për tu monitoruar, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtij sektori.*

Menjëherë

Ky rekomandim është vlerësuar dhe konfirmuar dhe nga observacionet e AZHBR, me nr. 639/3 prot., datë 29.12.2017, dhe janë shprehur se do të merren masa për hartimin dhe përshtatjen e manualit të monitorimit të investimeve sipas manualit IPARD.

- Mungesa e informacionin për indikatorët gjatë monitorimit të investimeve të cilët sigurojnë të dhëna reale dhe të qëndrueshme se sa efektive janë fondet e dhëna, p.sh se sa ka qenë numri i të punësuarve në momentin e fillimit të aktivitetit dhe sa ka qenë në momentin e monitorimit, ecuria e të ardhurave të biznesit në ulje apo në rritje, ecuria e prodhimit në ulje apo rritje, etj, ka ulur efektivitetin e funksionit të monitorimit.

Për këtë rekomandojmë:

3. *Sektori i monitorimit gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, të monitoroj disa indikatorë të rëndësishëm, si rritja e fuqisë punëtore për biznesin, ecuria e të ardhurave, ecuria e prodhimit të aktivitetit, si dhe të rrisë numrin e monitorimeve gjatë 1 viti, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të fondeve të dhëna.*

Vazhdimisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

- Mungesa e auditimit të pagesave për skemat kombëtare të vogla për vitet 2013 dhe 2016 nga SAB, gjetjet dhe rekomandimet e varfra në përmbajtjen e tyre, si dhe auditimi rreth 3 % të totalit të përfituesve nga skemat e vogla, një vlerë shumë e ulët në krahasim me periudhën prej 4 vitesh, tregon për një performancë të ulët të këtij sektori, duke ndikuar negativisht edhe në matjen e efektivitetit të AZHBR ndaj skemave kombëtare.

Për këtë rekomandojmë:

4. SAB të kryejë auditimin e skemave kombëtare çdo vit sipas përcaktimit në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe MF, si dhe gjatë këtyre auditimeve trendi i dosjeve të përfshira për t'u audituar të jetë në rritje, me qëllim identifikimin e problematikave gjatë zbatimit të skemave kombëtare nga ana e AZHBR.

Vazhdimisht

- Mungesa e monitorimit të objektivave (ku më kryesori është zbatimi i skemave kombëtare) të AZHBR, nga sektori i raportimit për periudhën 2013-2017, ka ndikuar negativisht në eficientë dhe efektivitetin e këtij institucioni në realizimin e zbatimit të skemave kombëtare.

- Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit në kohë midis sektorit të monitorimit dhe sektorëve të tjerë të AZHBR (sektori i autorizimit të pagesave), ka ndikuar negativisht në punën e sektorit të monitorimit.

- Mos përditësimi me informacion i treguesve të monitorimit sipas SNZHRB 2014-2020, si normën e rritjes reale ekonomike të sektorit bujqësor, produktivitetin e këtij sektori, ka sjellë mungesën e këtyre statistikave të rëndësishme, të cilat janë elementë të rëndësishëm që ndikojnë në vendimmarrjen e institucioneve përgjegjëse për zhvillimin rural dhe të bujqësisë.

Për këto rekomandojmë:

5. Sektori i raportimit AZHBR, të monitoroj zbatimin dhe ecurin e objektivave të AZHBR, gjithashtu të përditësojë informacionin lidhur me indikatorët e monitorimit të përcaktuar në SNZHRB 2014-2020, me qëllim përgatitjen e informacionit të saktë dhe të plotë për tu raportuar ndaj Ministrisë së Bujqësisë dhe Autoritetit Menaxhues.

Vazhdimisht

- Mos vënia në dispozicion të AZHBR të strategjisë ndërsektoriale për zhvillim rural dhe bujqësor 2014-2020, nga institucionet përgjegjëse, tregon një mungesë bashkëpunimi ndërmjet tyre, duke sjellë efekte negative për të dyja palët.

Për këto rekomandojmë:

6. Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të kenë koordinim dhe bashkëpunim sa më të ngushtë midis tyre, si dhe AZHBR-së t'i vihet në dispozicion nga Ministria e Bujqësisë “SNZHRB 2014-2020”, me qëllim identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndeshura nga eksperiencat e mëparshme gjatë aktivitetit të saj.

Menjëherë



4. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE, KONKLIZIONEVE DHE REKOMANDIMEVE

4.1 Informacion përmbledhës

Zhvillim i bujqësisë është një çështje ekonomike, financiare e sociale me shtrirjen më të gjerë gjeografike e demografike dhe që ndikon në tërësi mirëqenien e qytetarëve shqiptar. Në periudhën 2013 - 2015 kontributi i bujqësisë në ekonominë shqiptare përfaqëson mesatarisht 17 % të GDP-së, popullsia banuese në zonat rurale ka shfaqur prirje në rënie nga 63,6 % (1990) në 42.59 % në vitin 2016, si dhe vazhdon të mbetet sektori kryesor i punësimit për rreth 45 % të të punësuarve gjithsej. Veç kësaj, vlera e produkteve bujqësore dhe blegtorale në periudhën 2013-2016 zë mesatarisht 34 % të importeve dhe 2.28 % të eksporteve gjë që tregon se ekonomia jonë bujqësore nuk është akoma konkurruese me atë të vendeve të tjera. Gjithashtu, gati gjysma e popullsisë shqiptare (45.5 %) jeton me 5 dollarë në ditë, një kufi që konsiderohet varfëri nga Banka Botërore, e matur kundrejt nivelit të standardizuar rajonal, ose trefishi i nivelit krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Shkalla e varfërisë në zonat rurale është rritur nga 15,0 % në 2008 në 15,5 % në vitin 2012, duke shfaqur që nuk është më e përqendruar në zonat malore rurale.

Megjithëse sektori i bujqësisë është përfshirë në prioritetet strategjike të qeverisë për zhvillim, duke i ofruar edhe lehtësira procedurale, vazhdon të mbetet një nga sektorët më informal të ekonomisë, i cili vihet re në nivele të ndryshme në të gjitha hallkat e zinxhirit të prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore e blegtorale.

Në këto kushte, bujqësia konsiderohet një nga sektorët kryesor dhe potencial për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, për të cilën, krahas politikave të tjera mbështetëse, është financuar nga buxheti i shtetit. Pra një numër fermerësh kanë përfituar nga grantet (subvencionet) e skemave kombëtare me synim që të nxitet prodhimi, përpunimi, tregtimi dhe të rritet konkurrueshmëria në sferën bujqësisë. Në këtë kuadër AZHBR ka për detyrë, midis të tjerave të vëre në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, si dhe është përgjegjëse për administrimin e fondeve buxhetore të vëna në dispozicion për këtë qëllim. Rritja e subvencioneve për bujqësinë dhe burimet buxhetore të kufizuara kërkojnë domosdoshmërisht rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve në skemat kombëtare. Në këtë mënyrë, mbështetja e fermerëve dhe zhvillimi rural kërkojnë sisteme të forta menaxhimi dhe kontrolli.

AZHBR është një nga institucionet më të rëndësishme publike në menaxhimin dhe administrimin e pjesës më të madhe të fondeve buxhetore për zhvillimin e bujqësisë dhe të zonave rurale. Për më tepër, që Shqipëria ka mundësi të kufizuara të burimeve financiare të brendshme për shkak të enteve të dobëta dhe nivelit të lartë të ekonomisë informale.

Nevoja e miradministrimit dhe mirmenaxhimit të granteve nga AZHBR bëhet më e domosdoshme në kushtet kur bujqësia e vendit tonë vuan akoma pasoja të copëzimit të parcelave të tokës, çështjet madhore të pronësisë, mungesën e informimit dhe këshillimit të fermerëve në të gjithë territorin, largimin e fuqisë punëtore aktive etj., të cilat të gjitha së bashku kërkojnë rritjen e efektivitetit të granteve nga AZHBR.

AZHBR gjatë kryerjes së aktivitetit të saj, duhet të zbatojë përcaktimet në VKM për kriteret bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Në periudhën e aktivitetit të audituar të AZHBR 2013-2017, numri gjithsej i llojeve të masave është 23, por që disa prej tyre janë alternuar gjatë viteve të kësaj periudhe. Pavarësisht luhatjes së numrit të përfituesve, fondet buxhetore për zhvillimin e bujqësisë dhe atë rajonal kanë prirje të rriten, por interesat e vendit kërkojnë rritjen e vazhdueshme dhe me ritme të shpejta të financimit të bujqësisë në përputhje me strategjinë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor.

Veprimtaria e AZHBR-së 2013-2017 gjatë gjithë procesit të aplikimit: informimi, pranimi, kontrolli administrativ i aplikimeve, kontrolli në terren para dhe pas financimit; më pas të monitorimit të ecurisë së financimit përgjatë një periudhe kohore të caktuar, në miradministrimin e fondeve të buxhetit të shtetit për zhvillimin e bujqësisë dhe të rajoneve, përbëjnë objektin e këtij auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, jemi përpjekur t'i japim përgjigje pyetjes kryesore: *Sa ka kontribuar performanca e AZHBR në efektivitetin e granteve në zhvillimin bujqësor dhe rural? dhe në përfundim ka arritur në këtë mesazh auditimi:*

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural nuk ka arritur efektivitetin e synuar nga menaxhimi dhe administrimi i fondeve buxhetore për skemat kombëtare, për shkak se:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore ka shfaqur mangësi në strukturimin organik, formimin bazë, rekrutimin, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së tyre etj.;
- Kanë shfaqur mangësi vetë procedurat e subvencionimit për skemat kombëtare të analizuara në dinamikë për kushtet dhe kriteret e përfitimit, si dhe zbatimit të tyre nga ana e AZHBR;
- Fondet e dhëna për informim kanë rezultuar jo efektive, pasi mjetet e komunikimit kanë qenë të kufizuara, informacioni i pamjaftueshëm dhe jo cilësor, nuk është menaxhuar siç duhet etj.;
- Financimet për mbrojtjen e ullirit nuk rezultojnë efektive, pasi nuk janë zbatuar siç duhet procedurat e prokurimit, nuk është vepruar në përputhje me kuadrin rregullator, verifikimet dhe monitorimet për këtë skemë nga AZHBR kanë qenë me mangësi, duke rritur premisat për abuzime nga ana e institucionit;
- Fondet e investimeve të përfituara nuk janë shfrytëzuar si duhet në aspektin ekonomik, për të gjeneruar më pas të ardhura të mjaftueshme për të mbështetur zhvillimin e zinxhirit të vlerës që të mund të zhvillojnë projekte të besueshme për financim;
- Ka munguar sektori i monitorimit për një periudhë 4-vjeçare, e si pasojë edhe monitorimi i skemave kombëtare të vogla dhe investimeve, duke e ulur ndjeshëm efektivitetin e fondeve të dhëna për ato.

Konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi janë si më poshtë:

1.1 Për pyetjen: Si ka ndikuar menaxhimi i stafit dhe specialistëve të AZHBR në funksion të zbatimit të procedurave të granteve?

- Numri i inspektorëve të kontrollit në nivel qarku nuk ka qenë i mjaftueshëm për të kontrolluar dosjet e aplikuesve dhe përfituesve potencial brenda afatit të caktuar për vitet 2013-2014, duke krijuar në këtë mënyrë vonesa në DEP, për ekzekutimin e pagesave ndaj përfituesve, për pasojë ndikim negativ në besimin e fermerëve ndaj granteve në skemat kombëtare të bujqësisë.
- Konstatohet një prirje negative e zvogëlimit të numrit të inspektorëve dhe specialistëve që angazhohen direkt me kontrollin dhe monitorimin e skemave kombëtare, dy nga aktivitetet e një rëndësie të veçantë për AZHBR, në raport me numrin e skemave kombëtare, numrin e përfituesve që duhet të kontrollojnë, shtrirjen e gjerë territoriale të investimeve që financohen, si dhe rritjes së përvitshme të vlerës së fondeve buxhetore, me pasoja në uljen e efektivitetit të granteve të dhëna.
- Mungesa e studimeve, analizave dhe të planeve të veprimit për përcaktimin e numrit të punonjësve në strukturën totale të AZHBR, por edhe të drejtorive në veçanti, si dhe të llojit të profesionit që duhet të mbizotërojë në strukturë, ka shkaktuar ulje të efikasitetit në kryerjen e detyrave dhe uljen e efektivitetit në realizimin me sukses të objektivave.
- Për vitin 2015 AZHBR, si pasojë e mungesave në staf, kryesisht në drejtorinë e kontrollit, ka pasur performancë të ulët, duke ndikuar negativisht edhe në efektivitetin e granteve.
- Për një pjesë të konsiderueshme të punonjësve të AZHBR, 23 për totalit, ka munguar vlerësimi i performancës, gjë që përbën shkak për uljen e motivimit në punë, mos evidentimin e problematikave si dhe mos realizimin me sukses të detyrave funksionale.
- Kalimi i statusit të punonjësve nga shërbimi civil në kod pune në AZHBR, përbën një risk të konsiderueshëm në marrëdhëniet e punës së punonjësve me institucionin, sepse në këtë mënyrë Titullari ka liri veprimi në rekrutimin, seleksionimin dhe largimin nga puna të punonjësve. Gjithashtu trajtimi i marrëdhënieve të punës nëpërmjet kodit të punës rrit pasigurinë e punonjësit për vendin e punës, ndikon negativisht në motivimin si dhe ul performancën e tij në punë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

- Mbizotërimi i profesioneve që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet kryesore të AZHBR, afërsisht 64 % e profesioneve, si dhe rekrutimi i një pjesë të konsiderueshme të punonjësve në sektorin e kontrollit përgjatë viteve 2013-2017 në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga vetë AZHBR për pozicionin e Inspektorit të Kontrollit, ka ndikuar negativisht në realizimin me sukses të objektivave të AZHBR, kryesisht atë të përzgjedhjes, kontrollit dhe monitorimit të projekteve, duke i bërë këto të fundit jo efektive.

Për këto rekomandojmë:

7. AZHBR të kryejë analiza, studime, si dhe të hartojë dhe të kërkojë zbatimin e planeve të veprimit për numrin e punonjësve në strukturën e saj, llojet e profesioneve, veçanërisht në sektorin e kontrollit dhe të monitorimit të skemave kombëtare, sektorin e përzgjedhjes dhe aprovimit të projekteve për të rritur performancën e tyre, si dhe efektivitetin e granteve.

Brenda gjashtëmujorit të parë 2018

- Mungesa e një sektori në AZHBR, për informimin dhe këshillimin e fermerëve për procedurat që duhet të ndjekin dhe dokumentacionin standard që duhet të dorëzojnë në AZHBR, e cila ka ndikuar negativisht në numrin e aplikuesve, duke ulur numrin e tyre, të përfituesve nga skemat kombëtare, është përgjegjësi e drejtimit të institucionit.

Për këtë rekomandojmë:

8. AZHBR të marrë masat e nevojshme për krijimin e sektorit që shërben për informimin dhe këshillimin e fermerëve, me qëllim shmangien e gabimeve, vonesave gjatë përgatitjes së dokumentacionit si dhe penaliteteve që ndodhin gjatë kontrollit të aplikimeve.

Brenda gjashtëmujorit të parë të 2018

- Rritja e numrit të stafit sipas strukturës së re të miratuar në vitin 2015, kryesisht në sektorin e kontrollit të skemave kombëtare, përball mungesës së infrastrukturës së nevojshme për të realizuar në mënyrë të saktë, të plotë dhe brenda kohës së caktuar kontrollin e skemave kombëtare, ka ulur ndjeshëm eficientësinë dhe efektivitetin e këtij funksioni.

Për këtë rekomandojmë:

9. AZHBR të hartojë dhe të zbatojë një program të veçantë investimi me prioritete të evidentuara për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për kontrollin dhe monitorimin e skemave kombëtare si: GPS, Odometër, kuti e ndihmës së shpejtë etj., në funksion të rritjes së efektivitetit të granteve në bujqësi.

Brenda gjashtëmujorit të parë të 2018

- Trajnimet nuk kanë rezultuar eficientë dhe efektive, për shkak se: nuk janë në përputhje me nevojat e çdo drejtorie të AZHBR, inspektorë të kontrollit të skemave kombëtare, trajnohen për tema të cilat nuk ndihmojnë drejtpërdrejtë në rritjen e performancës, duke ulur efektivitetin e aktivitetit të kontrollit, janë të përqendruara në një numër punonjësish, janë të pabarabarta referuar viteve të eksperiencës, nuk kanë lidhje logjike me vitet e punës në AZHBR dhe ditët e trajnimit, duke ndikuar negativisht në performancën e atyre punonjësve që përbëjnë vazhdimësinë e institucionit, çka ka sjell uljen e performancës së punonjësve, kryesisht të inspektorëve të kontrollit në nivel qarku, duke ulur edhe efektivitetin e kontrollit dhe monitorimit të granteve të dhëna.

Për këtë rekomandojmë:

10. AZHBR të kryejë trajnime jo në numër të përqendruar punonjësish, por të jenë gjithë përfshirëse. Inspektorëve të kontrollit në nivel qarku t'u kushtohet më shumë vëmendje në këtë drejtim. Gjithashtu trajnimet të kenë një lidhje logjike midis eksperiencës në AZHBR, midis vlerësimit të performancës dhe nevojës për trajnime. Gjithashtu të kryejë vlerësimet e performancës dhe të marrin masat e nevojshme për punonjësit që kanë më shumë se dy masa disiplinore.

Vazhdimisht

- Afërsisht 62% e të larguarve janë nga Drejtoria e Kontrollit, ku një pjesë e konsiderueshme (30 prej tyre) janë me 3-6 vite eksperiencë në AZHBR në pozicionet përkatëse dhe me formimin e duhur profesional. Këto veprime nga ana e Titullarit të Institucionit kanë ndikuar negativisht në vazhdimësinë e ushtrimit të aktivitetëve të AZHBR, por kryesisht në aktivitetin e kontrollit, ku kanë qenë edhe largimet më të larta, të cilat kanë sjellë uljen e performancës por edhe performancën e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

munguar, si pasojë e vendeve pune bosh të krijuara, duke ulur efektivitetin në kontrollin dhe monitorimin e granteve.

- Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të AZHBR është shpenzuar në mënyrë jo efektive për proceset gjyqësore, dukuri, e cila ka ardhur prej largimeve nga puna pa kriter, pa shkaqe të arsyeshme, kryesisht në muajt Nëntor-Dhjetor 2013 dhe Janar-Shkurt 2014, një periudhë e cila përkon me ndryshimin e drejtimit të institucionit.

Për këto rekomandojmë:

11. AZHBR të analizojë dhe të evidentojë përgjegjësinë për largimet nga puna pa shkaqe ligjore, duke marrë masat e nevojshme për të shmangur përsëritjen e tyre në të ardhmen.

Vazhdimisht

I.2 Për pyetjen: A është ndikuar efektiviteti i granteve nga performanca e AZHBR në zbatimin procedurës së dhënies së granteve?

- Viti 2017, konsiderohet një vit i mos-realizimit të objektivave, për shkak se:
 - është ndikuar nga lëvizja e stafit në nivelet e larta drejtuese të AZHBR,
 - ende nuk është përgatitur relacioni për planifikimin e fondeve sipas skemave kombëtare për këtë vit. Mospërgatitja e relacionit në vitin 2017 për mënyrën e shpërndarjes së fondit, sipas qarkut, rrethit dhe skemave, duke mos respektuar pikën 3 të Udhëzimit të 2017⁷⁰, është pasojë e performancës së ulët të AZHBR, e cila ka sjellë mungesën e orientimit të duhur të fondit për skemat kombëtare, duke ndikuar negativisht efektivitetin e tyre.
 - sipas vizitave në terren dhe intervistave të zhvilluara, procesi i aplikimit, kontrolli në terren, kontrolli administrativ kanë zgjatur tej mase, nga 2-3 muaj, mangësi e cila do të sjellë si pasojë ekzekutimin me vonesë të pagesave, si dhe do të rrisë numrin e përfituesve të prapambetur në vitin 2018.
 - Performanca e ulët e AZHBR gjatë ushtrimit të detyrave, do të çënojë besimin e fermerëve si dhe do të ndikojnë negativisht në efektivitetin e skemave kombëtare.
- Keq planifikimi, keq administrimi si dhe rialokimet e shpeshta të fondeve për skemat kombëtare brenda vitit, si pasojë e mungesës së kriterëve për planifikimin e tyre, mungesës së përcaktimit të afateve për verifikimin në terren, kontrollit administrativ të aplikantit/përfituesit, si dhe paaftësia e AZHBR për të përthithur të gjitha fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit për skemat kombëtare, e ka shndërruar atë në një “debitore” të rregullt ndaj përfituesve të këtyre skemave, duke krijuar përfitues të prapambetur çdo vit, duke ulur efektivitetin e skemave kombëtare dhe besimin e fermerëve se mund të përfitojnë nga buxheti i shtetit.
- Ulja e fondeve nga viti në vit për skemat e vogla dhe rritja e tyre për skemën e investimeve, ndërkohë që fondi total për bujqësinë ka ardhur në rritje, si dhe ndryshimet e shpeshta brenda vitit të buxheteve për këto skema, kanë ulur efektivitetin e AZHBR, kanë ndikuar negativisht tek aplikantët e këtyre skemave, duke i favorizuar më pak fermerët dhe më shumë aplikantët e investimeve, si dhe duke zvogëluar efektin e skemave të vogla në zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural.

Për këto rekomandojmë:

12. AZHBR të marrë masat e nevojshme për të përgatitur menjëherë relacionin për fondin e vitit 2017, gjithashtu të kryejë një planifikim dhe administrim më të mirë dhe më të saktë të buxhetit për skemat kombëtare, kryesisht të skemave të vogla, në momentin kur ka mbaruar procesi i aplikimit, duke rritur mundësinë që fondi i alokuar për skemat të mos pësojë ndryshime të shpeshta dhe të konsiderueshme gjatë vitit, të rriti aftësitë e saj për të përthithur të gjitha fondet që akordohen nga buxheti i shtetit për bujqësinë, me qëllim që të mos të krijohen përfitues të prapambetur dhe skemat kombëtare të jenë efektive.

Vazhdimisht

- Udhëzimi i vitit 2017 ka penalizuar aplikantët me kriteret e vendosura, kryesisht ata të skemës së blegtorisë, lidhur me përfitimin financiar prej saj, pasi: nëse një fermer me 200 krerë dele/dhi në

⁷⁰ Udhëzim nr. 8, datë 31.03.2017 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

periudhën 2014-2016 përfitonte 240,000 lekë (200*1,200), në vitin 2017 përfiton 180,000 [(1,200*100)+(600*100)], pra duket qartë që ulet ndjeshëm financimi dhe përfitimi. Këto ndryshime kanë rritur mundësitë për uljen e besimit ndaj skemave dhe uljen e efektivitetit të tyre, duke i bërë blegtorët të paiterësuar ose në kërkimin e formave jo të rregullta për përfitimin e fondeve në këtë masë.

Për këtë rekomandojmë:

13. *AZHBR t'i propozojë Ministrisë së Bujqësisë rregullimet e nevojshme në udhëzimin e përbashkët të zbatimit të skemave kombëtare në përgjithësi dhe atyre të blegtorisë në veçanti në drejtim të përputhjes së tyre me politikatat ndërsektoriale të zhvillimit të bujqësisë dhe rural.*

Në udhëzimin për skemat kombëtare 2018

- Studimet e MBZHRAU janë të vjetra në kohë dhe të pa përditësuara me ndryshimet e faktorëve (klimaterik, mjedisor), duke ndikuar negativisht në udhëzimet për përcaktimin e procedurave për skemat kombëtare si dhe në hartat e rajonizimit, duke rritur tek këto të fundit mundësinë për pasaktësi dhe në uljen e efektivitetit të fondeve buxhetore për skemat kombëtare.

Për këtë rekomandojmë:

14. *Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të marrin masat e nevojshme që të përditësojnë studimet mbi të cilat ndërtohen hartat e rajonizimit, si dhe të kryejnë analiza vjetore mbi ecurinë e skemave kombëtare dhe problematikat që i shoqëron, me qëllim rritjen e efektivitetit të granteve për zhvillimin e bujqësisë.*

Brenda vitit 2018

- Mungesa e statistikave për arsyet e skualifikimit për periudhën 2013 - 2014, statistikave për ankesat që kanë fermerët ndaj AZHBR, si dhe mungesa e koordinimit, bashkëpunimit midis drejtorive të saj, tregon mungesë efektiviteti në veprimtarinë e këtij institucioni.

Për këtë rekomandojmë:

15. *AZHBR të krijojë një databasë të saktë dhe të plotë me informacionin për skualifikimet, ankesat, të kryejnë përpunime statistikore, me qëllim përgatitjen e informacionit të saktë për tu raportuar, si dhe të forcobet bashkëpunimi midis drejtorive të saj.*

Vazhdimisht

- Në udhëzimet 2013-2016 nuk kanë qenë të formuluar saktësisht, kriteret e përfitimit nëpërmjet intervaleve me vlerat përkatëse, si dhe formula e saktë për llogaritjen e pikëve ndaj aplikantëve, duke rritur mundësinë për t'i penalizuar ata dhe ulur efektivitetin e skemave.

- Mungojnë kriteret e penalizimit për të gjithë përfituesit e mbështetjes financiare, për rastet në të cilat, ata nuk pranojnë të kontrollohen nga AZHBR, duke ndikuar negativisht në eficientësinë dhe efektivitetin e punës së inspektorëve të kontrollit.

Për këto rekomandojmë:

16. *Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me AZHBR të marrin masat e nevojshme për përcaktimin e penaliteteve, në rastet kur përfituesit e fondeve të skemave kombëtare nuk pranojnë të kontrollohen prej inspektorëve të AZHBR.*

Duke filluar nga skemat e vitit 2018

- Në udhëzimet 2013-2017 kanë munguar kriteret e detajuara për mënyrën e strukturimit të plan-biznesit, për paraqitjen e informacionit të saktë, real dhe të qëndrueshëm, dukuri e cila ka rritur riskun e ecurisë së biznesit dhe të fondeve të dhëna për mbështetjen e tyre.

Për këtë rekomandojmë:

17. *Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të marrin masat e nevojshme që të përcaktojnë kriteret specifike dhe të qarta, për mënyrën e përgatitjes, vlerësimit dhe monitorimit të plan-biznesit në rastin e financimit të projekteve të që kërkohet ky dokument, me qëllim të paraqitet informacion real dhe të qëndrueshëm, për të minimizuar riskun e dështimit të projektit.*

Duke filluar nga skemat e vitit 2018

- Nga shqyrtimi i procedurave të dhënies së granteve, si dhe nga pyetësorët zhvilluar me aplikantët dhe përfituesit të skemave kombëtare, numri i dokumenteve për tu plotësuar ka ardhur në rritje nga viti në vit, duke rritur kostot financiare dhe atyre kohore për fermerin, për më tepër vështirësinë në fazën e aplikimit, me ndikim në efektivitetin e skemave kombëtare.

Për këtë rekomandojmë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

18. *Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Financave të marrin masat e nevojshme që një pjesë të dokumenteve (kryesisht vërtetimet, OSHEE, sigurimet shoqërore) që i kërkojnë aplikantit për tu plotësuar, të verifikohen prej AZHBR vetë, nëpërmjet aksesit që duhet ti jepet në institucionet që japin këto vërtetime, me qëllim lehtësimin e aplikantit në kosto financiare dhe në kohë për përgatitjen e tyre.*

Duke filluar nga skemat e vitit 2018

- Disa prej skemave (prodhimi i mishit, akuakultura) nuk janë mbështetur në mënyrë konstante me fonde, duke i lënë të "varfra" për nga zhvillimi i tyre dhe duke u mospërbushur objektivat e SNZHBR 2014-2020 në lidhje me këta sektorë.⁷¹

- Në disa raste, skemat kombëtare të cilësuar të vogla për shkak të vlerës së financimit në periudha të ndryshme kanë rezultuar të dështuara, nuk kanë pasur jetëgjatësi dhe nuk kanë qenë frytdhënëse, që tregon për një punë të dobët monitoruese të AZHBR.

Për këtë rekomandojmë:

19. *Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të shmangin lancimin e skemave për të cilat fermerët nuk janë të interesuar, si dhe të marrin masat e nevojshme, që të mbështeten financiarisht në mënyrë të qëndrueshme disa prej sektorëve të cilat janë përcaktuar dhe si objektiva në SNZHBR 2014-2020.*

Menjëherë

- Nga vizitat në terren, si dhe nga intervistat e realizuara me inspektorët e kontrollit të AZHBR dhe specialistët e DB, administrimi i regjistrit RUDA kryhej vetëm nga DB. Mungesa e aksesit të AZHBR në këtë regjistrë, pasaktësitë e informacionit në RUDA, kanë ndikuar negativisht në punën e inspektorëve të kontrollit, duke ulur efencën dhe efektivitetin gjatë identifikimit dhe vlerësimit të numrit të kafshëve të gjalla për vitet 2013 - 2017.

Për këtë rekomandojmë:

20. *Ministria e Bujqësisë të marrë masa për përditësimin e regjistrit të blegtorisë (RUDA), si dhe t'i krijojë akses AZHBR në marrjen e të dhënave të nevojshme, për të shmangur kostot e tepërta të fermerëve në aplikimin për përfitimin nga grantet buxhetore për zhvillimin e bujqësisë.*

Menjëherë

- Nga intervistat e zhvilluara me punonjësit e AZHBR si dhe pyetësorët me aplikantët, arrihet në konkluzionin se faza më e vështirë në të gjithë procesin e dhënies së granteve, është ajo e aplikimit, si pasojë e mungesës së informacionit të duhur dhe në kohën e duhur, si dhe numrit të lartë të dokumentacionit për tu plotësuar, duke e vështirësuar aplikimin si dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e tij.

- Mungesa e informacionit për inspektorët e kontrollit në qark ndaj investimeve 50-60% ka ndikuar negativisht në performancën e punonjësve të AZHBR në qark.

- Mungesa e manualeve të implementimit të procedurave për skemat kombëtare për vitet 2014 dhe 2016, mungesa e hartimit të procedurave të veçanta për disa nga skemat në vitin 2015 sipas përcaktimeve të bëra në udhëzim⁷², si dhe mangësitë në manualët e 2013-2015-2017, ka ulur efencën dhe efektivitetin e AZHBR në zbatimin me korrektesë të procedurave për administrimin e fondeve për zhvillim bujqësor dhe rural.

- Mungesa për vitet 2013-2016 e matrikullimit të koshereve të bletëve ka krijuar mundësi për subjektivizëm dhe liri veprimi për AZHBR në identifikimin e koshereve të bletëve, skualifikimin e aplikantëve dhe pagesa të pa drejta të ndjekura për këtë periudhë, ndërkohë që për vitin 2016, mungesa e planifikimit të afateve për kontrollin dhe pagesën e përfituesve të kësaj skeme, nga AZHBR, ka sjell shpërqendrimin e tyre ata dhe ka ulur efektivitetin e kësaj skeme.

Për këto rekomandojmë:

21. *AZHBR të marrin masat e nevojshme që në manualët për implementimin e procedurave të skemave kombëtare, të jenë në përputhje me udhëzimet e cdo viti që nxjerr Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Financave, si dhe të*

⁷¹Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020.

⁷²Udhëzim i MBZHRAU dhe MF Nr. 4, datë 25.02.2015 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

përcaktojë saktësisht afatet për realizimin e detyrave nga çdo drejtori, me qëllim shmangien e krijimit të vonesave dhe rritjen e korrektesisë ndaj aplikantëve.

Menjëherë

- Pasaktësitë e sistemit që gjeneron automatikisht vlerën e autorizuar për tu paguar, kryesisht pas pagesës së 70% të vlerës, si dhe puna e kryer manualisht nga DAP dhe DEP, ul ndjeshëm efikasitetin e këtyre drejtorive si dhe rrit kostot në kohë.

Për këtë rekomandojmë:

22. AZHBR të marrë masat e nevojshme për të rregulluar pasaktësitë që rezultojnë prej sistemit që gjeneron vlerën për tu financuar ndaj përfituesve, me qëllim shmangien e punës manuale, gabimeve njerëzore që mund të krijohen prej punës manual si dhe për rakordim të plotë e të saktë.

Menjëherë

II.3.1 Për pyetjen: A kanë ndikuar fondet për publicitet në efektivitetin e granteve të dhëna?

- Nga analiza në dinamikë e fondeve për informim konstatohet se në 2014 janë shtuar 87 % në krahasim me një vit më parë, rriten gati trefish në 2015, e shoqëruar kjo dhe me një rritje të konsiderueshme në përbërje të buxhetit të shpenzuar gjithsej nga 0.5 % në vitin 2013 në 2.3 % në vitin 2016. Të dhënat tregojnë se rritja e parave buxhetore për informim mediatik nuk ka lidhje me numrin e skemave përfituese, pasi numri i tyre për çdo vit ka qenë midis 15-19 skemave. Për më tepër, që në vitin 2014 dhe 2016 ndërsa rriten fondet për informim ulet nga 19 në 15 numri i skemave përfituese. Gjithashtu, duhet theksuar se në periudhën 2013 - 2017, në pjesën më të madhe nuk kemi ndryshim as të llojit të skemave. Të gjitha këto demonstrojnë se nuk është synuar dhe nuk ka pasur një përdorim me efektivitet të fondeve për informimin mediatik të publikut për skemat kombëtare të zhvillimit të bujqësisë dhe rural.

- Sipas të dhënave të AZHBR, në vitin 2014 fondet për informimin e publikut janë rritur 2.6 herë ndërsa aplikuesit 3.25 herë, gjë që nuk ndodh në periudhat e mëvonshme. Kështu, në vitin 2015 vazhdojnë të rriten shpenzimet për publicitet gati 2.7 herë, ndërsa numri i aplikuesve ka rënie të ndjeshme në krahasim me një vit më parë, mbi 8 mijë. Luhatje të tilla tregojnë se nuk ka një lidhje të fortë midis informacionit të shpërndarë publikut dhe aplikuesve për grante në skemat kombëtare.

- Në periudhën 2013-2016 ka ndryshime të theksuara të raportit aplikues:përfitues nga 41.5 % në vitin 2014 në 98 % në 2015, duke demonstruar më së paku cilësi të dobët informacioni ose shpenzimet për këtë qëllim nuk kanë pasur ndonjë efekt të dukshëm dhe të matshëm në arritjen e objektivave për të cilën shpenzohen.

Për këto rekomandojmë:

23. AZHBR të hartojë një relacion të veçantë mbi mënyrën e përdorimit të fondit për informimin e publikut për të argumentuar nevojat e domosdoshme, duke e lidhur me numrin e skemave, numrin e aplikuesve, ndryshimet, numrin e përfituesve etj., me synim ofrimin e informacionit sasior dhe cilësor për fermerët, duke rritur efektivitetin e këtyre shpenzimeve buxhetore.

Çdo vit, menjëherë pas alokimit të buxhetit

- Nga ana e AZHBR, nuk ka pasur ndonjë relacion mbi motivet e rritjes së këtij fondi, por është parë thjeshtë si fond që duhet shpenzuar sipas destinacionit të përcaktuar në VKM. AZHBR nuk ka përgatitur strategji komunikimi për të përcaktuar objektivat, grupet e synuara, mjetet, treguesit etj., dhe një set indikatorësh për të matur efektivitetin e kësaj pjese të rëndësishme të fondeve buxhetore.

Për këtë rekomandojmë:

24. AZHBR të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë strategjinë e komunikimit, duke përcaktuar objektivat, grupet e synuara, mjetet, treguesit etj., si dhe një set indikatorësh për të matur efektivitetin e kësaj pjese të rëndësishme të fondeve buxhetore.

Brenda tremujorit të parë 2018

- Megjithatë duke filluar nga viti 2015, në VKM-të për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, vlera e fondeve për informacionin mediatik të publikut është zgjeruar në koncept në fonde për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

aktivitete informuese për publikun, AZHBR ka vazhduar me zbatimin e VKM nr. 1195 datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, bashkëprodhimin e programeve dhe reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizive ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, megjithëse ka pasur mundësitë ligjore që të zgjerojë mjetet e komunikimit me publikun edhe me fletëpalosje, broshura, postera, takime informative rajonale, workshop-e etj., për të mos u kufizuar vetëm në spote televizive dhe botim njoftimesh në gazeta.

Për këtë rekomandojmë:

25. *AZHBR ta përdorë fondin për informimin e publikut duke zgjeruar mjetet e komunikimit edhe me fletëpalosje, broshura, postera, takime informative rajonale, workshop-e etj., për të mos u kufizuar vetëm në spote televizive dhe botim njoftimesh në gazeta.*

Çdo vit, para periudhës së aplikimit

- Veprimtaria menaxhuese e AZHBR në periudhën 2013-2016 për fondin e informimit është shoqëruar me mangësi të natyrave të ndryshme si: kanë munguar në këtë proces specialistë të komunikimit; ka raste të nisjes me shumë vonesë të zbatimit të procedurës; nuk janë përcaktuar tregues të efektivitetit të fondit; diferenca në tregues të ndryshëm (periudhë, kohëzgjatje, numër spotesh etj) midis urdhrimit të nisjes së procedurës, përcaktimeve të komisionit dhe kontratës së nënshkruar për këtë qëllim; gjatë monitorimit kanë rezultuar mangësi në transmetimin e spoteve të cilat kanë ndikuar në rezultatet e informacionit; në përcaktimin e fondit limit, komisioni pretendon të jetë bazuar në studimin e tregut për prodhimin e spoteve duke marrë oferta nga 3 subjekte, të cilat janë pa datë dhe pa numër protokolli, pra nuk plotësojnë kushtet e një dokumenti justifikues dhe argumentues për një çështje të tillë monetare; vonesa në zbatimin e urdhrave për këtë procedurë etj.

- Në vitin 2015, çmimi mesatar për sekondë krahasuar me ofertat e vitit 2014 në vitin 2015 është 6.6 herë më i lartë, që do të thotë se mbi 9 milion lekë janë shpenzime pa efektivitet; janë transmetuar spote në dy periudha (faza) jashtë afatit të aplikimit, çka tregon se këto shpenzime nuk kanë qenë në funksion të informimit të fermerëve.

- Për vitin 2016, ndryshe nga një vit më parë, kur spoti institucional është vlerësuar 2,000,000 lekë, në vitin 2016 është përcaktuar 5,000,000 lekë, me të njëjtat kushte, pra 3,000,000 lekë më shumë, të cilat janë plotësisht pa asnjë lloj efektiviteti, si dhe është paguar shfaqja e spotit jashtë afatit të aplikimeve për promovimin e AZHBR, dhe jo të skemave kombëtare, aq më tepër që është mbyllur 3 ditë para aplikimeve.

Për këto rekomandojmë:

26. *AZHBR të marrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin rigoroz të procedurës së ideimit, prodhimit dhe shfaqjes së spoteve publicitare, duke përfshirë specialistë të komunikimit, në funksion të emetimit të informacionit të nevojshëm dhe cilësor për skemat kombëtare, duke rritur efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve.*

Vazhdimisht

- Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR nuk kanë hartuar dhe zbatuar një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për skemat e përfutimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfutuar mbështetje financiare nga fondi i programit për mbështetjen e prodhimit bujqësor dhe zhvillimin rural, sipas kërkesës së vendosur në udhëzimin përbashkët për zbatimin e skemave kombëtare.

Për këtë rekomandojmë:

27. *Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të hartojnë dhe të zbatojnë planin e informimit dhe ndërgjegjësimit të grupeve të interesit për skemat, kriteret dhe kushtet e përfutimit të mbështetjes financiare nga fondi buxhetor për zhvillimin e bujqësisë dhe të rajoneve.*

Brenda muajit shkurt 2018

- Megjithëse fondet për informim përbëjnë mbi 2% të fondeve gjithsej ato nuk kanë qenë objekt auditimi nga ana e sektorit përkatës në AZHBR.

Për këtë rekomandojmë:

28. *Sektori i auditit të brendshëm në AZHBR të ushtroj një auditim tematik mbi menaxhimin e fondit për informimin e publikut, duke evidentuar dhe adresuar problematikat përkatëse.*



Çdo vit, pas përfundimit të përdorimit të fondeve për informim

II.3.2 Për pyetjen: Sa efektive kanë qenë financimet buxhetore për mbrojtjen e ullirit në vendin tonë?

Si konkluzion:

- Mungesë qëndrueshmërie në treguesit e përfitimit të skemës së mbrojtjes ullishteve nga dëmtimi i mizës, pasi në periudhën 2014 - 2016 ka ndryshuar përcaktimin e fermerëve përfitues nga Ministria e Bujqësisë në DB, në përcaktimin e numrit të rrënjëve për ha, ndryshimit të formës dhe afatit të paraqitjes së listave etj., duke sjellë si pasojë çorientimin e përfituesve dhe ulje të efektivitetit të kësaj skeme.

- Sipas të dhënave në vitin 2014 sipërfaqja e trajtuar prej 2109.73 ha është e shtrirë në 5 qarqe me pjesën më të madhe në Berat 38.4 %; në 2015 në 6 qarqe 3081.27 ha me përqendrim në Fier me 42.5 % dhe në vitin 2016 vetëm në 2 qarqe Vlorë dhe Fier një sipërfaqe prej 3687.6 Ha nga 5,352 të përcaktuar nga DB në qarqe. Pra, në se konsiderohen domosdoshmëri përcaktimet e DB ato në fakt nuk janë zhvilluar sipas kërkesës, duke ulur ndjeshëm efektin e kësaj mase në shkallë vendi si dhe në aplikimin e të gjithë fondit të akorduar.

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit janë shfaqur mangësi në përcaktimin e fondit limit mbi bazën e ofertave të cilët nuk plotësojnë kërkesat përkatëse të një dokumentacioni zyrtar argumentues për këtë qëllim por kanë vendosur kufirin maksimal prej 35,000 lekë të përcaktuar në VKM për këtë skemë.

- Në përcaktimin e fondit limit, komisioni nuk ka marrë në konsideratë numrin e rrënjëve për ha, i cili është përcaktues në vendosjen e pesticidit që lufton mizën e ullirit. Kjo pasi sipas metodikes së sjellë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, për çdo dy rrënjë ullinj përdoret një pako pesticid (ECO TRAP-kurth), për një efekt sa më të mirë dhe me ndikime sa më të vogla në mjedis.

- Sipas dokumentacionit të sjellë nga DB konstatohet se nënshkrimet e fermerëve pothuajse janë të njëjta, dmth fiktive; hartat kadastrale nuk provojnë se janë blloqe mbi 50 ha; nuk ka datën e fillimit dhe të përfundimit të trajtimit për secilin bllok; Lezha nuk ka paraqitur harta kadastrale por harta administrative, po kështu dhe Vlora. Pra dokumentacioni i sjellë nga DB nuk është në përputhje me udhëzimin përkatës duke ulur ndjeshëm efektivitetin e kësaj mase për efekt të përcaktimit të fondit limit dhe monitorimit të kryerjes së këtij shërbimi.

- Efektiviteti i luftimit të mizës së ullirit varet në mënyrë të konsiderueshme nga monitorimi i dëmtuesit si dhe vlerësimi i dendësisë së tij, i cili fillon në fund të muajit qershor, në fakt listat e DB janë dorëzuar që në mesin e muajit maj, pra para se të kryhet ky monitorim.

- KVO e ka shpallur fituesin, pa marrë shpjegime lidhur me vendosjen ecotrapeve numrit mesatar të rrënjëve të ullirit sipas loteve jo mbi bazën e faktit, por mbi bazën e ofertës. Kështu, në vitin 2014, në DB Vlorë, në fakt janë mesatarisht 150 rrënjë për ha, tenderi është shpallur fitues duke vendosur 240 rrënjë për ha, pra 90 rrënjë më shumë ose 37 %; për Fierin janë në fakt 153 rrënjë mesatarisht për ha dhe në tender janë marre për 240 rrënjë për ha, ose 36 %; për Tiranen nga 191 rrënjë për ha në fakt, janë kontraktuar 240 ose 21 % më shumë, ndërsa në Fier nuk janë përcaktuar numër rrënjësh për sipërfaqe; Oferta fituese ka të kontraktuar me furnizuesin 250,000 "kurthe" dhe në kontratën me AZHBR për 253,296 copë, pra për 3,296 copë më shumë ose 800,928 lekë të përfituara, por të pajustificuara (3,296 x 243 lekë/copë) me kontratën e furnizimit;

Megjithëse në kontratën e furnizimit të datës 20.05.2014 çmimin e një ecotradi e ka të përcaktuar jo më shumë se 200 lekë për cop, bashkimi i operatorëve është shpallur fitues me çmimin e ofertuar 218 lekë për cope, sipas metodikes dhe etiketës së ofertuesit të shpallur fitues, eco-trap siguron një efekt më të mirë kur vendoset në fazën e forcimit të bërthamës së ullirit (mesi i qershorit, ditët e para të korrikut) në një kohë që tenderi është zhvilluar me date 23.07.2014 dhe kontrata është nënshkruar më datë 12 gusht 2014, duke ulur ndjeshëm efektivitetin e përdorimit të tij; sipas TV "Ora news" në tetorin e vitit 2014 në zonën e Lushnjës ka qenë problem miza e ullirit, megjithëse ka qenë përfshirë në trajtim për luftimin e mizës së ullirit, gjë që tregon për efektivitet të ulët të këtij investimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

- Në fazën e monitorimit janë shfaqur mangësi në lidhje me sjelljen e listave të nënshkruara para përfundimit të kryerjes së shërbimit; janë përfshirë në Vlorë 12 ha të QTTB Vlorë, e cila nuk ka dhe nuk duhet të ketë prodhim ullinj, si dhe 1 ha fshati Aliban pa adresë fare. pra 13 nga 85.47 ha ose 15.2 % e fondit për këtë sipërfaqe është fiktiv; për sipërfaqen tjetër prej 410.916 ha; në Berat, sipas dokumentacionit në dosje listat nuk janë nënshkruar nga zyra e kadastrës dhe ato vendore, nënshkrimet pothuajse janë të njëjlojta dhe janë të nënshkruara 119 raste të pronës shtet, e cila përbën 9.4 % të sipërfaqes gjithsej të trajtuar për Beratin prej 810.9241 ha nuk janë shënuar fare emrat e përfituesve, por inicialet e emrit dhe mbiemri, firmat janë të njëjta, nuk ka datë se kur është nënshkruar; si dhe numri kadastral/emërtimi i parcelës janë pakuptim, pasi Vlora nuk ka dorëzuar së bashku me listën hartë kadastrale; verifikimi nga përfaqësuesit e AZHBR është kryer për një ditë, datë 03.09.2014, të cilët janë shprehur për numrin e rrënjëve dhe numrin e ecotrapeve, sipërfaqen, duke verifikuar brenda ditës veprimtarinë e disa ditore dhe të një grupi punonjësish, gjë që është e pamundur; Fituesi i lotit të Beratit ka kontraktuar blerjen e 80 mijë eco-trape dhe i kontraktuar dhe paguar për 81873 cop; fotot janë të copëzuara që i përkasin vetëm një blloku dhe jo të gjitha blloqeve.

- Në vitin 2017, Ministria e Bujqësisë në kundërshtim me VKM nr. 137, datë 22.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programimit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2016”, si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Financave nr. 8, datë 31.03.2017, më datë 16.05.2017 ka kërkuar që shuma 202,256,506 lekë e akorduar për mbrojtjen e ullishteve nga dëmtimi i mizës së ullirit të kalojë në aparatën e Ministrisë së Bujqësisë. Kjo pasi vetëm 100 milion lekë do të vihen në dispozicion për mbrojtjen nga miza e ullirit dhe pjesa e tjetër për dëmtuesit e bujqësisë, duke i kaluar Ministrisë së Bujqësisë më datë 31.07.2017, pra jashtë afateve për të dhënë efektin e duhur në interes të fermerëve dhe zhvillimit rural.

Për sa më sipër rekomandojmë:

29. AZHBR të studiojë dhe të analizojë me hollësi aplikimin dhe rezultatet e kësaj skeme, të evidentojë të metat, mangësitë dhe dobësitë e saj, duke parë mundësinë e kalimit në subvencionimin e ecotrapeve drejtpërdrejtë e fermerëve aplikues, mbi bazën e numrit të rrënjëve dhe faturës së rregullt tatimore për blerjen e tyre. Kjo gjë bëhet më e domosdoshme në kushtet e shkrirjes së DB në qarqe dhe rrethe.

Brenda tremujorit të parë 2018

II.3.3 Për pyetjen: A është përdorur me ekonomikitet mbështetja financiare e investimeve në bujqësi?

- Brenda një periudhe 5 vjeçare ka pasur ndryshime të mëdha të nivelit të financimit, vlerës dhe aq më tepër të drejtëve të investimit, tregon se nuk ka një strategji me objektiva të qarta dhe të matshme për të orientuar zhvillimin e bujqësisë në përputhje me strategjinë ndërsektoriale 2014-2020.

- Renditje e zonës së Tiranës dhe Durrësit me vlerën e investimit më të lartë në periudhën 2014-2016 tregon se më shumë ka përfituar zhvillimi i biznesit në tërësi, se sa ai i lidhur me rajonet bujqësore të zhvilluara, ndërkohë që ka qarqe si ai Dibrës që nuk ka fare apo Kukësi, të cilat edhe si pasojë e mungesës së aplikimeve, kanë vetëm një përfitues në vitin 2015.

- Vlera mesatare më e lartë e një projekti është në vitin 2015 në shumën 18,146,985 lekë. Duke i kategorizuar investimet në tre drejtme: ngritje/rikonstruksion ambientesh për grumbullim dhe ruajtje të prodhimit; blerje linja prodhimi dhe blerje traktori dhe makineri e pajisje bujqësore, në përgjithësi midis 67-80 % janë projekte të financuara në fushën e ndërtimit dhe diferenca linja prodhimi dhe agregate bujqësore. Kjo tregon se ose kriteret e vendosura nuk kanë siguruar mbështetje prioritare intensifikimit të bujqësisë ose veprimtaria informuese e AZHBR ka qenë kuptuar e diferencuar. Veç këtyre paraqitja e projekteve të fryra dhe në pjesën më të madhe me zëra shpenzimesh të fshehta, të pamundura për tu verifikuar nga ana e specialistëve të AZHBR, si dhe mungesa e inxhinierëve të fushës, e bën joshëse këtë formë mbështetjeje me investime, por që deformon arritjen e objektivave të zhvillimit bujqësor dhe rural.

Për këto rekomandojmë:



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

30. AZHBR të marrë masat e nevojshme për sigurimin e qëndrueshmërisë së kësaj skeme, si dhe të sigurojë shpërndarje territoriale dhe drejtimet e projektit të investimeve në favor të zhvillimit të bujqësisë dhe atij rural, nëpërmjet propozimit të kritereve dhe dokumentacionit të duhura për këtë qëllim.

Brenda muajit shkurt 2018

- Përfitimi i investimeve sipas subjektit, llojit territorit, shumës etj., nuk shoqërohet me pasqyrimin e kësaj liste pranë AZHBR ose drejtorive dhe zyrave të bujqësisë në rrethe, ose paraqitja në website-n zyrtar të këtyre institucioneve, përfshirë dhe Ministrinë e Bujqësisë.

Për këtë rekomandojmë:

31. AZHBR të rrisë transparencën e veprimtarisë së saj, duke pasqyruar në website-n zyrtar të dhëna mbi aplikuesit, përfituesit, projektin e investimit, vendndodhjen etj., duke i shërbyer njëkohësisht dhe rritjes së efektivitetit të kësaj mase.

Vazhdimisht

- Duke analizuar 133 përfituesit gjithsej në periudhën 2014-2016, konstatohet se në 13 raste ose 10% e tyre janë të njëjtët subjekte që kanë përfitur nga dy raste në dy vite edhe të njëpasnjëshme, kryesisht në Lezhë dhe Korçë. Kjo për shkak edhe të mungesës së kufizimeve në kritere që të mos lejojnë aplikimin për një periudhë të caktuar 5-7 vjeçare, për të siguruar jo vetëm një shpërndarje më të gjerë, por në të njëjtën kohë për të zbutur riskun e dështimit të investimeve, mjaft i pranishëm në fushën e bujqësisë. Për më tepër që një pjesë e konsiderueshme e tyre janë përfitues dhe në skemat e tjera të ashtuquajtura “të vogla”, si dhe janë kreditorë në banka të ndryshme, duke shkaktuar për pasojë mungesën e masivizimit të përfitimeve si dhe rritjen e riskut të dështimit.

Për këtë rekomandojmë:

32. AZHBR të analizojë me hollësi përfituesit e investimit të deritanishëm mbi bazë risku, duke ndihmuar me monitorime dhe këshillime më të shpeshta, përfituesit më të rrezikuar, si dhe të shmangë përsëritjen e këtyre rasteve në të ardhmen, duke krijuar mundësinë e shembullit të mirë në investime dhe rritjen e efektivitetit të tyre.

Vazhdimisht

- Nga dy auditime të Sektorit të Auditit të Brendshëm dhe nga shqyrtimi i dosjeve të përfituesve ka rezultuar se ka mangësi në dokumentacionin përkatës në lidhje me lejet, planbizneset etj.

Për këtë rekomandojmë:

33. Sektori i auditit të brendshëm në AZHBR të kryejë auditimin e çdo periudhe aplikimi, pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit dhe shpalljes së përfituesve, duke evidentuar mangësitë dhe përgjegjësitë përkatëse.

Për çdo vit, menjëherë pas shpalljes së përfituesve.

- Nga ana e inspektorëve rajonal të AZHBR nuk njihet vendndodhja dhe ecuria e investimeve në territorin përkatës duke ulur ndjeshëm monitorimin e zhvillimit të projekteve të tilla në dobi të zhvillimit bujqësor dhe rural.

Për këtë rekomandojmë:

34. AZHBR të njohë inspektorët rajonal me të gjitha projektet e financuara të investimeve, duke ju vënë detyrë përgatitjen dhe dorëzimin e një raporti periodik mbi aktivitetin dhe përputhjen e tij me plan-biznesin e paraqitur.

Vazhdimisht

- AZHBR ka arritur të vërë në përdorim të zhvillimit të bujqësisë vetëm 60.2% të fondit gjithsej kundërparti të vënë në dispozicion, ose nuk janë përdorur për investime 120,911,079 lekë, në një kohë që burimet dhe rrugët e financimit të zhvillimit rural konsiderohen të pamjaftueshme.

- Bazuar në shpërndarjen gjeografike konstatohet se kanë përfitur kredi pa interes 7 nga 12 qarqet, si dhe numrin (3) dhe vlerën më të madhe prej 26% të fondit është dhënë në qarkun e Gjirokastrës, Fier, Lezhë etj., gjë që nuk përputhet me zhvillimin bujqësor dhe rural në të gjithë vendin dhe me nivelin e zhvillimit brenda tij.

Për këtë rekomandojmë:

35. AZHBR të analizojë në mënyrë të hollësishme shkaqet mos thithjes së investimeve si dhe të forcojë kapacitetet e veta njerëzore dhe institucionale për të bërë të mundur përdorimin e të gjitha burimeve të mundshme të financimit në dobi të zhvillimit bujqësor dhe rural në të gjithë territorin e vendit.

Brenda tremujorit të parë 2018



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

- Dokumentacioni dhe procedura e dhënies së kredisë pa interes është shoqëruar me mangësi të shumta të cilat kanë sjellë pasoja në efektivitetin e ulët deri dhe të munguar të kësaj skeme.

Për këtë rekomandojmë:

36. AZHBR të marrë masa që të shmangë të gjitha mangësitë dhe të metat e evidentuara në këtë auditim, duke u shoqëruar me evidentimin e përgjegjësive, për të siguruar suksesin e projektit të financuar me kredi pa interes dhe rritjen e efektivitetit të masë së investimeve në bujqësi.

Vazhdimisht

- Përfituesit e kredisë pa interes për vitin 2013, deri në maj 2017 nuk kanë shlyer detyrimet korrente për shumën 25,368,500 lekë ose 80 % të detyrimit, ndërsa përfituesit 2014 – 2015 nuk janë korrekt me këstet e shlyerjes për 11,549,563 lekë ose 60 % të detyrimit të periudhës. Duhet theksuar se nga 5 përfitues në vitin 2014, 3 prej tyre nuk kanë shlyer asnjë këst nga kredia pa interes e marrë prej tyre, ndërsa për vitin 2013, 2 përfitues nuk kanë shlyer asnjë këst dhe 11 të tjerët kanë shlyer shumë pak, duke detyruar AZHBR që të hapë procese gjyqësore për 6 prej tyre. Në mos shlyerjen e detyrimeve ka ndikuar negativisht dhe lançimet e titullarëve të Ministrisë së Bujqësisë, për iniciativa për amnisti të këtyre detyrimeve, heqjen nga lista e debitorëve për t'ju krijuar mundësi aplikimi dhe përfitimi në të ardhmen.

Për këtë rekomandojmë:

37. Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR duhet të shprehen dhe të zbatojnë politika të qarta lidhur me zbatimin e detyrimeve në investime, me qëllim që të shmanget deformimi i objektivave për financimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural dhe rritjen e efektivitetit të fondeve buxhetore në këtë drejtim.

Vazhdimisht

- Në periudhën korrik 2016-nëntor 2017 janë kryer kontrole për 20 subjekte përfitues në mbështetje të investimeve 50% të vlerës së projektit të vitit 2014. Nga këto kontrole ka rezultuar se në 4 raste ose 20 % të projekteve ka mangësi të ndryshme si mospërputhje të makinerive me kërkesën për autorizimin e pagesës, operacioni nuk funksionon sipas kontratës, subjekti nuk vazhdon aktivitetin sipas objektivit të financimit etj., çka do të thotë në fund të fundit se 1/5 e projekteve të financuara nuk kanë ndihmuar në zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural.

Për këtë rekomandojmë:

38. Sektori i monitorimit në AZHBR të hartojë dhe të zbatojë një plan monitorimi periodik, me objektiva të qarta duke u përqendruar në ecurinë e projekteve të investimeve mbi bazën e plan-bizneseve të paraqitura, si dhe të koordinojë veprimtarinë tij me drejtoritë tjera brenda AZHBR për rregullimin dhe përmirësimin e situatës.

Brenda muajit janar dhe vazhdimisht

II.3.4 Për pyetjen: Sa i ka shërbyer monitorimi i granteve zhvillimit të bujqësisë?

- Mungesa e përcaktimit në udhëzimet e përbashkëta të MBZHRAU dhe MF në periudhën 2013-2017, funksionit të monitorimit për skemat kombëtare të vogla, përveç verifikimit para financimit dhe pas financimit 70 % të vlerës së investimit, ka ulur efektivitetin e fondeve të dhëna ndaj fermerit.

Për këtë rekomandojmë:

39. Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Financave në udhëzimin e përbashkët që miratojnë çdo vit për skemat kombëtare, të përcaktojnë edhe monitorimin e skemave kombëtare të vogla, me qëllim matjen e efektivitetit të fondeve të dhëna për këto skema.

Menjëherë

- Mungesa e sektorit të monitorimit për periudhën 2013-2015, mungesa e analizës për përcaktimin e numrit të duhur të stafit të kësaj strukture, me qëllim mbulim sa më të mirë të monitorimit të investimeve, si dhe fillimi i aktivitetit të kësaj strukture rreth 10 muaj me vonesa nga momenti i krijimit, ka sjell ulje të efikasitetit dhe efektivitetit të AZHBR në ushtrimin e këtij funksioni, ka ndikuar negativisht në efektivitetin e fondeve të dhëna për skemat kombëtare.

- Mungesa e manualit të detajuar për sektorin e monitorimit, metodologjisë për kryerjen e monitorimit, ka sjell ulje të efektivitetit gjatë ushtrimit të detyrave të këtij sektori dhe ulje të efektivitetit të fondeve të dhëna.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR”

Për këto rekomandojmë:

40. *Sektori i monitorimit AZHBR, të kryejë analiza për përcaktimin e numrit të nevojshëm të stafit ,të marri masat e nevojshme për përgatitjen e një manuali specifik për këtë aktivitet, ku të përmbajë metodologjinë, kalendarin, frekuencën e monitorimit (minimalisht një investim të monitorohet 1 herë në vit) dhe analizën e riskut mbi bazën e të cilit do të përzgjidhen investimet për tu monitoruar, me qëllim rritjen e efencës dhe efektivitetit të këtij sektori.*

Menjëherë

- Mungesa e informacionin për indikatorët gjatë monitorimit të investimeve të cilët sigurojnë të dhëna reale dhe të qëndrueshme se sa efektive janë fondet e dhëna, p.sh se sa ka qenë numri i të punësuarve në momentin e fillimit të aktivitetit dhe sa ka qenë në momentin e monitorimit, ecuria e të ardhurave të biznesit në ulje apo në rritje, ecuria e prodhimit në ulje apo rritje, etj, ka ulur efektivitetin e funksionit të monitorimit.

Për këtë rekomandojmë:

41. *Sektori i monitorimit gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, të monitoroj disa indikatorë të rëndësishëm, si rritja e fuqisë punëtore për biznesin, ecuria e të ardhurave, ecuria e prodhimit të aktivitetit, si dhe të rrisë numrin e monitorimeve gjatë 1 viti, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të fondeve të dhëna.*

Vazhdimisht

- Mungesa e auditimit të pagesave për skemat kombëtare të vogla për vitet 2013 dhe 2016 nga SAB, gjetjet dhe rekomandimet e varfra në përmbajtjen e tyre, si dhe auditimi rreth 3 % të totalit të përfituesve nga skemat e vogla, një vlerë shumë e ulët në krahasim me periudhën prej 4 vitesh, tregon për një performancë të ulët të këtij sektori, duke ndikuar negativisht edhe në matjen e efektivitetit të AZHBR ndaj skemave kombëtare.

Për këtë rekomandojmë:

42. *SAB të kryejë auditimin e skemave kombëtare çdo vit sipas përcaktimit në Udhëzimin e përbashkët të Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Financave, si dhe gjatë këtyre auditimeve trendi i dosjeve të përfshira për t'u audituar të jetë në rritje, me qëllim identifikimin e problematikave gjatë zbatimit të skemave kombëtare nga ana e AZHBR.*

Vazhdimisht

- Mungesa e monitorimit të objektivave (ku më kryesori është zbatimi i skemave kombëtare) të AZHBR, nga sektori i raportimit për periudhën 2013-2017, ka ndikuar negativisht në efencën dhe efektivitetin e këtij institucioni në realizimin e zbatimit të skemave kombëtare.

- Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit në kohë midis sektorit të monitorimit dhe sektorëve të tjerë të AZHBR (sektori i autorizimit të pagesave), ka ndikuar negativisht në punën e sektorit të monitorimit.

- Mos përditësimi me informacion i treguesve të monitorimit sipas SNZHRB 2014-2020, si normën e rritjes reale ekonomike të sektorit bujqësor, produktivitetin e këtij sektori, ka sjellë mungesën e këtyre statistikave të rëndësishme, të cilat janë elementë të rëndësishëm që ndikojnë në vendimmarrjen e institucioneve përgjegjëse për zhvillimin rural dhe të bujqësisë.

Për këto rekomandojmë:

43. *Sektori i raportimit AZHBR, të monitoroj zbatimin dhe ecurin e objektivave të AZHBR, gjithashtu të përditësojë informacionin lidhur me indikatorët e monitorimit të përcaktuar në SNZHRB 2014-2020, me qëllim përgatitjen e informacionit të saktë dhe të plotë për tu raportuar ndaj Ministrisë së Bujqësisë dhe Autoritetit Menaxhues.*

Vazhdimisht

- Mos vënia në dispozicion të AZHBR të strategjisë ndërsektoriale për zhvillim rural dhe bujqësor 2014-2020, nga institucionet përgjegjëse, tregon një mungesë bashkëpunimi ndërmjet tyre, duke sjellë efekte negative për të dyja palët.

Për këto rekomandojmë:

44. *Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të kenë koordinim dhe bashkëpunim sa më të ngushtë midis tyre, si dhe AZHBR-së t'i vihet në dispozicion nga Ministria e Bujqësisë “SNZHRB 2014-2020”, me qëllim identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndeshura nga eksperiencat e mëparshme gjatë aktivitetit të saj.*

Menjëherë



4.2 Aneksset (literatura e përdorur, pasqyra etj.)

a) Literatura e përdorur:

- http://www.azhb-ks.net/repository/docs/2017_07_20_145614_Raporti_Vjetor_i_AZHB-se_2016.pdf.
- <http://www.azhbr.gov.al/agjencia/rreth-nesh/historiku>
- <http://www.azhbr.gov.al/agjencia/rreth-nesh/misioni-dhe-vizioni>.
- <http://www.bujqesia.gov.al/al/programi/zhvillimi-rural/bujqesia-dhe-zhvillimi-rural>.
- <http://www.businessdictionary.com>.
- <http://www.investopedia.com/terms/s/secator.asp>
- <http://www.kryeministria.al/al/programi/zhvillimi-ekonomik/zhvillimi-urban-rural-dhe-rajonal>.
- <https://data.worldbank.org/indicator/NV.AGR.TOTL.ZS?end=2016&start=2016&view=bar>.
- <https://tradingeconomics.com/albania/rural-population-percent-of-total-population-wb-data.html>.
- Indikatorë të performancës, Tiranë, maj 2015
- Kodi i Punës miratuar me ndryshimet në Ligjin Nr. 9125, datë 27.09.2003.
- Ligji Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"
- Ligji nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"
- Ligji nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike".
- Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural"
- Manuale të procedurave për implementimin e skemave kombëtare 2013-2017.
- Manuali i Auditimit të Performancës.
- Nga fjala e KM: "Për herë të parë fermerët kanë Hartën e Rajonalizimit të Produkteve", 21 Nëntor 2014.
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030.
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020.
- Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020.
- Raporti i Vitit 2015 për Shqipërinë, Bruksel, 10.11.2015.
- Rregullore e Brendshme AZHBR 10.02.2016
- "Ribalancim për një rritje më të fortë" World Bank Group, Pranverë 2016.
- Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri 2014-2020, Nëntor 2014.
- Shqipëria: trendi i varfërisë 2002-2005-2008-2012, INSTAT.
- Udhëzim i MBZHRAU dhe MF Nr. 4, datë 25.02.2015 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural".
- Udhëzim nr 3, datë 30.12.2008 "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR, ndarjen e detyrave, përgjegjësisë, dhe kompetencave mes saj dhe aktorëve të tjerë të sistemit të bujqësisë dhe ushqimit"
- Udhëzim nr. 8, datë 31.03.2017 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të ndryshuar.
- Udhëzimet 2014-2017 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural".
- Udhëzimi Nr. 10 datë 22.11.2016 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural".
- Urdhër i Kryeministrit nr. 37, datë 26.03.2012 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

- Urdhër i Kryeministrit nr. 52, datë 22.04.2015 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural"
- Urdhër i Kryeministrit nr. 67, datë 13.02.2014 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural"
- Urdhër nr. 156, datë 01.12.2015 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së agjencisë për zhvillim bujqësor dhe rural"
- VKM 2013-2017 "Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, Për Vitin 2014, të ndryshuar.
- VKM Nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil"
- VKM Nr. 1443, datë 31.10.2008 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si Agjencia e Pagesave"
- VKM Nr. 719, datë 31.10.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", i ndryshuar, pika 4.
- www.instat.gov.al dhe përlogaritje të grupit të auditimit.

b) Pyetësi mbi zbatimin e skemave në terren:

I. Përfaqësuesit e DB dhe AZHBR në komisionet e pranimit të dokumentacionit

Qarku _____

Rrethi _____

Pozicioni i punës _____

1. Prej sa kohësh jeni pjesë e komisioneve të tilla? _____
2. Çfarë pengesash keni hasur për hedhjen në sistem të aplikimeve? _____
3. Kur është numri me i madhi aplikimeve në fillim, në mes apo në fund të periudhës dhe sipas mendimit tuaj pse? _____
4. Përgjithësisht sa herë paraqiten fermerët për aplikim me dokumentacion të plotësuar?
5. Sipas përvojës tuaj, çfarë dokumentacioni ju mungon përgjithësisht fermerëve aplikues? _____
6. A ju ka ndodhur që fermerët të kërkojnë informacion nga ju lidhur me dokumentacionin për aplikim? (PO/JO).
7. Sipas gjykimit tuaj cila është faza më e dobët në të gjithë ciklin e aplikimit dhe përfitimit nga skemat kombëtare: prioritetet, informimi; aplikimi, përzgjedhja, verifikimi, likuidimi) dhe pse?
8. Në vlerësimin tuaj, sa ka ndikuar programi i skemave mbështetëse në rritjen e të ardhurave të fermerëve të zonës: aspak, shumë pak, mesatarisht, shumë?

II. Përfituesit e skemave

Qarku _____

Komuna _____

Fshati _____

Skema _____

Sa here keni aplikuar 2013 – 2017 dhe për çfarë skemash? _____

Sa here keni përfituar 2013 - 2017? _____

1. A jeni informuar në kohë për mbështetjen që jep AZHBR? (PO/JO)
2. Si e keni marrë informacionin mbi skemat mbështetëse (specialistët e AZHBR/DB; Tv Kombëtar/lokal; Shtypi; burime të tjera)
3. A përputhen skemat me nevojat tuaja për subvencion? (PO/JO)
4. Rendisni tre nevojat bazë që mendoni se duhet të mbështeten?



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

5. A jeni dakord me kriteret e përcaktuara për përfitim? (PO/JO). Në se jo, ku duhen ndryshuar? (Shtuar, pakësuar, ndryshuar) _____
6. Çfarë mendoni për kriteret: Sipërfaqe; numër krerësh; sasi prodhimi etj.
7. Si e konsideroni nivelin e mbështetjes: dobët; mjaftueshëm, mesatar, normal?
8. Mendoni se procedurat e përzgjedhjes kanë qenë korrekte? (PO/JO) Në se jo, për çfarë arsyeje? _____
9. A ka qenë korrekt verifikimi i bërë nga komisioni? (në kohë, komisioni i plotë, respektimi i udhëzimit, arsye të tjera? _____
10. A është bërë në kohë likuidimi për skemën që je shpallur përfitues? (PO/JO). Në se jo shkaku _____
11. A keni plan biznesi, në se po kush e ka përgatitur _____
12. A keni pasur ndonjëherë dokumente mbi sasinë e prodhimit, shpenzimet të ardhurat etj.? (PO/JO)
13. Numri i të punësuarve të përhershëm _____ sezonal _____
14. Sa përqind mendoni se janë rritur të ardhurat tuaja pas zbatimit të skemës mbështetëse?
15. Sa vite keni qe merreni me biznes bujqësor? _____

Sipas gjykimit tuaj cila është faza më e dobët në të gjithë ciklin e aplikimit dhe përfitimit nga skemat kombëtare: prioritetet, informimi; aplikimi, përzgjedhja, verifikimi, likuidimi) _____

c) Pasqyra

Pasqyra nr. 16 Temat e Trajnimeve 2013-2015

	Temat e Trajnimeve 2013-2015
Drejtoria e Kontrollit/ Sektori I Skemave Kombëtare	workshop on National „Minimum Standart GIZ
	Traning on National Minimum Standart (Standardet minimale)
	Training on "on the spot control requirements" from IPA II, Sa and FwA GIZ/STE workshop GIZ (standartet e kontrollit në vend për IPARD)
	Capacity building for performing on the spot control on Ipard-like grand scheme at call III GIZ (kontrolli për skemat IPARD)
	workshop capacity building for performing on the spot control on IPARD-like grand scheme SARD-IPARD (Ngritja e kapaciteteve për kryerjen e kontrollit për IPARD)
	Traning on animal health and welfare
	Sectorial agreement on chical meeting GIZ
	workshop on National „Minimum Standart GIZ (mbi Standardet Kombëtare, Standarde Minimale të GIZ)
	Reviw and Adjustments Accounting GIZ/STE
	Traning on animal health and welfare (Shendeti I Kafsheve)
	Traning on NMS on food safety (Siguria e Ushqimit)
	Law on Administrative Procedure GIZ/STE (Ligji për Procedurën Administrative GIZ/STE)
	Sistemi Orade (Sistemi Orakëll)


Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Pasqyra nr. 17 Numri i projekteve dhe vlera financimit 2013 - 2016



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR"

Grafiku nr. 12 Nr projektsh-Vlerë Financimi 2013-2016



Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Pasqyra nr. 18 Buxheti i Planifikuar- i Realizuar 2013

Skemat	Viti 2013		Ndryshimi nga plani-	Në %
	Plan	Fakt		
Totali i planifikuar	1,052,000,000			
Bashkëfinancimi IPA	100,000,000			
Informimi mediatik	5,000,000			
Financimi IPA në % ndaj Totalit	10%			
Skemat për Bujqësin dhe Zhvillimin Rural	947,000,000			
Skemat për Bujqësin dhe Zhvillimin Rural në % ndaj Të prapambetura	226,892,685			
Të prapambetura ndaj Skemave	632,107,315			
Financimi I aplikimeve të reja	67%			
Financimi I aplikimeve të reja në % ndaj 947,000,000				
1 Mbiellje ullishte	97,447,890	219,043,406	121,595,516	56%
2 Mbiellje arvore	21,025,491	35,718,361	7,897,883	22%
3 Mbiellje Laiti, Shegë	6,794,987			
4 Mbiellje vreshti	7,038,596	11,632,200	4,593,604	39%
5 Mbiellje subtropikale	8,681,506	12,954,580	4,273,074	33%
6 Mbiellje pemtore	20,459,107	46,266,960	25,807,853	56%
7 Bimë Medicinale	76,939,695	101,724,256	24,784,561	24%
8 Plasmas për Sera me ngrohje	19,717,920	30,879,910	(4,216,085)	-14%
9 Plasmas në tunele	15,378,075			
10 Dele/dhi të Matrikulluara	155,506,885	169,570,500	(945,885)	-1%
11 Dele/dhi rac e pastër	15,009,500			
12 Vica per majmeri	27,775,000	20,005,000	(7,770,000)	-39%
13 Mbarshtrim Kërmilli	5,975,300	2,207,000	(3,768,300)	-63%
14 Uittje me pika	77,379,018	66,917,925	(10,461,093)	-16%
15 Lopë për qumësht	43,418,602	44,309,250	890,648	2%
16 Koshere Bletë	18,838,244	19,233,000	394,756	2%
17 Meshqera/Racë e paster	6,329,960	5,920,000	(409,960)	-7%
18 Vaj Uliri extra-verg	6,000,000	5,400,000	(600,000)	-11%
19 Prodhim i produkteve BIO	2,170,000	280,000	(1,890,000)	-675%
20 SH.B.B	30,000,000	11,824,219	(18,175,781)	-154%
21 Normë interes Kredie	58,000,000	42,722,404	(15,277,596)	-36%
Totali				

Diferenca në % Total
Fonde të Planifikuara-Fonde të realizuara

780% 18
43%

Burimi: Të dhëna të AZHBR të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH